

FADIL ZEÇIRI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

Z 48

DHËMBI I TRETË

TREGIME

85H-32


248

FADIL ZEQRIRI

R

DHËMBI I TRETË

Tregime



35769

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: *Tatjana Haxhimihali*

Piktor: *Safo Marko*

Tirazhi 5000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISh Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972

RRUGA E FUNDIT E NJË LANXHE

Dy rrema binin herë pas here në ujë duke lëshuar një tingull të butë e monoton. Futeshin dy-tri pëllëmbë thellë e që aty dilnin prapë mbi sipërfaqe si për të marrë më tepër vrull që sërishmi të binin me forcë më të madhe.

Ishte natë e qetë. Yjet e reflektuara në gjoks të detit e bënë sipërfaqen e tij të dukej si vazhdim i kupës së qiellit. Rremat herë pas here godisnin mbi këtë ujë duke i prishur qartësinë. Por uji përsëri kthjellohej e yjet sikur mbinin përsëri nga fundi i detit.

Varkëtari, një burrë me shpatulla të fuqishme dhe me krahë që ngjanin si shtesa të rremave që shtrëngonte, me duar tërë kallo, u jepte atyre me tërë forcën duke lëshuar herë pas here një ofshamë që pasonte zhurmën e rremave në ujë. Fytyra e tij e përzhitur nga erërat e detit e me rrudha të njomura nga djersët, shprehte një egërsi të çuditshme.

Vetëm errësira dhe yjet e ndritshme qenë dëshmitarë të asaj egërsie. Lanxha e mbushur me pjesë rezervë për fenerë, me kavo, pinca, darë e sharra për riparimin e tyre, shkonte drejt një feneri të

largët në sfondin e zi si pendë korbi, në malin përbri. Ai fener, po të mos shuhej e të ndizej me intervale të caktuara, edhe feneristit, që tani ngiste lanxhën drejt tij, me siguri do t'i dukej si një yll i ulur në sipërfaqe të detit.

Feneristi voziste drejt fenerit dhe mendonte. Gjithmonë, kur nisej drejt fenerëve, ditën ose natën, për të bërë riparime të çastit, ose për t'u hedhur gaz, ai rrinte me shpinë nga fenerët, por me zemër kishte qenë gjithmonë me ta.

E kjo kishte arësyet e saj. Fenerët digjen vetë që jeta të vërshojë nëpër dete, ngushtica e gjire... Ata vendosen mbi shkëmbinj të nënujshëm, mbi vaporë të mbytur, nëpër cekina e ngushtica që vaporët të mos përplasen, që pjesa e tyre e nënujshme të mos çahet. Ata shuhen e ndizen me intervale të caktuara si puna e zemrës së njerëzve. Këtë e di më mirë nga të gjithë feneristi. Po pse është kaq i zymtë?

E quajnë Thanos, po të gjithë e kanë thirrur dhe e thërrasin fenerist. Zanatin e mësoi me të vjedhur. Disa thonë se e ka mësuar te feneristët e ishujve të Dalmacisë, disa të tjerë thonë se e mori nga mjeshtri i tij i mëparshëm që e kishin sjellë nga jashtë për mirëmbajtjen e atyre pak fenerëve që kishte vendi para çlirimit. Mjeshtri vdiq. Tërë fenerët e vjetër edhe ata të rinjtë, që u ndërtuan nga pushtuesit fashistë i mbetën Thanos për t'i mbikqyrur. Ai ishte mësuar shpesh me detyra të pavarura. Feneristi kujdesej me shpirt për ta. Kush nuk i do mbrojtësit e jetës? I bëhej zemra mal kur dëgjonte se filan motobarkë, që e zuri furtuna, shpëtoi në saje të fenerit pa u përplasur në breg, se vaporit i pasagjerëve i ardhur nga Bari kaloi pa dalë në cektinë përmes kanalit të thelluar, të piketuar me fenerë etj. Po ki-

shte edhe raste të tjera që feneristit i priteshin fuqitë e i mbeteshin duart mbi rrema. Lanxha e tij lëkundej si e pirë nga dallgët e larta që krijonin elikat e fuqishme të anijeve luftarake. Ato sillnin topa, predha e municione. Feneristi e dinte përse duheshin ato armë. Nga porti ku shërbente shihte anije të mëdha me flamurë të huaj. Në barkun e bëshëm, të pangopur të tyre kishte bakër, bitum, naftë e grurë. E dinte ku shkonin. Të gjithë këta vaporë e anije lufte kalonin nëpër kanalin e ngushtë të piketuar me fenerët e tij. Kjo gjë e mundonte shumë dhe e fuste në mendime të thella. Këto mendime ja shfaqte edhe sekretarit të partisë së celulës. Siç thamë feneristi ishte njeri që luftonte për dritën.

Kishin një kohë të gjatë që po bisedonin të dy me sekretarin në një dhomë përdhese, nën dritën e një kandili, që Thanos i kujtonte dritën e yjeve të mbytura në det.

Nuk po duronte dot më.

— Më lejoni të iki. Është koha kur të gjitha rrugët të shpien në mal — kishte thënë feneristi. Po njeriu i partisë nuk qe ngutur t'i jepte leje menjëherë.

— Është koha kur të gjitha rrugët të shpien në luftë kundra okupatorit — i qe përgjegjur qetë.

— Ç'të bëj që po u shërbej ende fashistëve. Nuk e bëj dot. Më djeg këtu brenda — kishte thënë feneristi dhe i kishte rënë me grusht gjoksit të tij të gjerë.

— Jo, do të qëndrosh edhe ca, sa të fitosh mirëbesimin, pastaj do të të vijë radha.

— Shokët e mi i bëjnë kërmë këmishëzinjtë, ndërsa unë u tregoj anijeve të tyre rrugën e hyrjes dhe të daljes, u hap portat e atdheut, më dëgjon?

— Ti e di që edhe unë kam një punë të mirë në radhët e tyre, po bëj të kundërtën. Lufta nuk është vetëm në mal. . .

. . . Këtë bisedë e kujtonte feneristi edhe tani me duar mbi rremat që uleshin dhe mjegullonin dritën e yjeve të reflektuara në det. Ofshama dilte më qartë nga gjoksi i tij e lanxha rrëshqiste drejt fenerit diku larg në sfondin e errët. Po mendimet s'e linin të qetë. Anijet që vinin nëpër portet tona, ose që largoheshin prej tyre nisën të shtoheshin. Shpesh nga shpatet e maleve vinin krisma. Nga thellësitë e horizonteve të kaltëra dallgët nxirrnin gjëra të lehta, si salvaxhente, në breg, karrige, borsalina etj. Ky është një ligj për detin. Ai gjërat e lehta i ka nxjerrë gjithmonë në breg. Lufta po shtohet në tokë e në det.

Një mbrëmje erdhi një korrier dhe e thirri feneristin. Ishte korrieri ynë. E kërkonte sekretari i celulës.

— Tani erdhi radha jote — i kishte thënë ai. — Duhet prishur fenerët. Këtë më mirë se kushdo mund ta bësh ti. Me këtë veprim të kryer me mjesh-tëri e shpejtësi do të dëmtojmë komunikacionin detar — i kishte thënë sekretari.

— Si t'i prishim? . . . Unë kërkova të dal në mal.

— Lufta jonë kërkon të qëndrosh e të luftosh në det.

— Fenerët i shërbejnë jetës. Unë me këto duar. . .

Feneristi kishte vënë të dy duart e fuqishme mbi tryezë, ashtu të hapura, sikur të deshte të mban-te zemrën në to. — S'e bëj dot. . . Është e vështirë të prishësh atë që bie erë nga djersa jote.

— Edhe vetë lufta i shërben jetës. Edhe vdekja

e shokëve tanë atje lart e këtu rreth e rrotull i shërben jetës. . . — i kishte thënë sekretari.

— Këtë mos ma besoni mua. E kam të vështirë. Kanalet e mia të piketuara me fenerë më janë bërë si rremba gjaku. E kam të vështirë. . . Më dhimbsen.

— Po shokët kur hedhin në erë urat tona e shtëpitë tona, lehtë e kanë? Në mes të tyre ka punëtorë, muratorë, inxhinierë, njerëz të ndërtimeve. Secilit i dhimbset ajo që ka ngritur me duart e tij. Asnjë lloj ure që i shërben armikut të mos mbetet në këmbë!

— Fenerët e mi janë ura për të gjithë.

— Po sot ato i shërbejnë vetëm armikut.

— Njëpër vaporë ka udhëtarë dhe gra e fëmijë.

— Njëpër gërmadhat e shtëpive tona të djegura nga fashistë janë varrosur me mijëra të tillë. Kjo është luftë, shoku Thano. Ne si njerëz, si forca e saj, duhet të kuptojmë drejt dhe thellë. — Sekretari i kishte hedhur dorën në sup feneristit dhe kishin qëndruar për disa çaste në heshtje. Fytyra e Thanos i ngjante një feneri të shuar. Dialogu kishte vazhduar gjatë. Më në fund ai ishte larguar me një mendim të drejtë e me zemër të plagosur. . .

Që prej asaj nate fenerët në det sa vinin e pakësoheshin. Dikujt i futej ujë në bovë, nga një e çarë. Zhytej ngadalë nën dallgë, ndriçonte për disa çaste ashtu, e mandej shuhej përfundimisht. Dikujt i qe thyer llamba e ndriçimit, e bova qëndronte në gjoks të detit, pa dritë, si roja në gjumë.

Shefi i feneristit, një tenente i ri me flokë tërë brilantinë e parfum, i thërriste vartësit:

— Pse s'jep dritë feneri te vaporë i mbytur? Nga humbi feneri i cektinës, folë! . .

— Po ja, zoti tenente, parmbremë bëri det.

Dallgët janë të forta. Fryn murlani. Pastaj edhe pilotët e kundërshtarit i kujtojnë dritë vaporësh e bombardojnë...

— Të rregullohen... Të rregullohen të thashë — çirrej e bërtiste tenentja. Feneristi nisej në punë, por prapë difektet përsëriteshin.

Një herë tjetër e thirri në zyrë. Ishte tepër i zemëruar tenentja. Mbi tryezë kishte vendosur revoletën, sigurisht, jo pa qëllim.

— Për fenerin e hyrjes së kanalit do të më përgjegjesh me kokë... Natën e së shtunës presim një ngarkesë të rëndësishme. Vjen... — Tenentja e kuptoi se po e shkelte, prandaj e ndërroi bisedën. — Po i ndodhi ndonjë difekt fenerit të hyrjes në kanal in kryesor, shkëlqimi i syve të tu do të venitet si flakë kashte. — Në të njëjtën kohë rrëmbeu revolverin dhe e futi në këllëf...

Thanoja u jepte rremave me tërë forcat, ndërsa në vesh i vinin fjalët e tenentes. «Natën e së shtunës»... Kjo ishte pikërisht nata e së shtunës. Lanxha rrëshqiste drejt fenerit në hyrje të kanalit, aty mbi shkëmb në sfondin e errët të bregut malor.

«Pse ta mbyt, i lindi befaz një ide në kokë. Kështu po i mbyt të gjithë. Unë me këto duar i kam ngritur. Sharrë kam. Do të pres spirancën e ta lë të lirë. Vala do ta lëvizë nga vendi pa spirancë, do ta shpjerë tej. Shkëmbi mbetet i mbuluar, përplasja realizohet. Mua kjo më duhet. E kam rrugën e malit. Feneristi ngriti kokën drejt sfondit të maleve që qëndronin me tërë madhësinë e tyre». Po, po nuk do ta mbyt. Sharrë hekuri kam... Do t'i pres kavon e spirancës», vendosi përfundimisht feneristi. Kjo ndodhi në çastin kur lanxha i që afruar shumë më Bovës, në majë të së cilës fikej dhe ndizej feneri.

Lidhi cimën e lanxhës në bovë e me një të kërcyer u hodh në të. Bova u mënjanua nga pesha. Feneristi mbajti vesh. Dëgjohej vetëm llapashitja e valëve në bregun e afërt e asgjë tjetër. Mori sharrën e nisi të priste kavon e poshtme të spirancës. Dëgjohej vetëm zhurma që shkaktohej nga brerja e metalit. I përkulur afër sipërfaqes së ujit me fytyrë andej, balli i lagej herë pas here, sipas lëkundjeve. Dora që mbante sharrën punonte me vështirësi nën ujë. Herë zhurmonte uji, herë zhurmonte sharra.

Befas ndodhi ajo që s'pritej. U dëgjuan tri bre-shëri të njëpasnjëshme automatiku. Qenë plumba gjurmëlënës. Ata goditën bovën, njëri e gërvishi feneristin në dorë, ndonëse ajo vazhdonte të punonte nën ujë. Sharrën nuk e lëshoi. Drita e fenerit i binte mbi trup. Ajo dritë që e kishte ushqyer vite me radhë, tani po e luftonte. Automatiku vilte zjarr e plumba. Bova e hekurt dhe e madhe e mbronte.

«Më paska pikasur tenentja», mendoi feneristi. Megjithatë nuk mund të largohej pa kryer detyrën. Një herë mendoi të thyente llambën e dritës. Ngrii dorën, por e uli prapë. Plumbat u shtuan. Snajperi e ruante me kujdes dritën e fenerit. Siç dukej kë-shtu e kishte urdhërin. Feneristi po ndjente ujin që po i lagte trupin. Bova po anohej e po hynte në det. Ishte shpuar nga plumbat e po mbushej me ujë. Ai u mbështet fort pas bovës. Plumbat nuk i përshkonin dot anët e hekurta të saj.

Bova qëndroi shumë në ujë dhe e mbrojti ruajtësin e saj, pastaj u zhyt bashkë me feneristin dhe fenerin. Ai pa për herë të fundit shkëlqimin e dritës, që u fik përgjithmonë nën dallgë. U dha krahëve dhe me not zhyt kaloi në të majtë të armiqve që qëllonin vazhdimisht. Doli në sipërfaqe për t'u ori-

entuar e për të marrë frymë. U zhyt sërish. Vendin, si mbi ujë ashtu edhe nën ujë, e njihte me pëllëmbë.

* * *

Feneristi ngjitej shpatit të malit, kur dëgjoi sirenën e largët të një vapori. Nga lartësia vapori dukej si një kodër e errët në hyrje të ngushticës. «Me sa shoh unë, kapiteni, meqenëse nuk e ka parë dritën e fenerit, është lëkundur nga frika edhe nuk e ka futur vaporin në kanalën e ngushtë. Tani ulërin dhe pret ndihmë. Mbeti jashtë vathës së mbrojtur... Po, po, feneri im u mbyt, po punën e bëri.»

Feneristi pa edhe një herë vendin ku disa orë më parë ndodhej feneri dhe lanxha e tij, që qenë fshirë nga sipërfaqja e detit. Pësia e bovës së mbushur me ujë e kishte anuar dhe tërhequr pas, drejt thellësive edhe lanxhën. Ajo e kreu me nder detyrën në rrugën e fundit.

Vapori vazhdonte të ulërinte. Ngadalë-ngadalë yjet u fshinë nga sipërfaqja e qiellit dhe e detit. Agimi i ditës së diel e gjeti vaporin jashtë, në det të hapur. Tani ai mund të hynte në gj, por...

Befas u dëgjua zhurmë motorësh. Një çift aeroplanesh ra në pikiatë mbi vaporin e madh. Këtë punë e përsëritën disa herë me radhë. U dëgjuan plasje bombash dhe u ngritën shtylla uji. Në fund njëra ra mbi kuvertë. Shpërtheu flaka. Vapori u përfshi prej saj. Kur ai u anua pa shpresë shpëtimi, dy aeroplanat bënë edhe një rrotullim demonstrativ dhe u zhdukën.

Feneristi i shoqëroi me sy. Ai e kishte të qartë se punën kryesore e kishte bërë feneri, e jo aeropla-

nat. Më kot u mburrën me këtë fluturim të fundit.
Feneristi i ktheu shpinën skelës dhe ngau hapat drejt
majës së malit. Edhe andej vinin krisma. Lufta
kundër fashizmit ishte ndezur kudo. Thanoja do të
ndizte fenerë të rinj në male.

REZERVISTI

Llogaritari i kooperativës, Islam Mediu, me vetulla të ulura e ballin mbushur me djersë, i ra fushës mes për mes. Ecte me nxitim. Kaloi nëpër parcelat e mbjella me mollë pa vënë re se ku e hidhte hapin, kapërceu vijën e tharë të ujit, doli në një bregore të vogël dhe hodhi vështrimin tej arave. Dielli deshte dhe dy hostenë që të fshihej prapa kodrave. Tutje, disa pendë qe lëronin ende. Syri i tij dalloi menjëherë, që larg, Mithat Seferin që mbante dorezën e plugut. E njohu jo vetëm nga shtati i gjatë dhe qylafi i bardhë, por dalloi edhe Larashin e Murrashin që përbënin pendën e qeve më të mira të kooperativës.

Me të parë fshatarin, llogaritarit ju prenë gju-njët. Gjer atje kishte ardhur vërtet me një frymë e i tronditur, por nuk e kishte ndjerë aq thellë shqetësimin, sa tani kur pa Mithatin.

«Si t'ja them, të ziut. Është e vështirë t'i japësh tjetrit mandatën!»

Filloi të zbriste ngadalë nga bregorja.

«Duhet nisur larg e larg, zuri të mërmëriste. Këto gjëra nuk thuhën drejt. Do t'i zgjat kutinë e duhanit... «Mithat, do t'ja nis, dikur ne quanim

humbje më të madhe ngordhjen e kaut të vetëm, apo përmbytjen e tokës së paktë. Të kujtohet sa e thellë qe dhembja jonë? Pastaj do t'i flas për vdekjen e të birit. Po, pas tokës do t'ja them mënxyrën... Ç'hyn toka në hidhërimin e Mithatit?—

Islami ecte, ndërsa tymi i cigares i kalonte pas. Era e sillte që larg zërin e bujkut që u bërtiste qeve. Ndihej edhe zhurma e majës së plugut tek ndeshej me gurët e një parcele të papunuar. Fshatari po i vinte asaj rrotull. Dukej se kishte vendosur t'ja ndryshonte ngjyrën në të kuqe që atë mbrëmje.

— Puna mbarë, Mithat!

— Mbarë paç e me bereqet, shoku Islam!

— S'paske të ngopur, lum miku. Dielli të thërret t'i lësh të lira qetë. Nuk sheh se janë bërë qull?

— Dielli vërtet më thërret, po toka më tërheq. Më vjen keq ta lë këtë copë për nesër — ju përgjegj bujku pa e ndërprerë punën.

— Drejt e ke, po eja ta ndezim nga një — i tha përsëri llogaritari dhe, duke e parë bujkun që ende s'po vendoste, shtoi: — Ke zjarr, se këto dreq shkrepse s'më ndizen.

— Kam eshkën e strallin që s'më lënë në baltë. Meqë paske qejf, tym të dalë!

U ulën afër brazës së hapur. Përballë tyre dukej qartë brezi i punuar i kufirit, në shpat në malit. Rrezet e diellit, që binin mbi të, e bënë të dukej si një vijë e ndritur. Pak më tutje brazës, nën hijen e një pjeshke, bri shtambës së ujit, llogaritari pa pushkën e bujkut.

— Do të kemi misër të mbarë sivjet. Ujin e kemi te dera, toka është si tul — nisi të fliste Islami teksa me duar thërmonte një copë dhe.

— Ashtu është, vëlla. Toka i ngjan pushkës. Po

e vajise dhe e mbajte mirë, s'të turpëron. — Bujku heshti një çast, pastaj ju kthye llogaritarit: — Po ty ç'të solli këtej poshtë kaq vonë?

Islami uli sytë përdhe.

— Ç'sjell minuta, nuk sjell moti, Mithat.

Mithati u mbështet më bërryl dhe vështroi nga pushka.

— E ç'mund të na sjellë kjo e uruar minutë? Po ecim me këmbët tona. Jo vetëm që s'i marrim më shtetit, po i shesim edhe teprica. Kooperativën e kemi si s'ka më mirë. Ujin e sollëm, mot do të biem edhe elektrikun. Më vjen keq që humbëm jetën nëpër parmendat e të tjerëve. Por s'ke ç'i bën. . .

— Mithati fërkoj mjekrën e parruar për disa çaste dhe, duke vërejtur nga fusha, tha: — Do t'ua lëmë djemve dhe vajzave tona që ta zbukurojnë më shumë, që të jetojnë më të lumtur.

— Djemve tanë, the zotrote — ja mori fjalën llogaritari, ndërsa përpiquej të gjente fjalën që vetë Mithati po ja sillte në shteg dhe belbëzoi: — Po ata që nuk kanë fëmijë, po atyre që. . . — llogaritari la fjalën përgjysmë, se e pa që nuk ja doli dot.

Mithati u kthye me rrëmbim nga ai.

— S'po të marr vesh, o Islam! Si «atyre që. . .» çfarë «atyre që», flet ca fjalë që s'po t'i kuptoj dhe sytë m'i mban përtokë. Po mbush të pesëdhjetat e nga kjo jetë kam mësuar se njerëzit që s'të shikojnë në sy kur flasin, ose nuk janë të drejtë, ose fshehin diçka. Edhe ty sot sikur s'të shoh mbarë: Vjen vonë, flet gjëra të shkëputura dhe më thua: «Ata që nuk kanë fëmijë, do t'ja lënë. . . . kooperativës, popullit, Shqipërisë, pse kujt t'ja lënë. S'ka këtu për të vrarë mendjen — u nxeh Mithati.

— S'më kuptove. Unë e kam fjalën se jeta ka

të papritura. Ne jemi bujq, i duam arat, bimët. Mbjellim ndonjë pemë, e ushqejmë, e vaditim me djersën tonë për vite me radhë. Kur ja, rrufeja e mallëkuar vete e i bie tamam asaj peme, pemës që nuk ka shoqe pranë.

Mithati u pre. Cigarja i ra nga dora. Duart plot damarë nisën t'i dridheshin. Mbylli sytë, po i hapi menjëherë, si të deshte të largonte një mendim të keq, një mendim të kobshëm.

Në atë çast nga ana e postës kufitare u ndjenë tri të shtëna pushke me intervale të barabarta. Të dy burrat brofën në këmbë. Alarm në kufi. Islami mbeti si ngrirë. Mithati vrapoi te pushka e tij dhe i vuri krehërin.

«S'e kuptoi akoma, tha me vete llogaritari. Po tani si t'ja bëj? Më duhet të shkoj me fshatarët të zëmë shtigjet.

— Ç'më rri si i ngrirë, o Islam, — i thirri Mithati me pushkë krahaqafë — nuk e dëgjove alarmin?

— Mithat, ti duhet të shkosh në shtëpi. Në këto çaste atje je më i domosdoshëm.

— Në shtëpi?..

— Duhet të shkosh patjetër. Të gjithë ne marrim pjesë në hidhërimin tënd. Duhet të mbash veten, vëlla... .

Mithati hapi sytë, vuri dorën në gjoks dhe duke ju marë goja tha:

— Dja... djali?

Llogaritari pohoi me kokë.

— Gëzimit i pushoi zemra papritur në arë. Ishte fare mirë. Më duket sikur jam akoma duke parë ëndërr të keqe... .

Mithatit i kërcitën nofullat. Ju afrua shokut dhe e kapi nga jaka, e shtrëngoi fort si të deshte

të shfrente ndonjë zemërim, por, papritur, u mbësh-
tet në gjoksin e tij dhe pëshpëriti:

— Pse s'ma the më përpara, pse?

— Më fal, shok. Nuk qenkësh kollaj. Nisu në
shtëpi, ngushëlo nënën e djalit, ngushëlo të tjerët.
Ata kanë nevojë për ty. Erdha këtu me qëllim që
të të shpija në shtëpi. Aty do të vinin dhe të tjerët.
Por tani. . . Unë. . . ne të gjithë??? ti e kupton. . . Ko-
mandantin e postës po e vë unë në dijeni për ty.

Llogaritari u nis, në fillim me hapa të ngutur,
pastaj me vrap. Ecte dhe mendjen e kishte ende te
Mithati, te dhembja e tij e thellë.

Tri orë më vonë, në errësirën e mbrëmjes, në
postën kufitare u grumbulluan dhe rezervistët. Ar-
miqtë e kishin marrë mësimin e merituar. Koman-
danti i postës nxori nga çanta listën. Në radhë të
parë duhej bërë apeli. Kështu është rregulli, pas
përpjekjeve me shkelësit e kufirit.

— Islam Mediu — nisi ai të thërriste me zë të
lartë emrat e rezervistëve, pas atyre të kufitarëve.

— Këtu!

— Gani Gorani. Mithat Seferi. . . Gëzim Seferi. . .

— Këtu — u përgjegj i njëjti zë për të dy.

Dikush i zgjati krahun kufitarit të moshuar. Llo-
garitari ktheu kryet nga ai. «Paska ndejtur vetëm
pak çaste në shtëpi», mendoi. Ju afrua dhe e vësh-
troi në sy. Pastaj të gjithë u kthyen poshtë nga koo-
perativa, nga shtëpia e tij.

Mithati mbante në dorë një cigare të trashë, të
pandezur. Llogaritari i afroi shkrepën.

NËNA ME ZEMËR TË MADHE

Një shoku im artist më tregonte:

Ishin ditët e fundit të korrikut. Punë shumë ndër ara, bënte vapë e madhe.

Trupa jonë e teatrit kërkoi të shfaqte dramën në klubin e kooperativës, ku ishin mundësitë për t'ja dhënë publikut me të gjitha nuancat e saj. Kishte vend të gjerë për ndërrim skenash, dhoma zhveshjeje, etj. Mirëpo na ngeci gozhda në gur nga kryesia.

— Jo — nguli këmbë kryetari. — Na ju prisnim si ujin e rrallë. Ekonomia ka shumë njerëz. Ku i nxe klubi të gjithë? Kanë punuar tërë ditën dhe ndjejnë nevojën për pak freski që t'u përthajë fytyrën e djersitur. Në arë jashtë, e ngrini skenën.

U vendos që ta jepnim shfaqjen në një lëndinë të gjerë në fund të fshatit, ku dy plepa të mbirë afër njëri-tjetrit u bënë buzë për skenën tonë të thjeshtë. Kooperativistët u ulën mbi bar. Erdhën dhe gratë me fëmijët e vegjël. Disa brigada nuk arritën dot të linin as veglat e punës. Me to në duar u ulën, menjëherë, këmbëkryq. Burrat pinin duhan, ndërsa fëmijët e shkollës, që e kishin lexuar pjesën, komentonin me zë të ulët.

Nuk ma merrte mendja se do të mblidhej aq popull.

Në atë pjesë mua nuk më kishin dhënë rol. Trupa jonë e ka bërë traditë tashmë që, kur niset për turne, të pregatitë disa drama. E ndodh të kesh edhe ndonjë ditë pushim.

I lodhur nga puna e ditës, (të gjithë ditën punonim në fushë së bashku me shokët e kooperativës) u lëshova mbi bar si të tjerët. Përpara meje rrinin një grup fëmijësh. Në të djathtë një djalë i ri, ndërsa në të majtë një plakë e veshur me të zeza. Asnjëri nuk pipëtinte. Dëgjoheshin vetëm fëshfëritjet e fletëve të plepit dhe ndonjë blegërimë e largët deleje. Qe mbrëmje. Dielli kërkonte dy-tri pushkë që të fshihej prapa maleve, në perëndim. Bari lëshonte një erë dehëse.

U hap skena. Drama ishte me përmbajtje nga Lufta nacionalçlirimtare. E njihja mirë historinë e kësaj krahine. Sa e sa herë këto fshatra malore kanë qenë dëshmitare dhe kanë marrë pjesë vetë në drama të tilla. Në këto male të zhveshura, luginat e lëruara numërohen me gishtërinj, por qafat, shkrepat dhe shpellat nuk i llogarit dot.

— Katilët! — murmuriti plaka që kisha në brinjë. Në atë kohë nuk po shikoja në skenë. Sa e sa herë e kisha parë. Ngrita kokën drejt saj. Drama po arrinte kulmin. Heroi kryesor, një djalosh i torturuar deri në vdekje nga fashistët, rolin e të cilit e luante shoku im, Skënderi, u thirr për t'u ripyetur. Rrobat e gjakosura ishin të nxira dhe të grisura në shumë vende. Prej tyre shquheshin pjesë të enjtura të trupit. Para tij rrinin në tryezë tre oficerë fashistë, me rrobat e tyre të zeza. Njëri u ngrit, mori kamxhikun dhe përveshi mëngët.

— Të poshtërit — tha plaka me zë të lartë dhe afroi cepin e shamisë së zezë te dhëmbët. E kafshoi fort. Dëgjova kërcitjen e dhëmbëve të saj. Ishte plakë e mbajtur.

Djaloshi në krahun tjetër më preku me bërryl:

— Nënë Hankoja — më tha me ngadalë, duke afruar buzët pranë veshit tim.

Nuk pashë gjë tjetër në atë çast, veç fytyrës së rrudhur të nënë Hankos. Një copë e shamisë i rrinte si strehë në anën e majtë, pjesa tjetër i zgjatej nën shpatulla. Sytë e skuqur të drejtuar nga skena shprehnin një egërsi të madhe. Ajo fytyrë më dukej sikur ruante gjurmët e luftës së djeshme, të bërë nga kjo krahinë.

Përpara nesh nga skena vinte zëri i zemëruar i kuestorit.

— Trego cilët janë shokët e tu. Vetëm kryetari na duhet e ty të pret liria. . .

— Shokët. Kryetari! . . . Liria — kërciste dhëmbët nënë Hankoja. Thashë se mos shikoja ndonjë vijë lotësh nëpër ato rrudha të thella, që ngjanin si të plasurat e tokës së etur për ujë, të tokës që nuk u ngop kurrë, por më kot.

Plaka vazhdonte të shtrëngonte njërin cep të shamisë me dhëmbë, ndërsa vështrimin e kishte ngjitur në tribunë, atje në skenën tonë.

Papritur fytyra ju ndryshua menjëherë, ju bë si shamia e hedhur kokës. U ngrit, shikoi rrotull sikur kërkonte diçka.

— Ulu, nënë Hakon! Nuk shikojmë dot ne të prasmët — u dëgjuan zëra.

Me sa dukej, ajo nuk dëgjonte. Ashtu e ngritur, me fytyrë të egërsuar e me grushte të mbledhura, ngjante si një shqiponjë majë shkëmbit, gati për t'ju hedhur kundërshtarit.

Njerëzit nga pas u mënjanuan për të parë. Djaloshi pranë meje u ngrit, e preku në sup dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Me sa kuptova, ju lut që të uletj. Nëna u ul e i tha djaloshit:

— Si e katandisën katilët!

M'u desh që të ndërhyja për ta zbutur, se mos zemërimi i saj shkonte më tej e prishte dramën.

— Është lyer me bojë ai, moj nënë. Ato nuk janë plagë të vërteta. Është artist — i thashë me zë të lartë, si u ktheva drejt saj.

— E di — u përgjegj.

S'e kam te ky unë, more bir, s'e kam te ky. Veç dëgjo nënën ti. Gjaku buron nga zemra, prandaj nuk ja zë vendin asnjë lloj boje.

Mbështolli mirë shaminë rreth qafës e i drejtoi përsëri sytë nga skena.

— Ashtu është, por s'kemi si t'ja bëjmë ndryshe — i thashë për ta qetësuar. Ajo vazhdoi më tej:

— Gjaku! Sa i shtrenjtë është! S'ka më të shtrenjtë se gjaku, e prapë ja kemi falur dhe jemi gati t'ja falim atdheut.

— Se atdheu është më i shtrenjtë se çdo gjë — i thashë.

— Ashtu është, të keqen nëna.

Përreth u rivendos qetësia. Disa njerëz zgjatnin kokën për të dëgjuar bisedën tonë. Ne flisnim me zë të ulët. Në fund nënë Hanksja u përqëndrua prapë në skenë. Unë vrisja mendjen për qëndrimin e saj. Djaloshi që kisha në bri më erdhi në ndihmë.

— Që kur ju vra i biri, nuk ka dalë nga fshati. Për në shfaqje mezi e kandisëm.

Sakaq u mbyll perdja. Mbaroi pjesa e parë. Njerëzit u ngritën në këmbë, duke duartrokatur. Nënë Hanksja me vështrim të përqëndruar në drejtim të

grykës, ku nxinin disa re të largëta, nuk lëvizte as qepallat. Pastaj rrudhat e fytyrës ju tkurrën, ngriti kokën lart dhe një ngjyrë tjetër shkrepëtiu në sytë e saj. U largua pa përshëndetur, duke çarë me trupin e saj të shkurtër atë gardh njerëzish që duartrokisnin pa pushim.

2

Po errej, kur mbaroi drama. Spektatorët u përhapën nëpër shtëpira. E ngritën skenën dhe zunë të grumbullonin tryezat dhe karriget. Artisti i fundit, i rrethuar me batanie, që po ja mbanin shokët, po vishesh me rrobat e tij.

Skënderi nuk e hoqi akoma makiazhin, as mundi të zhvishej. Roli i tij vazhdonte edhe në skenën e fundit. Ai po bisedonte me regjizorin dhe me disa nga fshatarët, kur ja behu nënë Hancoja. Në dorë mbante një bohçe me rroba të mbledhura me kujdes. Nga mollëzat e rrudhura i kalonin bulëza djerse. Ajo u afrua dhe të tjerët i bënë vend.

— Lëmë të të puth, or bir, se më nxore mallin e djalit — i tha Skënderit. Ky uli ballin. Nëna e puthi aty ku dukej ende shenja e plagës.

— Kaq sa ti ishte, ma vranë, i vraftë mortja.

Plakës i dridhej trupi. Fytyra e saj ishte shumë tronditëse.

— Më piku në zemër thiatrua. Pashë disa minuta të jetës sime. Pashë tim bir...

Ne ju afruam të gjithë. Ajo rrinte në mes tonë, fliste dhe ngrinte dorën e rrudhur lart, sikur të mbante fjalim.

— Ju solla rrobat e tim biri, që m'i dhanë ata pas pushkatimit.

I kam ruajtur si sytë njëzet e pesë vjet në sënduk. Merrini. Le t'i shohin të tjerët. Ju u treguat shumë gjëra njerëzve, rinisë. Të dalin dhe këto në ajër. Zëre se është ai vetë gjallë. Atje brenda do të kalben. Merrini, janë me gjak të vërtetë. Unë sot jam, nesër nuk jam, kurse im bir rron. . . — e, si i pritë pak për të mbledhur mendimet, shtoi: — Vetëm thumëni nga do të veni. Të vij t'ju shoh ngandonjëherë, se më merr malli.

I tha këto dhe ju hodh prapë në qafë Skënderit, duke e puthur në çdo vend të fytyrës.

E zgjidha me duar të dridhura atë bohçe me rroba. Një xhakëtë dhe një palë pantallona të vjetra, të grisura, me shumë arna. Në shumë vende të lyera me gjak e të djegura. Leshi i shkrumbuar dukej ende sikur lëshonte erë mishi të përcëlluar.

Të gjithë shtangën. Asnjëri nuk i dha përgjegje nënë Hankos. Skënderi i puthi duart e rrudhura. Rregjizori thithi deri në mushkëri cigaren. Sekretari i organizatës bazë të partisë të teatrit mori frymë thellë dhe foli i pari:

— Këto rroba, nëno, kushtojnë më shumë. Ne do t'i vendosim në muze. Atje ka mundësi t'i shohë gjithë populli ynë.

— Po unë, bir?

— Edhe ti, edhe gjithë brezat, që do të vijnë.

— Më bëni kabull, kaq mendojmë ne plakat. — Rregulloi shaminë, u ul e puthi rrobat, puthi prapë Skënderin dhe u largua. Skënderi e shoqëroi. Ai na tha se ajo deri në fund nuk derdhi asnjë pikë lot. Të gjithë menduam se ajo ishte një nënë me zemër të madhe.

U err. Flladi u shtua. Gjethët e plepit po lëkundeshin nga era e mbrëmjes. Ato përplaseshin me njëra-tjetrën dhe nxirrnin disa fëshfëritje si duartrokitje.

Të nesërmen muzeut të qytetit tonë ju shtua edhe një thesar i çmuar.

VIGJILENCA

Sirenat e fabrikave e të uzinave, llojet e ndryshme të borive dhe të zileve ranë me ritme më të shpejtuara. Herë pas here këto sinjale shoqëroeshin me zëra:

— Alarm! Alarm! Secili të zërë postin e caktuar!

Me këtë ritëm vraponin edhe njerëzit drejt pikave, posteve e vendstrehimeve, sipas detyrave. Vargu i tyre rrallohej përherë e më tepër. Dikush me uniformë, dikush civil, por të gjithë të armatosur.

— Alarm! Alarm! — u dëgjua për herë të fundit nga altoparlanti.

Ishte një alarm stërvitor.

Qyteti u bë si i shurdhër, rrugët mbetën pa njeri. Cilido kishte zënë postin luftarak, ose ishte vendosur në strehimin e tij.

Ne, tri veta të armatosur, kryenim shërbimin e patrullimit buzë detit të mbushur me shkëmbinj.

Në trasenë e kaltër të detit u shfaqën valë të shkumëzuara. Për njëfarë kohe ato nuk u zhdukën, pasi po kalonte kateri silurues i parë. Nëpër valët e bardha që krijonin elicet e tij, vërshonte i dyti, e kështu me radhë. Alarmi ishte dhënë edhe në det.

Ne ecnim të tre. Asnjë frymë njeriu përreth.

Ende më zhurmonin në vesh tingujt e prerë të alarmit kur, befas, shoh në buzë të ujit, pas shkëmbit, një njeri që tërhiqte filispanjën dhe thithte i qetë çibukun. Ndoshta ishte i vetmi njeri i gjallë që nuk e kishte prishur terezinë nga ritmet shqetësuese të sirenavë të alarmit. «Do të jetë shurdh», mendova. U bëra shenjë dy vartësve që të më ndiqnin dhe ngava drejt tij.

Burri i moshuar kapi grepin me mjeshtëri peshkatari, e rrotulloi disa herë krahun në formë spirali po me atë ritëm po me atë zotësi dhe i flaku tej në det. Nga inercia u përkul.

Nuk mund të them me saktësi se ç'moshë kishte. Vetëm fytyrën e kishte të dobët, me nofulla të dala dhe ballin të përzhitur nga erërat e detit. Njerën këmbë m'u duk se e kishte të vënë, pasi shkonte dhe ulej me mundim pas shkëmbit. Më tej ndodheshin plaçkat e tij: një biçikletë me tri rrota, një xhakëtë e vjetër ushtarake dhe mbi to një batanie e murrme nga ato të luftës së fundit. Nën batanie vendi dukej i ngritur. «Me siguri, thashë, do të jetë trasta e mbushur me gjahun e zënë».

«Patjetër është i shurdhër e nuk di gjë për alarmin», mendova dhe vendosa ta lajmëroja:

— Xhaxho, është dhënë alarmi. Njerëzit kanë kapur armët. Të pamundurit, ata që nuk e punojnë gishtin e pushkës, kanë zënë strehimet.

Ai nuk lëvizi as qepallat nga fjalët që i thashë. Gjithë qënja e tij ishte mbërthyer tek ajo fije e hollë që shkëlqente nga dielli.

— Alarmi është zëri i atdheut! — vazhdova unë.

— Njerëzit kanë rrokur armët, kanë zënë pozicionet!

Dora që mbante filispanjën lëvizi disa herë. Peshkatari i kënaqur, rregulloi kapelën...

— Ah, e mallëkuar! Kocë e zgjuar. Ma hëngri tonjën dhe s'ra në grep. Tfu! — dhe nisi ta tërhiqte pa kthyer sytë nga unë. Nga lëvizja e kapelës prej stofe leshi unë i kisha dalluar thinjat. Sytë e mi të inatosur bridhnin sa te filispanja, që po mblidhej spirale në këmbët e peshkatarit, nga duart e tij të shpejta, tek ajo dendësi thinjash si copa shkume. Ai po i vinte grepit ushqim të ri, copa sardeleje. Mua më vinte të haja veten me dhëmbë. Ndodhej në sektorin tim të shërbimit dhe ai nuk duhej të peshkonte në kohë alarmi.

— Xhaxho, qyteti është në alarm! — i bërtita.

— Sh-sh-sh-ët — pëshpëriti dhe vuri gishtin e rrudhur në buzë. — Çdo lloj gjuetie kërkon qetësi.

Këto ishin të vetmet fjalë që dëgjova prej tij.

— Njerëzit kanë zënë pozicionet...

— Në buzën e detit çdo shkëmb pozicion është. Edhe unë jam në pozicionin tim — më tha duke hedhur vështrimin nga fija e hollë që lëkundej mbi valë.

— Në pozicion me filispanjë në dorë?!

Rëndësi kishte fakti se peshkatarin indiferent nuk ishte shurdh. Pra me ndonjë mënyrë, mund të merrresha vesh me të.

— Mua më kanë hequr nga lista, e hëngra çaririn... — tha ai duke bërë një shenjë nga ana e këmbës së vënë. Një nënqeshje u duk në fytyrën e tij. Nuk e kuptova mirë përse, pasi tonja e tendos, e bashkë me të, edhe duart e tij. Ai bënte punën, unë i thërrisja. E, vetëm kur krahët e argjenditë të një koceje të madhe goditën për herë të fundit mbi valë dhe u ngjitën drejt grepit që e tërhiqte, më tha:

— Pusho, lanet, se s'marrke erë fare nga gjuetia!

Ai i hiqte peshkut grepin, unë vrisja mendjen se ku e kisha parë këtë fytyrë. Në fund m'u mbush

mendja se duhej të ishte detar, ndonjë kapiten i vjetër i dalë në pension, ndryshe nuk kishte si ta përdorte me aq mjeshteri tonjën dhe të qëndronte kaq mospërfillës në një kohë kur cilido që do të qe në vendin e tij do ta kuptonte se ndodhej në faj. Të bësh sikur nuk ka asgjë në çaste të vështira, është zakon i vjetër i detarëve të regjur.

— Ata që hiqen nga listat e kanë vendin në strehim, në kohë alarmi — i thashë i vendosur. — Ndaj mblidhni plaçkat dhe, kur të kthehem me patrullën, të mos ju gjej më këtu..

— Mirë e ke ti, djalo, por puna e gjuetisë së mirë nuk bëhet në çdo kohë — m'u përgjegj.

Peshkatari invalid u kthye nga unë, ngriti dorën e lirë nga filispanja drejt mureve të një shtëpie katërkatëshe, që ende nuk ishte mbaruar, tendosi muskujt e fytyrës dhe tha:

— E sheh ndërtesën e re që po ngrihet? Në ledhet e saj ka vend për gurë të mëdhenj e të vegjël. Nëpër të plasurat mistria e muratorit fut llaç e ato shtrëngohen fort me njëra-tjetrën. Kështu muri bëhet i pakalueshëm nga çdo furtunë... Po le ç'them unë... ju të rinjtë... — dhe peshkatari uli dorën ngadalë mbi gjunjë e u kthye nga deti.

— Njerëzit provohen në çdo rast. Alarmi është lidhur me mbrojtjen e atdheut dhe të jetës. Në këtë pikë ju nuk bëni pjesë në asnjë lloj «muri». Jo vetëm që dëmtoni veten tuaj, por tërhiqni edhe vëmendjen e «armikut» — i thashë.

Fytyra ju nxi. Filispanja po i dridhej mbi valë. Më vërtiti fjalët:

— Kur unë kam dëgjuar alarmet e bashkë me to dhe zërin e vdekjes, yt atë e jot ëmë akoma s'e dinin se do të takoheshin e do të të lindnin ty. More

vesh? Mora, thuaj! Tani nisu në punën tënde, se po më tremb gjahun!..

— Dale, shok, pse e more keq? E kemi për de-tyrë që...

Sytë e tij lëshonin shkëndija... Tërhoqi me nervozizëm filispanjën dhe me mundim e shikoi e u ul mbi gurin e lëmuar për ta rikuar. E pashë se s'kishte ndër mend të më përgjegjej më. Sa mund të luajë shkëmbi nga vendi, aq luante dhe peshkatari. Megjithatë e porosita prapë që, kur të kthehesha, të mos e gjeja më aty dhe u nisa.

Njëri nga ushtarët kureshtarë desh të shikonte sa peshk kishte zënë, ndaj ngriti cepin e batanies. Sytë e mi mbetën për disa çaste atje, të hutuar, jo se kishte diçka të paparë, po se më doli një e papritur. Aty ndodhej një pushkë, në rripin e vjetër të së cilës numërova njëzet e pesë të prera me biçak, ndërsa në qytën e drunjtë lexoheshin disa fjalë që ende s'i kishte fshirë koha: «Babicë, qershor 1920. Drashovicë shtator 1943».

Në trastën e gjahut kishin nxjerrë kokë disa ballë me fishekë. Ktheva kryet nga peshkatari. Ai shikonte nga deti. Nuk na kishte vënë re se ç'po bënim. Tërhiqte filispanjën. Siç dukej, tani po i binte prapë peshku.

— Më fal, xhaxho, më fal... Po. po të lëvizin të «kaltërit», lajmëroni me tri të shtëna që ta marrim vesh se pozicionet janë zënë, e ne i zbuluam.

— Mos ki merak — m'u përgjegj.

Ngava hapat pa patur guxim të ktheja kokën pas.

Horizonti zhurmonte. Karaburuni, ashtu mbuluar me mjegull, qëndronte në përgjim. Pas nesh dëgjohej zhurma e dallgëve që thërmoheshin nëpër shkëmbinj.

PROVIMI I PARË

— Bëhuni gati, shokë, se do ta lagim — tha Jovani me buzë në gaz dhe tregoi nga Feti, që kishte ngritur një cep të xhupit e përpiqej të ndizte cigaren. Të tjerët qeshën. Feti, me qafën e gjatë mbështjellë me jakën e shqepur të xhupit, i inatosur nga era, që i fiku dy herë shkrepse, nuk u përgjegj menjëherë. I ktheu shpinën erës, ndezi prapë shkrepse e, vetëm kur era e duhanit i gudulisi hundët, u kthye nga shokët duke nxjerrë tymin nga goja.

— Kur të kthehem në Durrës, zëmë qoshen tonë në bufe «Vollga». Atje jo vetëm ta lagim, por ta djegim fare. Nuk jam aq dorështrënguar sa mund të mendojë ndonjëri.

— Në «Vollga» the? — e pyeti Jovani dhe ja shkrepri prapë gazit me të madhe. Akoma tek ura e Dajlanit ky. E kemi gjetkë fjalën ne, mik vëllai? Si, mendon ti, të dalësh për herë të parë në oqean, të japësh «provimin» e detarllëkut e të kalosh ashtu lehtë pa e mbajtur mend? Jo, jo, ka zakone deti.

— Pse, ç'kërkoni akoma nga unë?

— Do ta shikosh? Mos u ngut më shpejt se elica — tha Mersini dhe u shkeli syrin të tjerëve si për t'u thënë: «Nuk kupton muçoja».

— Që ta dish ti, Feti, se je muço akoma, mbasi nuk e ke dhënë «provimin», këtu nën kallunën e vaporit ka varreza vaporësh të mbytur gjatë epokave. Që nga rremat, te velat, te avulloret me qymyr e naftë, deri te mashinat e sotme moderne. Pra ka koleksione të çdo lloj marke. I thonë gjiri i Biskajës, këtij — tha Mersini. Ai la cimën përdhe dhe ngriti gishtin duke e tundur lart sikur të mbante fialim. — Kush kalon për herë të parë këtej, i jepet, si të thuash, patenta e naftës, prandaj i nënshtrohet një dushi të mirë që ta mbajë mend për tërë jetën, siç i mban mend nxënësi provimet e maturës; them të maturës, se ka provime edhe më të vështira deti, ja, ta zëmë lundrimin e mëtejshëm nëpër oqeanë, ndërrimin e klimave dhe kalimin e ekuatorit.

Për kalimin e ekuatorit e di. E dinë bile edhe muçot që nuk kanë kaluar as prakun e Adriatikut, por, sa për Biskajën, kjo është pjellë e fantazisë suaj — tha Fetiu i qetë. Mersini përpiquej të bënte një radace të re, nga një cimë e trashë, e dalë jashtë përdorimit. Pothuajse e kishte në mbarim e sipër. Ai po shtrëngonte fort telin rreth fijeve të litarit në kokë të bishtit të drunjtë, me ndihmën e një dare të madhe. Jovani përfitonte nga pushimi i vogël dhe përgatiste bojën për lyerjen e pjesëve metalike të kuvertës që të mbroheshin nga ndryshku. Sa të kalohej Biskaja, do të merrej një sulm me goditje të përqëndruar për pastrimin dhe rregullimin e mbikuvertës.

— Shiko, shiko, prapë kërkon të bëjë bisht — tha Mersini. — E di që s'e ke për qejf, se helbete, është ftohtë, duart edhe në xhepat e xhupit nuk e ndjejnë veten mirë, po s'ke ç'i bën. Zakoni është zakon.

«Hëm! Zakoni është zakon,» thotë. Të më bëjnë qull në këtë kohë, kur hedhin valle dallgët nga fto-
ma. Bëjnë shaka? Të bukur shaka paska menduar.
Vërtet e lagën Petritin edhe Metin kur «Vlora»,
duke i rënë rreth Afrikës, kaloi për herë të parë
ekuatorin, po atje pëlçet peshku nga vapa e piqet
buka në diell, kurse këtu në këtë shkurt të ftohtë...
Po edhe Selfon e lagën në lundrimin e parë gjatë
kalimit të Biskajës, bënte pak ftohtë, po sidoqoftë,
ishte verë. Frynte gjiri, po dielli digjte ende. E ai
pas dushit i vuri kurrizin oxhakut, në anën e kundërt
të erës dhe, si kaloi një gjysmë ore, erdhi në kurs
dhe e mori veten për bukuri. Sidoqoftë edhe ky ve-
prim ka domethënjen e tij. Njerëzit mërzhiten duke
parë vetëm qiell e det të egërsuar. Kjo s'është punë
orësh, por punë ditësh. Mërrin pak me shokun, duke
larguar ashpërsinë që u mbjell nëpër zemra egërsia
e detit në këtë stinë. Kurse mua nuk do të ma kishte
qeji një dush të tillë...»

«E bela, bela, pëshpëriti Feti. Atje në ekuator
uji të freskon trupin, kurse këtu...»

— The gjë, Feti? — pyeti Mersini duke shtrënguar
telin me dorë.

— Jo, asgjë. — E, si priti pak, vazhdoi: —
Pse, vërtet e keni ju?

— Ti e kupton vetë. Rrugë e gjatë, mërzhitje, do
variacione detari, se i shkumon buza si kurriz dallge.

— Sikur po lëvizim shumë pak.

— Muçoja ynë kërkon të shpëtojë një orë më
parë nga ethet e Biskajës — tha Mersini. — Mos u
mërzhit, se edhe durimi bën pjesë në këtë ceremoni.

— Bëjeni dreqin ç'keni për të bërë, ose më lagni,
ose mora tubin dhe do të lagem vetë — tha Feti

midis të qeshurave të shokëve të tjerë. Do ta bëj si ai që i dha çadrën shokut.

— Prit edhe pak sa të qetësohet — ju përgjegj Mersini. — Nuk e shikon çfarë erë e marrë që po fryn? E pret tymin e fumajolit si me sharrë.

Nuk arriti të përgjegjej Feti, kur u dëgjuan disa zëra të mbytur që vinin nga poshtë. Në çast hodhi sytë nga fumajoli, kur...

— Zjarr! — thirri ai duke mbledhur grusht gish-tërinjtë e futur në xhepat e xhupit. Mersini lëshoi radacen, darët dhe vrapoi drejt rubinetit të afërt, që sillte ujin nga motopompat? U përkul për ta zhvidhosur, por duart e ftohta nuk kishin fuqi të mjaftë.

— Zjarr në oxhak! — bërtiti Feti, i cili, si pa shokun që s'bëri dot gjë, kapi darën që tjetri i kishte lënë përdhe dhe i ra me forcë rubinetit. Ai përsëri nuk lëvizi. Nga të lyerit vazhdimisht me minium, filetat qenë shtrënguar fort njëra me tjetrën. I ra dhe një herë. Uji shpërtheu në kuvertë. Mbërriti Jovani me shllangën që kishte në majë një hedhëse për ta flakur ujin me presion. Mersini ngriti sytë lart drejt fumajolit. Ju duk sikur po digjej qielli. Tymi u përhap përreth me shpejtësi.

«Pse nuk shqitet, pse nuk stakohet zjarrfikësja automatike e fumajolit, mendonte i shqetësuar Feti. Pse nuk po shuhet zjarri? I hipi gjaku në kokë. Zjarr në fumajol. E ku? Në mes të Biskajës.» Ishte njësoj sikur efektivin e anijes, ngarkesën e çmueshme dhe vetë vaporin ta shtyjë drejt mbyttjes. Shikonte zjarrin dhe shokët. Ju parafytyrua Myrtezai me Muhametin duke i mbyllur frymën flakës me batanie, Adem Reka duke i vënë gjoksin furtunës mbi bigë. Ju kujtuan të gjitha, nëna e tij plakë, që llogaritte ditën e vajtjes dhe të ardhjes dhe e priste në port... me

sy të djegur nga malli. Ju kujtua... çfarë s'ju kujtuan në ato çaste.

— Është jashtë gatishmërisë sistemi zjarrfikës — bërtiti Mersini i djersitur mbi shllan.

«Po tani si do të vejë halli?! Unë jam mekanik e flaka më djeg oxhakun e shtëpisë. Kjo është shtëpia ime. Te plaka në Durrës, rri vetëm dy-tri ditë si mysafir, kurse këtu tërë jetën...»

— Tërë jetën — përsëriti me zë dhe vrapoi drejt flakës.

— Po ky ku vete, ky?.. Feti, kthehu! — bërtiti Jovani duke qenë në kulmin e zemërimit dhe e shau rëndë. Ndërkaq vaporit uli shpejtësinë në minimum.

Fetiu u ngjiti në majë të shkallëve. Tani ndodhej ballë për ballë me flakën.

Hoqi xhupin, e mori në duar, rrotulloi krahët dhe i uli mbi flakë menjëherë. Në duar ndjeu përcëllimat e para. Poshtë, shokët e bënë gati shllangën.

— Mos, se na flet kapedani. Ka rrezik që uji të fikë mashinën — i tha Mersini Jovanit.

— Në djall të venë këto teori. Në e fiktë, e ndezim prapë. Këtu po digjet vaporit, ky i trembet fikjes së mashinës — tha Jovani dhe e ngriti tubin e shllangës lart mbi fumajol, ku gjuhët e flakëve që i ngrinte era po rriteshin vazhdimisht. Fetiu ndodhej nga ana tjetër. Mbi trupin e tij, që kishte marrë flakë, nisën të thërmoheshin currilat e ujit, të cilat vinin që poshtë nga shllangat e drejtuara prej shokëve. Mersini shikonte i trembur nga flaka e bërtiste me zë të lartë.

— Feti! Kthehu, është urdhër i kapitenit! — Zëri i tij ngrihej mbi ushtimën e dallgëve.

Jovani që po kafshonte vazhdimisht me dhëmbë buzën e poshtme, ngrinte dhe ulte hedhësen me presion të ujit drejt rrobave të shokut. Shllangat e tjera

e kalonin currilin e tyre herë mbi Fetiun e herë mbi fumajolin.

Kapiteni, si siguroi timonin dhe uli shpejtësinë, vraponte sa te njëri te tjetri.

Pas derdhjes së masës së parë të ujit në oxhak, u përhap një re tymi, e cila po pushtonte tërë kishin. Flaka sa vinte e mblidhej si kuçedër në strofkën e saj, veç s'deshi të jepej.

— Tani duhet të zbresë Fetiun, ja... tani — thoshte Mersini duke lëvizur këmbë e duar, po shoku i tij nuk po dukej.

Fetiun gërriti xhupin gjysmë të djegur, të porsashuar dhe të rënduar nga pesha e ujit, që ngjante nga larg si flamur i shpuar nga plumbat dhe me të në duar u vërtit mbi atë copë flakë që u kishte shpëtuar currilave të ujit dhe të avullit, e që s'desh të jepej ende. Duart për disa çaste nuk e ndjenë nxehësinë. Rrobat e trupit nuk morën më flakë. Mandej dhe flakës ju zu fryma përfundimisht. Në vend të saj plakosi tymi, i cili u shpërnda shpejt nga era duke nxjerrë në shesh tubin e oxhakat të nxirë anash dhe trupin e Fetiut që priste akoma se mos dalloheshin gjëkund shenja zjarri. Në shumë vende rrobat i qenë djegur, e nga larg dukej si ato shportat lara-lara të thurura me thupra.

Si u bind që rreziku u kalua, u kthye dhe nisi të zbriste shkallët. Njëra dorë nuk peshonte shumë pas shkallëve. Sa keq! Jovani dhe Mersini ju afruan për ta ndihmuar. Shokët e tjerë nga kuverta nuk ja ndanin sytë e skuqur nga tymi.

Fetiun kullonte ujë, e nga trupi i dilte një avull i nxehët. Fumajoli ende lëshonte tym. Edhe detari, edhe oxhaku kishin gjurmë djegjeje.

Mersini ju afrua dhe i zgjati një cigare të ndezur.

— Faleminderit — i tha Fetiu. — Më mirë, pas dushit. Do ta zhvilloni atë qerrata ceremonie, apo jo?.. — Shokët qeshën me të madhe, ju afruan, e zunë në qafë, e ngritën në duar duke bërë sikur do ta hidhnin në gjirin e Biskajës.

— S'është nevoja të të pagëzojmë ne — i thanë. — Tërë kjo që ngjau vlejti shumë më tepër.

Vetëm atëhere Fetiu e kuptoi se papritur e kishte dhënë provimin e parë në një mënyrë krejt të pakuptuar.

PËR PJEKJA E FUNDIT

Xha Zen'eli shkundi çibukun në shollën e opin-gës, nxori qesen, e mbushi prapë me duhan atë çibuk të vjetër druri me rreth hekuri, duke i mëshuar nga sipër që të merrte sa më shumë me gishtërinjtë e hollë të rrudhur nga vitet. Pastaj, ai mori një urë zjarri nga vatra dhe e ndezi, qesen e duhanit e futi në xhepin e xhaketës prej shajaku, ku mbante strallin dhe eshkën. Me gishtërinj ai preku letrën që e kishte sjellë pak më parë, poshtë nga fshati, ai malukati i vogël i Xhelos. Thithi dy herë çibukun dhe u ngrit, mori çiftin varur në oxhak, te vendi i miqve të nderuar të kasolles, i futi dy fishkë mbushur me plumba, që i përdorte në gjuetinë e derrave, lidhi gjerdanin në brez e pastaj vështroi të nipin.

Fëmija i ndiqte me vëmendje veprimet e gjyshit e sytë i shkëlqenin si dy thëngjij të ndezur. Nën dritën e flakës i kishte lexuar letrën gjyshit, ndaj e merrte me mend pse u mbush çiftja. Ai përkëdheli me duart e vogla Lolon, qenin besnik, që i ngatërrohej nëpër këmbë, si për të fshirë atë shtresë bore ende të pashkrirë në kurrizin leshtor. E deshte

shumë kafshën, po edhe ai nuk ju nda asnjëherë, sikur të ishte kërrabë e bariut të vogël.

— Te shpella e zezë thoshte karta, more? — pyeti gjyshi.

— Po veç duhet të nxitojmë, se koha nuk pret.

— Ti me Lolon do të rrish në shtëpi. Me t'u gdhirë, nxirri dhinë në dushqet e Përroit të thatë.

— Do të vij me ty — nguli këmbë nipi, me zë të shuar nga lotët. Pikat e dendura u mblodhën në mjekrën e njomë. Nga flaka që i jepte dritë kasolles, ato pika loti vezullonin me gjithë ngjyrat e spektrit.

Qeni, sikur t'i kuptonte të gjitha, vinte rrotull fëmijës. Plaku hodhi çiftin në sup, me grykë poshtë, e mbuloi me gunën e dhive, hodhi kapuçin mbi qyllahun e bardhë me majë dhe ju hakërrua të voglit:

— Rri këtu të thashë! Do të arrij përpara gjermanëve e do kthehem më të zbardhur. — Hapi lesën e kasolles. Një rrymë e fortë dhe e ftohtë ajri vërshoi brenda. Flaka në vatër u përkul e u nda në dy pjesë si mustaqe kuqoshi. Plaku i dha trupit përpara si me inat për të mposhtur forcën e erës të përzier me copa bore dhe e tërhoqi derën pas. Nuk i pëlqente kur ja kthenin fjalën të vegjëlit.

I nipi, i mësuar me këto huqe, u bind. Kur plaku u zhduk në errësirën e natës, të shkrirë në atë bardhësi të pafund, djali hapi derën e ju hakërrua qenit të ulur në dy këmbët e prasme mbi hasër.

— Shkoi mbas gjyshit!

Qeni besnik tundi disa herë bishtin në shenjë pohimi dhe u zhduk në errësirë.

Xha Zeqoja sa kishte hyrë në rrugën e dhive, që të shpinte lart, kur papritur ju ngatërrua Loloja nëpër këmbë.

— Nga mbive ti, lanet! Kthehu në kasolle! — i tha qenit. Kafsha e ulur mbi borë në dy këmbët e prasme, me bishtin në shalë, qëndronte si trung i prerë nga sëpata. Plakut ju ngrit damari i ballit. Një rrymë avulli nxori nga goja. Ta priste puna, do t'i hynte me një hu Lolos, sa ta linte pa frymë mbi borë.

— Tfu, kafshë e ndyrë! — shau plaku qenin, që tregohej më kokëfortë se nata e trazuar me furtunë dhe çapiti më tej, duke tërhequr qytën e çiftes zvarrë mbi borë. Ecte nëpër gjurmët ende të pambuluara nga bora, të repartit armik, që sa kishte kaluar. Ishin gjurmë çizmësh të rënda, të futura thellë në borë, që plakut i dukej sikur qenë futur në trupin e tij. Shpesh ai qëndronte i kërrusur për të gjetur gjurmat dhe, duke përdorur çiftin në vend të bastunit, zbulonte borën e freskët; kur dora e rrudhur i zhytej thellë, vazhdonte më tej. Më kot Loloja zvarriste noçkën e tij, duke bërë një vijë të re në rrugën e ngushtë të bagëtive, për të gjetur erën. Bora që kishte rënë pa pushim e zvogëlonte shumë shërbimin e tij.

Plaku nxitonte. Dëgjohej vetëm vërshëllima e erës nëpër zgavrat e shkëmbinjve dhe nëpër degët e pemëve, të ulura deri afër tokës nga pesha e rëndë. Tej nga thellësia e pyllit vinte zëri i ngjirur i ndonjë egërsire, që i bënte veshët e qenit të ngriheshin si brirë mëzati. Plaku ecte pa pushim. Duhej arritur para armiqve. Në krye printe qeni e, kur plaku lodhej e mbetej prapa, kthehej si për t'i dhënë guxim duke ecur paralel me të.

Xha Zeqoja shpejtonte. Ai nxitonte duke sjellë vazhdimisht ndër mend fjalën që i kishin çuar nga këshilli i fshatit, nga këshilli nacionalçlirimtar. «Par-

tizanët që mund të ndodhen te kasollja jote, ose lart në Shpellën e zezë, i ka spiunuar djali i Selim agait. Drejt tyre janë nisur forca gjermano-balliste. Të lajmërohen sa më parë. Të largohen nga shpella, ose të marrin masa mbrojtëse. . .» Letra nuk kishte nënshkrim, por plaku e dinte se nga i vinte. Priti më kot mos dukeshin në kasollen e tij të veçuar, në anë të pyllit. Armiqtë kishin ardhur rrotull sa kishin gjetur rrugën e kafshëve për në mal dhe ishin nisur. Pra kishin të dhëna të sigurta, dinin se ku po shkonin.

«Maskarai, mendoj plaku për të birin e agait, mirë thonë, kështu kanë qenë gjithmonë të pasurit, kaci në duart e të huajve. Tfu, lanet paçin!»

Xha Zeqoja kishte vetëm një djalë, Petritin. Sa ishte gëzuar kur e kishte martuar, aq ishte hidhëruar kur i kishte vdekur nusja, duke e lënë djalin me djalë dhe gjyshin me nip. Plaka po mbushte vite të tëra që hante dhe, në një varr aty pas kasolles. I nipi u rrit jetim, pa grua në shtëpi. Djali paradite zbriste në fshat e mblidhej në shkollë me shokët, pasdite bridhte kodrave me dhi. Pastaj filloi lufta.

Petriti një mbrëmje nën dritën e kandilit, kur po binte në shtrat, i kishte thënë i vendosur të atit:

— Do të shkoj në mal me shokët!

Plaku nuk i kishte thënë asnjë fjalë, vetëm kishte thithur çibukun fort, me vështrim të përqëndruar mbi tymin e zjarrit. Tym i kishte shkuar e gjithë jeta në atë kasolle. Kishte shuar kandilin dhe kish rënë, po gjumi nuk e kishte zënë. Thellë në zemër se si i vinte që po i langohej dhe trau i vetëm, që e mbante në këmbë atë kasolle të vjetër, veç nuk kishte folur. Malet gjëmonin nga krismat. Bëhej luftë për jetë a vdekje, për t'u dhënë paqe dhe ngrohtësi

kasolleve. Plaku i kuptonte të gjitha e prapë nuk i kishte thënë me gjithë zemër të birit që të dilte malit. Po Petritit i ishte mbushur mendja top për të dalë partizan, e kishte dalë. Që prej asaj dite plaku ishte mbyllur më shumë në vetëvete dhe ishte bërë më i zymtë se kashta e kasolles. Kujdesej me shpirt për të nipin dhe për ato dy dhi, që vazhdonin të mbanin në këmbë kasollen rrëzë pyllit.

Petriti erdhj disa herë tek i ati. Në vatër ndizej zjarri dhe zihej qumështi, e bashkë me të e me muhabetin e gjatë, ngrohej dhe zemra e plakut.

Xha Zenelit, duke qëndruar pranë zjarrit e duke biseduar me shokët e djalit, i lëvrinte gjaku i paktë ndër damarë kur dëgjonte rojën partizane që bërtiste jashtë kasolles: «Ndal! Kush kalon? Parullën!..» E ndjente veten krenar që ishte zot i kasolles së mbushur me njerëz zemërciltër, që flisnin për ditë të bardha e s'u vinte keq kur jepnin dhe jetën për këto ditë.

Shpeshherë, kur i biri vonohej me partizanët, i dukej sikur era e luginës i sillte në vesh shprehjen e dashur: «Ndal! Kush kalon? Parullën!..» Ngrihej, ndizte çirakun, si për t'u thënë atyre që priste: «Urdhëroni! Kasollja e vogël është e ngrohtë për miqtë e vërtetë...» Pastaj e kuptonte që i bënin veshët, e gëzimi i shuhej ngadalë në fytyrën e rrudhur, siç shuhej drita e çirakut kur frynte era e ftohtë nga lesa e hapur. Sa herë pas kësaj thënjeje kishte krisur pushka.

Kohët e fundit djali nuk ishte dukur. Disa thoshin se e kishin parë në fshatin e afërm, disa të tjerë thoshin se ishte plagosur gjatë një prite që ju bë gjermanëve në rrugën e maqinave, kurse disa të tjerë bënë be e rrufe se e kishin parë andej nga

gërxhet e Skraparit, duke u rënë fashistëve. Plaku e njihete gjakun e tij, prandaj ishte i bindur se kudo që të ndodhej Petriti, nuk do ta turpëronte në pleqëri. E ja, tani i thonë, në atë copë kartë, se shokët e të birit janë në rrezik për t'u rrethuar te Shpella e zezë. . .

I sillte të gjitha këto në mendje dhe nxitonte hapin. Fuqitë po i pritëshin. Ishte tepër plak për të mundur të përpjetën dhe dimrin e egër. Guna i ishte zbardhur nga bora dhe rënduar shumë nga lagështia që kishte thithur. E ndjente të ftohtët deri në palcë. Bora e shkrirë po i depërtonte në trupin e dobësuar më shumë nga kohët se sa nga vitet. Era e përzier me copa bore, që e shtynte nga pas dhe Loloja nuk i ndaheshin. Sytë, të futur thellë në zgavra, me qepalla të zbardhura nga vitet dhe nga bora, rrëshqisnin nëpër rrugën e ngushtë. Qeni nuhaste.

Në shpat, atje ku rruga e ngushtë ndahej më dysh, plaku qëndron, kërruset prapë e bindet që armiqtë kanë shkuar në të djathtë. Më kot qeni leh dhe mundohet ta tërheqë në të djathtë, duke e kapur nga poturet prej shajaku, plaku kthehet në të majtë, ku rruga është më e rrezikshme, por më e shkurtër. Tani e pengon dhe era që i bie në brinjë.

— E shoh që kanë kaluar në të djathtë, po hajde pas meje, lanet — i thotë qenit, dhe vazhdon të ngjitet. Merr frymë me zor, rrëshqet nëpër rrëketë e ngrira dhe prapë ngrihet, i fundoset këmba në borë dhe i humb opinga, përkulet, i fut brenda duart gjysmë të ngrira dhe mezi e gjen. E mbath prapë dhe vazhdon rrugën. Kjo udhë është dhe më e ngushtë. Degët e ngarkuara zgjaten anash si për ta penguar. Ai i mënjanon herë me duar dhe herë me çifte. Nëpër ferra dëgjohet ndonjë mëllenjë e trembur.

Ai e di se duhet të arrijë përpara tyre me çdo kusht, s'ka gjë që e përpjeta i merr frymën dhe të ftohtët po e kërrus më shumë trupin e tij të dërmuar.

Tani duart sikur nuk i ka të tijat, këmbët i bëjnë pllajq-plluq mbi borë. Ato i janë bërë aq të nxehta, sa po shkrijnë dhe borën. Për t'u mbajtur ai kapej pas shkurreve, por nuk kishte fuqi.

Tek po mendonte se si do të shkonte e si do t'i përshëndette, partizance, me një «vdekje fashizmit», si do t'i lajmëronte ashtu me dy fjalë, tek e përfytyronte veten pas shkëmbit, duke luftuar së bashku me çiften e tij, që nuk e kishte lënë asnjëherë në baltë, i rrëshqiti këmba. Duke u rrokullisur tatëpjetë pjerrësisë së shpatit, i erdhi ndër mend kasollja e ngrohtë, ku ishte thinjur e rrudhur. Rrotull oxhakut rrinin miqtë e zemrës. Ja Petriti, ka varur belxhikun me kapelën me yll te gozha e tij në mur. Ai i ndez çibukun të atit, që ka pleksur muhabetin me komisarin. Komisari, i qeshur flet jo, ai nuk flet, por ligjëron për të nesërmen: «Ajo do të shpërthejë si lulet e Luginës së bilbilave në pranverë... Veç lulet duhen vaditur, se për të ardhmen duhet luftuar...» Xha Zenelit po i gumëzhinin veshët nga zëri i njuhur i rojës: «Ndal! Kush kalon? Parullën!...» Ky zë shumëfishohet nëpër shpate e vjen përherë e më i fortë në veshët e plakut.

«Jo, ata nuk do të kalojnë. Në asnjë mënyrë nuk do të arrijnë përpara meje». Hap sytë. Natë. Era ja përplas borën në fytyrë. Hedh sytë rrotull. Ka qëndruar pranë një gëmushe. Lëviz gjymtyrët, ndjen pak dhembje. Kapet nga degët dhe mezi çohet... Fut duart nëpër borë. Diçka kërkon. Diçka i mungon. Po Loloja ku është?

— Ç'u bëre, lanet? — Bërtet plaku, po zëri i është ngjirur, e mezi i dëgjohet. Kafsha se nga del e i shfaqet përpara, e tërheq pas vetes në të përpjetë. Plaku e ndjek. Pesë hapa më lart qeni qëndron e zvarrit noçkën. Plaku e kupton. Merr çiften e mbulluar me borë, e hedh krahut, rregullon gunën, që i rëndon si berr i majmë, dhe vazhdon rrugën. . .

Në qiell nisën të shkrepëtinin yjet që dolën nga retë. Bora pushoi. Plaku me gjithë qenin besnik u nis. Tani e kishte më të vështirë. Ai pushim i mallëkuar, i bërë pa dëshirën e tij, i kishte mpirë trupin. Tani po ngjitej këmbadoras në të përpjetë. Më të ftohta i ishin bërë duart se hekuri i çiftes, e prapë ngjitej. Kur arriti në afërsi të shpellës, sfondi shkëmbor i saj ju duk si shqiponjë gati për fluturim. Nga buza e malit doli hëna. Rrezet e saj binin dhe reflektoheshin në atë bardhësi pa fund. Një buzëqeshje triumfuese u duk në fytyrën e rrudhur, veç kjo nuk zgjati shumë. Plakut ju duk sikur në të djathtë tringjet e pishave po lëviznin drejt shpellës. Priti pak pa marrë frymë. Si njeri i maleve, ai kuptoi gjithshka. Të dy palët kishin arritur në të njëjtën kohë në vendin e caktuar. Kjo bëri t'i dridhej i gjithë trupi (çdo qelizë e tij, që nga këmbët e enjtura e deri te shpina e kërrusur dhe e dërmuar. Qeni i vinte vërdallë dhe e tërhiqte në drejtim të hijeve që lëviznin, po plaku nuk ju hakërrua si zakonisht: «Pusho, lanet!» Tani ndërroi mendje për kafshën e pafajshme, veç kësaj, fjalët mund të sillnin dështimin e gjithë këtij mudi. Duhej vepruar pa humbur kohë, po xha Zeqoja nuk kishte më fuqi të qëndronte më këmbë dhe jo të ecte më tej. Edhe sikur të kishte këmbë të çlodhura djali, prapë gjermanët do të arrinin më parë, se qenë më afër shpellës.

U mat t'i sulej hijes së parë, me shpresë se mos ishte trupi i tradhëtarit, t'i futte dhëmbët në grykë për të nxjerrë një pjesë të dufit, po ishte gjë që s'bëhej.

U fsheh pas shkëmbit, uli sigurecën dhe vuri në shenjë njërën nga hijet, tërhoqi këmbëzën, por në vend të krismës së njohur, u dëgjua një «shkrap» e shurdhër. Lagështia kishte bërë të sajën nëpër kapsolla. Provoi fishekë të tjerë prej gjerdanit, si nga ata që përdorte për derra si ashtu edhe nga të zakonshmit, po përfundimi ishte i njëjtë.

Xha Zenelit ju ngritën përpjetë flokët e thinjur. I dukej sikur mori fund gjitnshka, sikur kope ujqish po futeshin në vathë, e kasollja e ngrohtë po përpëlitej nga flakët. Ata do të arrinin më përpara në shpellë. Të mësuar me dhelpëri, do ta zhduknin me ndonjë mënyrë rojën e pastaj... Ta zhduknin thua?! Po kur vinin në kasollen e tij as Loloja nuk hynte brenda pa u diktuar nga roja, as Loloja që dinte sa furka kishte lesa. «Jo, s'është aq kollaj, mendonte. «Ai që ka kapur dyfekun në dorë e ka dalë malit, duhet të ruajë veten dhe shokët, se jeta nuk i takon vetëm atij. I takon në radhë të parë çështjes sonë të madhe», thoshte komisari. Po unë ç'kam bërë deri tani për luftën tonë? Ç'kam bërë?»

Hoqi gunën nga supi dhe e flaku në borë; kapi çiften dhe çapiti prapë përpara. Krahavori i digjte si furrë. Tani vetëm disa dhjetëra hapa e ndanin nga shpella, e po aq larg saj ndodheshin dhe armiqtë. Aty në kulmin e zemërimit, u kthye nga shpella për t'u thënë partizanëve: «Kaq pata mundësi, djema. Bjeruni tani dushmanëve». U kthye nga hijet që po i afroheshin shpellës, vuri duart e rrudhura si hinkë në gojë dhe bërtiti me zërin e ngjirur:

— Ndal! Kush kalon? Parullën!..

Jehona e zërit të shumëfishuar poshtë nëpër shpate prishi qetësinë e natës. Askush nuk ju përgjegj përveç jehonës nga monopatet dhe shpellat. Plaku e përsëriti dhe një herë parullën e dëgjuar nga roja partizane, te kasollja e tij:

— Ndal! Kush... — Një breshëri automatiku të huaj, e zgjatur si rënkim i pyllit, ja la në mes. Plumbat gjurmëlënës shkundën borën në degën e pishës para xha Zeqos dhe u shuan në gjoksin e tij. Plaku u rrëzua me fytyrë nga drita e hënës. Qyta e çiftes u ngul mbi borë, e ashtu me grykë lart si shtizë flammuri, lëshonte hije mbi fytyrën e tij të rrudhur. Qeni ulërinte si i tërbuar dhe vinte rrotull të zotit. Ende nuk kishte dhënë shpirt, kur dhjetëra krisma pushkësh dhe thirrja «Para partizanë!» ju përgjegjën breshërisë së automatikut. Plaku po jetonte çastet e fundit. «E thoshte komisari. Ai që ka kapur dyfekun në dorë...» I dukej sikur ende bisedonte me shokët e djalit. Me buzëqeshje mbylli sytë. Ashtu e gjetën partizanët në mëngjez. Në njërin dorë të gjakosur shtrëngonte letrën, ndërsa me tjetrën ishte përpjekur të kapte çiften, që i bënte roje në këmbë.

NË LUGINËN E FTOHTË

... Ushtarët shqiptarë, të dërguar me forcë nga fashistët italianë në frontin grek nuk pranuan të luftonin dhe dezertuan në masë...

Dita ishte e kthjellët. Dielli i tetorit ende nuk e kishte humbur forcën ngrohëse. Në lulishten e re të qytetit të vjetër një grup pensionistësh, ulur nëpër stolat e drunjtë, pinin duhan dhe kujtonin shokët, luftërat, ngjarje nga jeta e tyre. Më pëlqente t'i shkoja pas në orët e lira xhaxhait për të mësuar histori nga jeta e madhe e këtyre njerëzve.

Muhabeti ishte ndezur, tymi i duhanit zhdukej në masën e ajrit, ndërsa cigaret zëvendësonin njëra-tjetrën. Më pak fliste një burrë i thyer, me fytyrë të vrazhdë e me bastun, që erdhi i fundit në lulishte, duke tërhequr njëren këmbë zvarrë.

— Mirë se rrini shokë! — u dëgjua një zë i fortë nga rruga. Kokët tona u drejtuan andej. Një burrë me trup të shkurtër e fytyrë të hequr na buzëqeshi. Mollëzat eshtërore spikatnin në fytyrën e tij. Flokët e dendur i kishte të zbardhur. Burrit me fytyrë të

vrazhdë i shkëlqeu fytyra. U mbështet te bastuni për t'u ngritur e ju përgjegj atij që përshëndeti nga rruga:

— Urdhëro, Arin! Hajde, se për kohën e luftës po flasim!

— Po shkoj në komitet për disa rrjeta peshkimi. Një herë tjetër. — Mirë u pafshim! — u tha Arini dhe ngau hapat.

— Është i fortë njeriu — na tha burri që tërhiqte këmbën zvarrë. Ja, ky, Arini. Fashistët e detyruan të ngrinte armën kundër shokut të ngushtë, vuajti shumë, por...

— Si, vërtet ka qëlluar kundër shokut. Tregoni, ju lutem — i thashë i rrëmbyer nga emocioni rinor për të mësuar gjithshka. Të gjithë të pranishmit ngritën sytë nga burri me bastun, që tërhiqte njëren këmbë zvarrë.

— U ndodha në vend. Ata ishin dy. Jo, ne ishim shumë, po le të flas për ata dy. Miqësia e lindur në brazat e tokës së hapur nga parmenda dhe e kalitur në luftë me dallgët e detit është e fortë — nisi të thoshte burri invalid. Thithi prapë cigaren dhe për disa çaste humbi nëpër tymin e duhanit:

2

... Çadrat tona ishin në radhë njëra pas tjetrës, e radhët të futura si pyka në gjoks të luginës, nuk kapeshin dot nga sytë e pilotëve. Atë ditë ra shi i madh. Pastaj retë e zeza morën arratinë nga era duke u fërkuar në kurrizet e maleve të zbardhura. Toka ishte zbutur si tul. Lotonin degët e pemëve,

herë duke lëshuar pika të dendura shiu, herë fletë të zverdhura të rënduara nga uji. Nga Jugu dëgjohe-
shin gjësimet e dendura të artilerisë. Ne e kishim
të vështirë t'i dallonim nga bubullimat, kurse ata të
pikës së vrojtimit, vendosur në majën e kodrës në
jugë e kishin kollaj. Nëpër rrjetën e instrumentave
të zbulimit të tyre dendësoheshin përherë e më shu-
më plasjet e predhave.

Lugina frynte, po djersët tona përthaheshin ve-
tëm pas disa minutash pasi mbaronte stërvitja inten-
sive. Pregatitja e kompanisë sonë, e përbërë vetëm
prej shqiptarësh, po shkonte drejt përfundimit. E siç
ndodh në ushtri, që, pas shkollës së shënimit kalohet
në qitje luftarake, edhe për ne po afrohej koha e
hedhjes në luftë, në kasaphanën me grekët. Deri tani
kishim kaluar vetëm shqetësimet e demave toreadorë
gjatë stërvitjes në stadiumin e zbrazur, për së shpejti
prisnim shfaqjen e madhe ku do të vriteshim nga
shigjetat, e publiku do të gajasej duke parë gjakun
tonë. Askujt nuk i pëlqente një vdekje e tillë. E ki-
shte nga ata që këputnin zinxhirët me brirët e fu-
qishëm e ja mbathin fushave e kodrave.

Çadra e majorit fashist, që komandonte forcat e
bashkuara, ishte në krye të luginës, pak e veçuar,
nën një gërshetim të dendur me degë pemësh. Ai po
pinte çaj e po dëgjonte i kënaqur një serenatë napolitane,
kur, po i sillnin ata të dy. Disku gramafonit
rrotullohej, e zëri i ëmbël i këngëtarit përhapej lu-
ginës. Ne na gërvishte nervat kjo muzikë e preferuar
e majorit.

Të dy shokët tanë, të çarmatosur, ecnin duarli-
dhur e kokëlart të mbikqyrur nga një roje këmishë-
zinjsh të armatosur. Duart brenda zinxhirëve të he-
kurt i mbanin grusht. Unë i njihja si veten time, të

dy. Jo, nuk i njihja mirë. Edhe ata, edhe veten më vonë i njoha.

Në të djathtë ecte Safeti, i gjatë, me shpatulla të gjera e trup të drejtë. Në të majtë Arini, pak më i shkurtër, me trup të lidhur e qafë si demi. Këmbët e tij të fuqishme dukeshin si copa shtyllash hekuri këputur nga direku i anijes. Nëpër vrimat e xhaketave të grisura shquheshin vijat e bardh e zi të karnatiereve marinare. Shoqëronim me sy shokët e arrestuar e mendonim për ta e për veten. Asnjëri nuk desh të humbte si gjurmët në rrëke. Vërtet u vranë disa nga shokët tanë më 7 Prill, po varret e tyre mbetën si gjurmët e luftës sonë... Secili mendonte për familjen, për tokën që la pa mbjellë, për atdheun. Mos harrojmë se ishte vjeshtë si tani, e toka priste parmendën, kopeja me qengjat e parë bariun, e fëmija babain...

Sa hyjnë në çadrën e majorit, serenata u ndërpre menjëherë.

— O, mirë se erdhët! Ju prisja — tha majori me një zë ironik. Pastaj shtyu me bërryl gotën e çajit, hapi plikon që i zgjati përgjegjësi i rojes së shoqërimit, vuri syzet, i hodhi një sy të shpejtë letrës dhe u kthye nga të dy njerëzit e lidhur. Menjëherë nxori krehërin nga xhepi dhe e kaloi disa herë nëpër flokët tërë brilantinë, që u puthitën mirë pas kafkës së vogël, ndërsa vazhdonte me të njëjtin ton:

— Në s'gabohemi Safet Shkoza me mikun e tij Arinin, dezertorë nga radhët e ushtrisë së pathyeshme të Duçes?

Ai e shoqëroi pyetjen e tij me një gjest në drejtim të portretit të varur në krye të çadrës, ku koka e madhe e mbuluar me helmetë zinte vendin kryesor të portretit. Për t'u dhënë më tepër rëndësi fjalëve,

u ngrit në këmbë. Përkthyesi, një rreshter kalabrez, që më vonë u bashkua me forcat partizane, sa dëgjoi emrin e prijësit, u ngrit me përtesë dhe përktheu fjalët e majorit.

Majori nisi të lëviste poshtë e lart në atë vend të ngushtë, brenda çadrës. Herë pas here kthente sytë e vegjël nga dy shqiptarët që rrinin para tij. Roja e shërbimit solli nga kuzhina një mangall me prush.

— Mirë! Bukur fort! Po çfarë ju shtyu që t'i binit së mirës me shqelm? Të arratiseni nga lavdia e të shkoni te plumbi ballit?.. U ul përballë tyre. I binte tryezës me gishtin e hollë, sikur të kishte ndonjë piano përpara. Ushtarët po këndonin një këngë të re aty jashtë, grumbull rreth zjarrit. Në çadrën e majorit vinin fjalët e shkëputura të saj «Netët do t'i kalojmë në kabaretë e Athinës»... Ritmi i lëvizjes së gishtërinjve përputhej me ritmin e këngës. — Mirë! Bukur fort, po çfarë ju shtyu? — përsëriti prapë majori.

— Ne jemi detarë, zoti major, kurse ju na mobilizuat në këmbësori. Nuk i shkojnë detarit këmballet, e aq më tepër nuk di të luftojë në tokë — u përgjegj i qetë Safeti.

— Shih, shih? E paskemi ne fajin. «Detarët nuk ditkan të luftojnë në tokë» — i tha përkthyesit dhe i bëri shenjë që të mos e përkthente. Me nofulla të shtrënguara, e me fytyrë të verdhë dyllë u kthye prapë nga të arrestuarit. U përpoq të mbante gjakftohtësinë. — Të dhënat që kemi këtu — vuri dorën mbi pliko — jua hedhin poshtë këtë teori. Në shpatullat e majta keni një plagë. Është plagë plumbi, e bërë më 7 Prill, kur ju na luftonit nga pozicionet tokësore, apo e kam gabim — tha majori duke ju drejt-

tuar Safetit dhe i shtyu plikon e porsaardhur për-kthyesit që ta hapte, po ta lypte nevoja, më vonë.

— Jo, nuk e mohojmë, ndryshe do të mohonim vetëveten, veç ajo është tjetër luftë. Ju erdhët pa ftuar, ndaj e gjetët shqiptarçe shtruar — u përgjegj Safeti.

— Jepni përgjegje të goditura, djalosh, por në veprime jeni treguar dy herë i trashë, ose më mirë të themi armik i vetes. Në prillin e vitit të kaluar mbreti juaj ua mbathi, oficerët e lartë ishin me ne. Armë nuk kishit. Pse, i bihet murit me kokë? Kurse tani edhe më keq. Qeveria e Tiranës...

— Edhe tani qeveria e Tiranës është me ju, po ne u arratisëm. Të tjerë para nesh janë arratisur, të tjerë pas nesh do të arratisen. Nuk lufton shqiptari më për interesa të huaja, si në kohën e pashallarëve të Turqisë. Erdhën kohë të reja e njerëzit mendojnë sipas kohëve. Qeveritë borgjeze vërtet shpallin luftë, por popujt i mbajnë në kurriz — e ndërpreu Safeti përkthyesin që tregohej i përpiktë. Duart po i dhembnin nga hekurat e shtrënguar. Sytë po i lëshonin shkëndija. Gjithë trupi i dridhej. Dësh t'ja përplaste të gjitha menjëherë majorit. Po majori nuk nxitonte. Nga Jugu vinte gjëmimi i dendur i artilerisë. Kishte marrë lajmin se grekët po përparonin. Më mirë në çadër pranë mangallit me dy të lidhur përpara, se sa në mes të bajonetave greke.

— Me kokëfortësinë tuaj morët veten më qafë dhe gjithashtu prishët edhe shokun. Ju e keni gënjyer, për ne ai s'ka faj. — Si tha këto majori ju drejtua njërit prej rojeve shoqëruese.

— Hiqeni këtë tjetrin, Arin e quajnë dhe shpjereni në kuzhinë. Ai ka të ftohtë dhe uri. — Përkthyesi bëri detyrën. Roja zhvidhosi prangat, hoqi

atë anë të zinxhirit që lidhte duart e Arinit dhe e shtyu këtë drejt daljes. Arini nuk lëvizi prej vendit. Këmbët e gjata e të forta si prej hekuri ishin mbërthyer fort pas tokës. Ngrii sytë e mjegulluar mbi fytyrën e tjetrit, që nuk lëviste as qepallat. Mendoi hatanë e madhe; gëlltiti lotët e i hypi gjaku në kokë. U kthye nga majori dhe ja plasi në fytyrë.

— Vërtet secili ka kokën e tij mbi supe dhe vepron sipas saj, po ne jemi shokë. Kemi luftuar të dy kundër jush dhe po bashkë jemi arratisur. Fajin e kemi njësoj. Prandaj s'ka forcë që të na ndajë për së gjalli.

— Flet nga emocioni që shpëtoi. E njoh mirë psikologjinë e këtyre tipave — i tha eprori përkthyesit. Me vështrim nëpër të çarën e çadrës, ku rrinin varur një tufë resh të zeza, qëndroi për disa çaste. Mendja i bluante plane të errta. U kthye prapë nga përkthyesi dhe vazhdoi:

— U thuaj të dyve se ne i dimë punët e tyre më mirë se ata. — Përkthyesi e përktheu deri në fund. Dy roje kapën me forcë Arinin dhe e tërhoqën zvarrë jashtë çadrës. Më kot mendohej të kundërshtonte. Në fund arritën ta nxirrnin jashtë, pa i dhënë rëndësi bërtitjeve të tij.

— Safet! Vëlla, po na ndajnë për së gjalli, që i ndaftë peshkaqeni në mes!

Majori përplasi gishtërinjtë mbi tryezë. Ai i gëzohej suksesit. Melodia e këngës dëgjohej përherë e më e qartë.

— E dëgjoni? Ata do të kalojnë natën në kabaretë e Athinës, ndërsa për ju do të hapen dy metra dhe! — tha majori. Safeti qeshi me të madhe e, duke qeshur ju përgjegj:

— Pse ëndërroni si qentë në hënëz që t'ju bien.

thela nga qielli. Ju vetë e kuptoni se luftën me grekët e humbët, para se ta nisnit mirë.

— Mbylle gojën, komunist kokëngjeshur! — bërtiti majori në gjuhën e tij dhe u ngrit pasi goditi me forcë tryezën me gishtërinjtë delikatë të mbledhur grusht. Hunda ju skuq; damarët anës qafës së hollë ju përdrodhën si këlyshë gjarpërinjsh. Do të ta mbyllim ne, me plumba, në mënyrë të tillë që ta mbajnë mend edhe fëmijët e fëmijëve të tu. Merreni qenin — ju hakërrua dhe rojës. Duart e mbështetura mbi tryezë i dridheshin nga nervozizmi.

Thirri shefin e shtabit, priftin dhe mjekun e regjimentit. Të katër biseduan gjatë rrotull tryezës katrore.

— Hi-hi-hi — qeshi prifti me të madhe duke fërkuar mjekrën e rruar.

— Kështu i vrasim të dy dhe u japim një mësim të mirë shqiptarëve sa, kur të dëgjojnë tjetër herë fjalën «arratisje», t'u dridhet foshnja në bark të nënave — përfundoi majori.

— Po në qoftë se nuk bindet? — ndërhyri për-kthyesi i caktuar në grupin e mësipërm për përpunimin e planit.

— Të thotë «jam dakord», as mos prisni nga ai tip. Njerëzit duhet të kuptohen nga mimika. Atë që ndjen zemra, po nuk e tha goja, e tregon fytyra. Mos harroni se jeta është e shtrenjtë. Megjithatë, po nuk u bind, do ta bindim. Shkoni tek Arini dhe vërgjuni punës. Nesër, kur ta ketë mendjen top, ma dërgoni mua — tha majori dhe u ngrit për t'u dhënë të kuptonin se biseda kishte marrë fund.

Atë natë asnjëri nuk mbylli sy. Të nesërmen pasdite ishte caktuar ora e sulmit. Gjithashtu të dy shokët tanë nesër me siguri do të viheshin në plumb.

Është e madhe humbja e shokut. Të dhëmb njësoj sikur kirurgu të heq pa narkozë pjesë nga trupi yt. . .

3

Në kampin ushtarak të fushimit kishte rënë qetësia, një qetësi e rreme që i ngjan sipërfaqes së Detit të Vdekur, që nga jashtë është e lëmuar kurse për brenda kalojnë rryma të fuqishme, të zonjat për të mbytur edhe anije moderne. Dëgjoheshin vetëm hapat e rojeve, të përforcuara, mbi tokën e ngopur. Ne i ndjenim si dhembjen tonë ata hapa dhe e kuptonim se majori kishte dhënë urdhër për dyfishimin e rojeve. Rojet atë kohë kishin detyra të dyfishta. Ruanin nga jashtë, por ruanin edhe nga brenda.

Dera e çadrës sonë ishte e hapur, prej andej dukej një copë qiell. Ja, u këput një yll e mori të tatëpjetën andej nga Jugu si për të lajmëruar grekët për sulmin e nesërm. Sa yje të tilla do të bien?

Hëna e mbështjellë me ca re të copëtuara si fasha të gjakosura ngjante me midhjet e detit kur u heq lëvozhgën.

Nëpër çadrat tona fenerët me vajguri nuk ishin shuar ende. Dikush shkruante letrën e fundit që do ta hidhte në postën ushtarake. Dikush rënkonte nga lodhja e stërvitjes së gjatë e të rëndë taktike të zhvilluar gjatë ditës, dikush tjetër sytë me qepalla të rënduara i ka përqëndruar në një pikë dhe përpiqet të parafytyrojë të ardhmen. Rrugët tona ishin të lidhura me rrugën e atdheut. Jo, robëria nuk mund të jetë e përjetshme, ashtu siç nuk janë edhe ata që na e kanë sjellë atë.

Të nesërmen të dy shokët tanë i priste plumbi.

Edhe ata, edhe ne mendonim për të nesërmen. Leka me fytyrë nga drita e hënës shtrëngonte dhëmbët. Ai ishte kryetari ynë. Ai na ushqente me idetë e luftës së padrejtë me popullin grek. Ai na kishte treguar rrugën e arratisjes, po jo ashtu si veproi Safeti me Arinin.

— Jo, nuk duhet ta lejojmë. Më mirë të vdesim me armë «në dorë» këtu, se sa në fushë të luftës së padrejtë... — thoshte Leka.

— Atëhere siç biseduam, nesër në kohën e pushkatimit... — i thashë dhe prita. Fjala e tij ishte, si të thuash, ligj për ne.

— Ashtu e lëmë. Ti lajmëro me kujdes shokët e besuar të togës së dytë e të tretë. Shenjën e hakmarrjes do ta jap unë.

— Të shkoj që tani. Unë i njoh njerëzit e besuar — i thashë dhe u ngrita. Leka më zuri me duart e fuqishme dhe më uli.

— Në asnjë mënyrë tani natën. Rojet jashtë qëllojnë pa paralajmërim. Nesër i lajmërojmë. — Si tha këto, e treti vështrimin nga hyrja e çadrës, tej në copën e qiellit ku disa yje, se shumicën e kishin zënë retë, soditnin kampin e shqetësuar. — Ja ç'them unë. Duhet thënë në kampin e armatosur. Ne nuk i kishim armët me municione, të nesërmen do t'i merrnim, po ishin armatosur me qëllimin tonë të madh për të bojkotuar këtë luftë të padrejtë.

Në agimin e ditës së nesërme kompaninë tonë, të përbërë vetëm prej shqiptarësh, e rrjeshtuan pa armë mbi barin e tharë nga të ftohtët, në mes të lu-

ginës. Malet e veshura me gunën e bardhë që ngriheshin në të dy anët dukeshin sikur na dërgonin buzëqeshjet e tyre të rrudhura. Në të majtë dukej, porsì një e çarë, përroi, nga rridhte një ujë i pastër burimi. Përroi humbte diku në Veri përtej horizontit. Në anën e majtë, pylli i dendur dukej si një copë e gjelbër, arnuar në gunën e bardhë të malit.

Secili prej nesh e shihte qëllimin e rrjeshtimit. Ne për t'u pregatitur, bëmë planin tonë, por ata nuk na i dhanë armët. Secili vriste mendjen për skenën e afërt, veç nuk mund të pëshpëritnim. Spiunët fashistë rrinin rrotull dhe nuhatnin e, aty ku ka spiunë, ka tradhëti e vdekje të parakohshme. Pranim të sillnin dy shokët, kur pamë vetëm Safetin që ecte me kokën lart dhe me duart e lidhura në mes të ushtarëve fashistë, që mbanin gishtat në këmbëzën e automatikut. Era e luginës i përkëdhelte flokët mbi ballin e gjerë. Na pa ashtu të rrjeshtuar, na buzëqeshi dhe qëndroi te vendi, disa metra para bokërinës e po aq larg nga ne. S'e kishte xhaketën. Kanatierja me vija, në shumë vende e gjakosur dhe e grisur, i rrinte pas trupit të bëshëm. Një oficer fashist desh t'i lidhte sytë. Safeti e largoi kokën me neveri nga shamia.

Pas kompanisë sonë erdhi një skuadër fashiste e armatosur me automatikë dhe një mitraloz «Breda». «Janë për ne», mendova dhe shtrëngova dhëmbët nga inati.

Doli suita e majorit. Në krye vetë ai, në të djathtë shefi i shtabit, e në të majtë prifti. Pas vinte doktori e një ushtar këmishëzi, që mbante një pushkë të gjatë snajpere në krahë. Bisedonin në gjuhën e tyre dhe qeshnin me të madhe.

Leka, që ndodhej në mes të togës sonë, nga i cili hidhnim sytë vazhdimisht, dha shenjën që të mos

e zbatonim atë që kishin vendosur në natën e shkuar, bashkërisht. M'u duk vendim i drejtë. Pse ta jepnim jetën kot kur nuk nxirrnim gjë, në një kohë kur jeta jonë i duhej luftës së ardhshme kundër fashizmit!

Siç dukej çdo gjë ishte bërë me plan. Pse nuk po fillonin?! Pse nuk po mbaronte një orë e më parë kjo skenë torturuese. Dukej se dhe torturimi ynë bënte pjesë në planin e majorit.

Më në fund doli përpara prifti me përkthyesin. Zëri i priftit, i trashë e i zgjatur, u përhap në luginë dhe më pas zëri i përkthyesit.

— Mos besoni në miqësinë e përjetshme! Tradhëtia ka sjellë tragjedi ndërmjet miqve dhe shokëve, si një e keqe e madhe e dërguar prej zotit. Çezarin e pathyer e vrau Bruti me Kasin. Khani vrau vëllain e gjakut. Laerti vrau shokun e ngushtë, Hamletin... Ne kemi përpara dezertorin Safet Shkoza. Atë do ta pushkatojë shoku i tij, Arini, i cili e kupton gabimin e nuk ngarkohet me asnjë faj... Kështu do ta pësojnë të gjithë ata që thyejnë betimin e shkojnë kundër zotit...

— Duçen do ta pushkatojnë italianët, se edhe Krishtin shokët e kryqëzuan — u dëgjua një zë nga radhët tona. Nuk patën jehonë këto fjalë, se vëmendja e të gjithëve ishte përqëndruar te trupi i fortë i Arinit që sa po dilte nga çadra. Ishte veshur me rroba të reja ushtarake. Mbi supe i shkëlqenin gradat e rreshterit, veç fytyrën e kishte si të lyer me gëlqere. Ngjante si kufomë. Siç duket nuk kishte vënë gjumë në sy tërë natën. Pastaj vinin dy ushtarë dhe një marshall, të tre të paarmatosur. Vetë Arini mbante një patickë të shkurtër në krahë. «S'është e mundur të ndodhë kjo. S'mund ta bëjë këtë Arini ynë», këtë mendoja. M'u nxi fytyra. Shihnim njëri-tjetrin si

egërsira të lidhura, pastaj ulnim sytë mbi barin e shkelur nga këpucët me gozhdë. Çdo gjë e prisnim nga fashistët, po kjo po i kalonte kufitë.

Arini qëndronte përballë Safetit, te vendi që i t'hanë. Vështrimet e të dy shokëve u kryqëzuan për një çast. Kush mund ta dinte se çfarë shprehnin ato vështrime? Me sy merren vesh shokët, por kuptohen edhe armiqtë. Ne i njihnim për shokë. E shoqëria e brumosur nën breshërinë e plumbave nuk mund të shuhet kështu shpejt, si shkumë valësh. Para nesh qëndronin dy njerëz që bisedonin me njëri-tjetrin në heshtje. Safeti duarlidhur në vendin e ekzekutimit, Arini me armë në dorë përpara tij. Arini hoqi vështrimin nga shokët dhe pa me bisht të syrit majtas e djathtas sikur të kërkonte dikë tjetër. Majori me suitën e tij e ndiqte me interesim skenën dhe gajasej së qeshuri. Sytë tanë bridhnin sa te Safeti, Arini dhe drejt majorit. Vetëm një hap pas Arinit rrinin tre trupa të zgjedhur fashistë. Arinit i dridheshin duart mbi patickën e shkurtër, të fuqishme, të kalitura mbi rema.

Marshalli u shkëput nga treshja dhe i zgjati Arini tre fishekë.

— Qëlllo pa frikë, Arin! Është e ëmbël vdekja nga duart e shokut! — tha Safeti me zë të lartë. Dikush nga ne kërciste dhëmbët, një tjetër gëlltiti lotët. Bashkë me lotët na vërshonte dhe urrejti e madhe.

Arini mbushi pushkën. Tani nuk i dridheshin më duart, ende nuk shënonte. Skuadra e automatikëve kishte marrë armët në gjoks. Mitralieri tani pas kompanisë sonë kishte vendosur shiritin në gojën e ushqimit.

— Mbi dezertorin, zjarr! — u dëgjua zëri i përthyesit.

Arini vazhdonte të qëndronte si i ngrirë me armën tytëlart. Mbi kokët tona fluturoi një shqiponjë. Rrahu krahët, erdhi disa herë rrotull e u zhduk drejt majës së zbardhur të malit. Safeti e shoqëroi shqiponjën sa u largua, pastaj u drejtua nga suita.

— Kot e keni, zoti major! Në det nuk është dëgjuar ende që pulëbardha të hajë pulëbardhën. Caktoni më mirë një këmishëzi të mbarojë punë shpejt! — Heshtje. Leka e bëri gjak buzën e sipërme. Mua s'më rrihej. Dy herë mendove t'i hidhesha ndonjerit në grykë, por m'u kujtua Leka, disiplina, fjala e dhënë.

— Qëlllo, Arin, qëlllo, vëlla, siç qëllonim bashkë në prill të 39-ës kundër fashistëve. Sidoqoftë një tjetër do ta bëjë këtë. Njëqind herë më mirë të vdesësh nga dora e shokut. Veç mos harro t'u thuash të mive në fshat si vdiqa. — Zëri i tij përhapej luginës si bori që na thërriste për rrjeshtim. Sa më shumë fliste Safeti, aq më shumë uleshin kokët tona. Nga lindja nisi të përflakej. Mali i zbardhur po shfaqej para luginës me tërë madhështinë e tij. Ne shikonim drejt malit siç vështrojnë shqiponjat krahëlidhura drejt viseve të shtrenjta.

— Na hedhin në kasaphanë kundër një vendi kufitar që mbron lirinë e tij. Fashizmi është armiku ynë i përbashkët. Kundër tij duhen drejtuar armët tona... — fliste Safeti.

Fytyra e majorit, ashtu verdhacuke, si e një njeriu që vuan nga ulçera, egërsohej përherë e më tepër. Sa herë që përkthyesi zgjatej drejt veshit të tij dhe bënte detyrën me zell, majori përpiqej të zgërdhihej, pastaj i zhdukej nënqeshja nga buzët e holla e, duke u anuar tej, mundohej të mos i dëgjonte fjalët e Safetit. Përkthyesi u shkëput prapë nga suita e bërtiti me zë të fortë:

— Zjarr! zjarr, mbi dezertorin!

Arini ngriti më në fund armën dhe me një rrotullim të shpejtë e shkrepri në drejtim të majorit. E shkrepri kur e kishin kapur nga prapa fashistët. Ne, që u ndodhëm afër, dëgjuam shkrepjen e shurdhër të patickës së tij. Në të njëjtën kohë, nën gajasjet hysterike të majorit, shefi shtabit shtyu me bërryl snajperin. Pra çdo veprim ishte parashikuar e shkonte sipas planit të tyre.

— Rroftë liria! Rroftë!.. Një tufë zogjsh fluturuan të trembur. Fjalët e Safetit u prenë në mes. Ai ra në drejtim të Arinit sikur të donte që me trupin e tij të zvogëlonte distancën që e ndante nga shoku.

Majori lëvizi disa herë dorën e futur në dorashkat prej meshine për të mënjeluar tymin e barutit. Ushtari fashist hodhi pushkën snajpere në krah. E gjithë suita mbante duart në ije nga gazi.

Arini u hutua, nuk e kuptoi që i kishin dhënë fishek fals, ju duk se krisma e snajperit ishte e tija. Ai pa shokun e rënë dhe dha një britmë sa u tund lugina, flaku pushkën, u shkëput nga duart e fashistëve dhe u sul drejt kufomës. Qëndroi. U kthye nga ne dhe ja dha një të qeshure të papërmbajtur.

Ne na u rrëqeth mishtë. Fytyra ju nxi si re e ngarkuar. Sytë i dolën jashtë zgavrave. Flokët ju ngritën lart. Hapi gishtërinjtë dhe po i shihte me kujdes. Ngjante si ari i egërsuar. Me atë pamje bërtiti: — Unë e vrava Safetin. Ja, kam duart me gjak. Është gjaku i shokut tim. . . — U lëshua drejt kufomës, sikur do ta shqyente. . .

— Ç'rriini si spektatorë. Ky është. . . kulmi. . . Kjo nuk durohet! — bërtiti njëri nga rrjeshtat e fundit. Atëhere pashë nga Leka. Damari i ballit i ishte

ngritur, nofullat i kërcisnin sikur po bluante plumba me dhëmbë. Ai vështrim e bëri të heshtte shokun e revoltuar. Prapë qetësi. Dëgjoheshin vetëm qeshjet e majorit që po largohej dhe të suitës së tij. Andej u shkëput doktori dhe ju afrua dy të vrarëve. Pastaj, si një njeri që ka shpënë deri në fund detyrën, ju kthye t'i raportonte eprorit. Deri te ne u dëgjuan fjalët e tij të ftohta metalike.

— I pari i vdekur, i dyti kaloi në gjendje relative.

— Në këtë mënyrë ne nuk vramë vetëm dy veta, — tha majori — por gjithë shqiptarët. Kur të dëgjojë ndonjëri prej tyre fjalën «arratisje», do t'i dridhet dhe foshnja në bark të nënës nga frika. — Tha këto dhe i ktheu shpinën skenës së organizuar me aq kujdes. Të tjerët i shkuan pas. Ne ende nuk po na shpërndanin. — Të dytit mos i bëni gjë. Më mirë të vuajë ashtu — tha majori në ecje e sipër.

Arini i përkulur mbi kufomën e shokut ngrinte duart, hapte gishtërimjtë e shikonte me kujdes, pastaj i përplaste me forcë në tokë dhe i fshinte fort nëpër bar. Më në fund mori kufomën e shokut në krah, pa anash se mos e ndiqte njeri dhe u dha këmbëve, poshtë luginës. Sa kaloi para rrjeshtit tonë, nxitoi me të shpejtë, duke e parë kufomën me frikë e tmerr. Më tej, afër një grupi fashistësh, u rrëzua me gjithë kufomën. Vuri gishtin në buzë dhe tha:

— Shët!! Fle Safeti im. Mos e zgjoni!... — Një marshall qeshi me të madhe, disa e pasuan, kurse një pjesë uli kokën.

E mori prapë në krah e, duke shkuar majtas e djathtas se mos e ndiqnin e ja merrnin, u zhduk e humbi mes shqopave dhe mareve.

Ne e pamë të gjithë këtë skenë, ashtu të vre-

rosur më tepër se qielli. Secili bënte betimin e tij në heshtje aty përpara gjakut të ngrirë të Safetit e përpara qeshjeve të papërmbajtura të Arinit.

Ra boria për t'u shpërndarë e për t'u përgatitur për sulmin e afërt.

5

Pasdite lamë pas luginën e ftohtë dhe çadrat tonë. Me vete morëm pushkët dhe urrejtjen e madhe. Qëndruam nëpër llogoret e vijës së parë e prisnim raketën e kuqe. Hidhnim shpesh sytë nga malet, siç bëjnë shqiponjat kur janë gati për fluturim drejt viseve të tyre. Tani kishim pushkë e fishekë, kishim krahë të zgjidhur, veç fluturimi duhej bërë me kujdes, se shqiponja mund të goditet dhe në ajër. Përrreth krahët e maleve mbulonin dhe zbulonin njëri-tjetrin, ndërsa majat ashtu të heshtura e madhështore, sikur na jepnin shembull qëndrese e burrërie. Gjëmimi i artilerisë ishte i afërt. Tani dukeshin jo vetëm këpurdhat e plasjeve rreth nesh, por edhe flaka e barutit, aty pas vijës mbrojtëse të grekëve, kur shtynin dhe u jepnin shpejtësi predhave. Ca nga retë mbi kokë, e ca nga koha, mugëtira po përhapej në vijën e parë.

Ja dhe raketa e kuqe! Si një pikëçuditëse e madhe mbi urdhërin e luftimit shkruar me germa të dendura, të kuqe, bëri harkun dhe ra. Ne u ngritëm me përtesë duke shikuar përpara për vendin më të përshtatshëm. Ecnim dhe sillnim ndër mend skenën që lamë në luginën e ftohtë, skenë që u bë bashkudhëtare si pushka, në rrugët e vështira të luftës. Ecnim me ngadalë duke pritur sinjalin e Lekës. Vetëm katër-

qind metra më tej qëndronin në llogoret e tyre grekët.

Duhej vepruar me kujdes. Armiku ishte i fortë. Armiku edhe kur... Çfarë them unë. S'ka më të fortë se njeriu që ka zgjedhur rrugën e jetës e mban pushkën dhe zemrën në dorë. Pa le kur bashkohen shumë të tillë, ata bëhen një ortek i fuqishëm, që rrëshqet tatëpjetë e fshin çdo gjë që përpiqet ta ndalë.

Më afrohet Zotoja, që ngre zërin mbi krismet e pushkëve e mitralozave, mbi vërshëllimin e plumba-ve dhe thotë:

— Majori u vra nga grupi i Lekës. Mblidh shokët dhe mbathja! Takimi te Burimi i dushkut mbi rrap! — Mora frymë thellë. M'u duk sikur u pajisa me krahë. Vërshëlleva fort, kjo ishte shenja, sinjali për shokët. Duke përfituar nga rrëmuja e sulmit, mora drejtimin e përroit. Shokët e grupit më ndoqën pas. Krismat mbeteshin përherë e më tepër pas nesh.

Në fund te kthesa e përroit, aty ku mbaronte lugina, në të cilën tani frynte era e detit, pamë Arinin me trupin e Safetit në dorë.

Në fillim vuri dorën në buzë dhe përshpëriti, pastaj bëri disa hapa, u pengua e nuk lëvizi më. Ju afruam të dy shokëve. Në fytyrën e Arinit nuk dukej asnjë ndryshim nga ajo që kishte pësuar në çastin e pushkatimit. Ndejti mjaft kohë ashtu i qetë, pastaj ja dha prapë së qeshurës së papërmbajtur dhe me pamie të ndryshuar bërtiti:

— Vramëni, unë jam më i lig se Khani. Unë vrava shokun...

Ne u munduam ta qetësonim, t'i tregonim të vërtetën. Më kot u përpoqëm, se mendja e tij nuk i kapte fjalët tona.

Një pjesë e shokëve hapi me bajonetë varrin e

Safetit aty nën rrapin karshi diellit dhe maleve, ndërsa të tjerët po përpiqeshin të bisedonin me Arinin. Nuk kisha takuar asnjëherë një njeri në një gjendje të tillë psiqike. Si e linin krizat, rrinte i qetë, fliste normalisht. Sa shikonte pushkën, prishej në fytyrë dhe niste nga të thirrurat.

Si varrosëm Safetin, bëmë betimin mbi dheun e kuq të të vvarit të porsambuluar. Leka, që u bashkua me gjithë grupin e tij, fliste i pari. Ne përsëritnim si në kor fjalët e tij. E ato përhapeshin përreth e merrnin malet.

Po errësohej. Malet e heshtura qëndronin madhështore me porta të hapura, sikur prisnin banorë të rinj.

Arinin vendosëm ta linim përkohësisht te disa miq të tij në një fshat të afërm, për ta pasur kujdes, ndërsa ne i hymë rrugës së gjatë të luftës. Në fillim e patëm të vështirë, po shpejt urrejtja e popullit vërshoi si lavë nën udhëheqjen e komunistëve, para nesh po lindnin agime të përflakura.

Veç Arinin nuk e harruam. Dërguam në fshat dy mjekë nga ata të luftës, mjekë të mirë, nevrologë. Ata u përpoqën shumë. Mbas një luftimi në afërsi të luginës së ftohtë, ku Arini luftoi si luan dhe vrau shumë italianë, duke qëlluar me këmbë, nuk e zunë më krizat. Prej çastit kur lugina u bë përgjithmonë jona, Arini nuk u nda nga ne, vazhdoi luftën deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë dhe luftoi për vete, për Safetin e për vatanin, luftoi si ari.

Mbas çlirimit u vendos në qytetin e tij, buzë detit dhe merrej me peshkatarët. Po ta ndash pulëbardhën nga uji i kripur, nuk jeton dot. Ashtu është edhe puna e tij.

Kështu pra, shokë. Ata qenë dy, po ne u bëmë

shumë. Mos u çuditni që flas kështu. Atij, që u ka lidhur buzët e plasura shokëve të vrrarë, i vërshojnë fjalët nga zemra.

Njeriu që tërhiqte këmbën zvarrë mbaroi tregimin dhe u ngrit duke u mbështetur ngadalë në bastunin e tij.

DHËMBI I TRETË

«Gazi» i degës mbërriti para zjarrfikëseve në depon ku kishte rënë zjarri. Ishte një depo e madhe me mure tulle, ku ruhej i gjithë gruri i kooperativës «N», fruti i punës së përbashkët vjetore. Njerëzit që zbritën nga maqina më kot përpiqeshin të ndalnin disa fshatarë, që sulleshin mbi flakën për të shkëputur mundin e tyre nga gjuhët e tmerrshme.

Vetëtimat e njëpasnjëshme, që kishin shoqëruar «Gazin» nga qyteti në depon, e cila ndodhej poshtë në ara, në këmbë të fshatit, afër rrugës së automobil, vazhdonin të ndiqnin njëra-tjetrën. Ishte mesnatë, e në qiell nuk dukej asnjë yll. Retë dukej sikur qenë ulur mbi flakë për të bërë sehir. Një sy i sprovuar e vinte re këtë nga drita e vetëtimave, por tani sytë dhe mendjet e njerëzve, ndonëse e prisnin me padurim shiun, qenë mbërthyer mbi depon, mbi flakën që po e sterronte atë. Dukej qartë se përveç zjarrfikëseve askush nuk mund të bënte gjë atje.

Pëllumbi, sa zbriti nga «Gazi», çmoi gjendjen dhe dha udhëzimet e rastit për të mos i lënë njerëzit që t'i afroreshin objektit. Ai nxori elektrikun e dorës, i ra rrotull vendit se mos gjente ndonjë gjurmë. Atje ishte bërë një mishmash i tillë, saqë askush nuk

ja gjente dot fillin. Nuk kishte forcë t'u vinte fre kooperativistëve që t'i largonte nga vendi i zjarrit, ku po digjej munda i tyre. Kishin lënë fëmijët në gjumë, plakat rreth vatrave e qenë sulur drejt flakës për t'u mundur me të. Disa mbanin në dorë kova uji, disa cfurqe e disa shata e lopata. Fytyrat e tyre të lodhura e të djersitura shkëlqenin nga dritat e fuqishme të flakëve.

Një fshatar, që mezi e mbanin dy policë, bërtiste me të madhe. Zëri i tij ngrihej mbi zhurmën e flakëve dhe të kërcitjes së grurit që po përcëllohej brenda.

— Lërmëni, në keni perëndi. Brenda është xha Thanasi. Ai ka fëmijë... S'e njihni ju atë. Është shpirt njeriu.

Policët e mbanin, ata zbatonin urdhërin e hetuesit. Po Feimi, kështu e quanin llogaritarin e ekonomisë së përbashkët, u shpëtoi nga duart, theu xhamin dhe u vërsul brenda, hodhi dy thasë grurë nga dritarja e doli. Në ndihmë i shkoi Osmani, një brigadier i pararojës, me trup si lisi. Sakaq mbërritën zjarrfikësit e, sa të hapësh e të mbyllësh sytë fluturuan mbi flakët që dilnin nga çatia gjysmë e rrëzuar. Po ngriheshin lart shtyllat e para të ujit me presion.

Pëllumbi shihte me vëmendje flakën dhe veprimet e të gjithëve. Flaka i ngjante një armiku të rrezikshëm. Në fillim hetuesi ndjeu një si erë benzine, pastaj, kur mbërritën maqinat, ajo u përzje me erën e naftës bruto dhe humbi në të. Tani vinte vetëm era e djegjes së grurit dhe ajo e tharta që shkaktohej nga djegja e druve të ndërtesës.

Pëllumbi, si hetues, i njihte të gjitha llojet e tymit që dalin nga djegja, po në errësi dhe tymi

paskësh një ngjyrë. Më kot ai vriste mendjen, me blok në dorë e me laps nën nofull, për të gjetur shkaqet, për të marrë vesh ç'u bë me rojën, xha Thanasin. Flakët, ndonëse qenë nën goditjet e vazhduara të shllangave zjarrfikëse, prapë nuk po e ulnin kokën. Dy zjarrfikës tentuan që nëpërmjet shkallëve të hynin brenda nëpër nyjet e tavanit, por s'u eci. Pëllumbi e kuptoi se ata po përpiqeshin të shpëtonin kufomën e rojës, që, sipas thënjeve të vendësve, duhej të ndodhej patjetër brenda.

Atëhere u shkëput prapë Feimi dhe Osmani, të ndjekur nga disa djem të tjerë. Dy të parët, si u largën mirë nga një shllangë zjarrfikëse, u futën nga dritarja, por dolën shumë shpejt duke mbajtur në dorë një thes gruri gjysmë të djegur që po e përpinin flakët. Feimi bërtiti me zë:

— Ujë! Ndhimë... E, po të mos e kishin dëgjuar zjarrfikësit aty pranë e të mos drejtonin shtyllën e ujit me presion drejt tyre, ata do ta kishin pasur jetën në rrezik. Feimi zbriti, po prapa po vazhdonin t'i digjeshin pantallonat. Ai vraponte që të shpëtonte nga flaka, duke mos e kuptuar se kështu rrezikohej më shumë, mbasi lëvizja e ajrit ndihmon djegjen. Ju desh të ndërhynte vetë Pëllumbi, ta shtrinte në bar dhe ta rrokulliste derisa t'i mbytej gjuha flakës. Të gjitha këto u bënë shpejt e shpejt, veç as xha Thanasi, as kufoma e tij nuk dukej gjëkundi.

Edhe fshatarët e tjerë, duke marrë shembull nga Feimi, Osmani dhe të rinjtë e tjerë, u sulën mbi flakë me kova e kanoçe. Uji ishte pak larg e mundimi që i madh në krahasim me rezultatin, megjithatë ata u përpoqën me mish e me shpirt, ashtu siç ishin përpjekur gjatë punimit të tokës, gjatë mbjelljes dhe

korrrjes. Në çastin kur flakët përherë e më shumë po mblidheshin e po dendësoheshin, ja dha një shi i dendur që i bëri të padobishme përpjekjet e mëtejshme të zjarrfikësve dhe do të vështirësonte punën e hetuesit.

Feimi, që kishte lidhur mesin e djegur me një copë të madhe të bardhë nga një këmishë e grisur e që nuk u bind të shkonte në spital për mjekim me «Gazin» e degës, po shikonte drejt qiellit me kënaqësi. Ai nuk i ndahej hetuesit. Edhe këtij të fundit i hyri në zemër djaloshi energjik i sakrificës dhe e mbajti afër me shpresë se do ta ndihmonte në mendimet e tij. Kështu ndodh edhe në jetë: Njerëzit që kryejnë veprime të guximshme, japin dhe mendime të tilla.

Kur çdo gjë përreth u mbulua nga errësira e natës, Pëllumbi hyri i pari brenda nga dera e djegur, i shoqëruar nga shokë të kryesisë së kooperativës si dhe nga Feimi me Osmanin.

Mbasi nuk i mjaftoi drita e elektrikut të tij të dorës, ai i dha urdhër një maqine zjarrfikëse të hapte prozhektorët. Herë pas here u vinin në ndihmë dhe vetëtimat, që sa vinin e largoheshin së bashku me retë e ngarkuara me shi.

Pëllumbi arriti të zbulonte dy kufoma, prej të cilave njëra ishte djegur pothuajse plotësisht. Asaj i kishin mbetur betëm kockat e kafkës, dhëmbët dhe gjymtyrët e këmbëve; ndërsa tjetrën më pak të djegur, fshatarët e njohën menjëherë, ishte trupi i xha Thanasit. Ai e dinte se sado i vëmendshëm që të tregohesh, prapë do t'i mbeteshin sende të rëndësishme, ndonëse të vogla, pa u vënë re për shkak të ndriçimit të pakët, prandaj vendosi që shikimin e hollësishtëm të vendit ta kryente në mëngjes. Megjithatë, u

hodhi një sy ashtu kalimthi sendeve që binin më tepër në sy për të pasur një ide të përgjithshme.

— I shkreti xha Thanas — tha Feimi. — E ka zënë gjumi duke bërë muhabet me mikun dhe rezistenca që shërbente për ngrohje ka bërë të sajën.

Pëllumbi e pa rezistencën të rrethuar nga bloza, metali i shkrirë... ende lëshonte avull.

— Rezistencë elektrike në depo?

— E blemë me fond të kooperativës, se natën kishte të ftohtë plaku — u përgjegj llogaritari i prekur.

Pak më tej ndodhej pjesa metalike e një pushke model 1891/30 me gushë të shpërthyer dhe me gëzhoje të çara.

— Pushka e xha Thanasit — tha Feimi. Shokët e tjerë të kryesisë pohuan me kokë.

— Dëgjoi krisma njeri? — pyeti Pëllumbi.

— Ku mund të dalloheshin krismat nga bubullimat që lart nga fshati — u hodh një mesoburrë, që mbante në dorë një cigare të fikur.

Hetuesi vëzhgoi edhe disa sende të tjera, që mund t'i hynin në punë, i shënoi në blok me lapsin e tij, që e vinte herë pas here nën mjekër si për të mbledhur mendimet. Pastaj dolën të gjithë jashtë. Në depo u vunë roje, mbasi të nesërmen do të shikohej çdo gjë me imtësi. Feimin e nisën në spital me një maqinë zjarrfikëse, ndërsa Pëllumbi i kaloi ato orë deri në mëngjez në një kasolle aty afër, duke menduar vazhdimisht për enigmën që i kishte dalë përpara.

Në mëngjez Pëllumbi kontrolloi edhe një herë vendin rrotull depos. Aty u panë aq gjurmë të ndryshme njerëzish, sa do të ishte e kotë të merreshe me ndonjërin. Gjurmët e vjetra i kishin përpirë rrëketë e ujit. Shikoi përreth nëpër ferra, kanale e gropa se mos gjente ndonjë mjet ose gjurmë të krimt, por pa dobi. Pastaj së bashku me dy shokë të kryesisë hyri brenda, fotografoi kufomat, rezistencën dhe shikoi me imtësi vendin. Ndërmjet disa thasëve gjysmë të djegur gjeti një copë blok të hyrjes dhe të daljes së grurit dhe disa copa kartoni të rrumbullakëta e katrore gjysmë të djegura. Pak më tej i pa prapë copat e një shisheje dhe mbeturinat e një çakmaku që Feimi i kish thënë që në shikimin e parë, që bënë natën, se ato i takonin xha Thanasit. Njëri nga të kryesisë e pohoi këtë. I mblodhi të gjitha me kujdes në qese të veçanta dhe i vendosi në çantën e tij.

Në kohën kur shokët e tij po bëheshin gati të merrnin kufomat e t'i vendosnin me kujdes në bantanie, ai vuri re në gjoksin e xha Thanasit një plagë të hapur ku kishin mbetur cefla të mprehta druri shkaktuar nga ndonjë tra i thyer. Kur mblodhën kokkat e kufomës së painedentifikuar, u pa një plumb, që ra në tokë. Pëllumbi e mori plumbin dhe e shikoi me kujdes. Ishte plumb i zakonshëm i pushkës model 1891/30.

— Do të jetë nxehur arma nga zjarri. Ka shpërthyer fishekun, e plumbi ka goditur në trup të mikut të plakut — tha një shok i kryesisë.

Ai e argumentoi këtë duke u mbështetur në drejtimin e tytës metalike, e vetmja pjesë që kishte

mbetur nga pushka e plakut. Hetuesi e shikoi me kujdes plumbin, vuri re gjurmë vijaskash në të dhe e vuri prapë majën e lapsit nën mjekër, duke mos folur asnjë fjalë. Asgjë e veçantë nuk u zbulua për t'ju përgjegjur pyetjes se cila do të kishte qenë viktima e dytë, që i kishte bërë vizitën plakut në një natë të tillë dimri. Përveç kësaj dhe shkakut i vërtetë i zjarrit në depo mbetej i panjohur, ndonëse shumë rrugë të shpinin te pakujdesia e rojës.

Edhe mjeku që mbërriti menjëherë, që në vështrimin e parë tha se viktimat kishin vdekur nga asfiksia. Veç për çudinë e të tjerëve, veçanërisht të Pëllumbit, asnjëra nga viktimat nuk kishte bërë përpjekje për të dalë, sepse dritaret u gjetën të mbyllura.

Më në fund u lejuan që të largoheshin kufomat. Bashkë me to u larguan edhe të tjerët, të shqetësuar për mosgjetjen e shkakut të vërtetë të kësaj humbjeje të madhe të kooperativës edhe të familjeve të viktimave, prej të cilave njëra nuk njihej ende. Pëllumbi mblodhi materialet e nevojshme dhe i nisi në qytet, duke i lënë fshatarët në ankth, megjithëse pjesa më e madhe e tyre që e bindur se fatkeqësia ndodhi nga pakujdesia e rojtarit plak. Ata i paguanin ditët e punës për të ruajtur frutet e djersës së tyre, kurse ai u tregua aq sylesh, sa u përcëllua dhe vetë së bashku me grurin.

Hetuesi i raportoi shefit me hollësi rezultatet. Në fund shtoi:

— Sipas mendimit tim, shkakut i zjarrit nuk është thjesht pakujdesia. Vërejtja mirë vendin përreth dhe mund të them me bindje të plotë se zjarri nuk ka rënë si rezultat i shkarkimit të rrufesë. Ç'desh rrufeja në depo, ku mungonte krejtësisht metali brenda?

Aq më tepër kur përreth depos ndodheshin kodra me pemë të larta e shtylla elektrike. Përveç kësaj bie poshtë edhe supozimi i dytë i fshatarëve se zjarri është rezultat i pakujdesisë së rojtarit. Zjarri gjoja ka shpërthyer nga rezistenca ose nga shpërthimi i shishes së benzinës në kohën kur xha Thanasi po i hidhte çakmakut benzinë nga shishja. Kur brenda ndodhen dy burra, s'ka mundësi të shpërthejë zjarri, qoftë edhe nga një shishe benzine, mbasi ata do ta shuanin patjetër. Xha Thanasi, kur ka mbushur çakmakun, ka qenë zgjuar vetë, e rrjedhimisht ka pasur mundësi të vinte në dijeni edhe mikun.

Mendoj se këtu është dora e armikut që ka vepruar. Po, pa identifikuar kufomën e dytë, nuk mund t'i hyjmë asnjë rruge. Kur Pëllumbi mbaroi së foluri, shefi u përkul mbi sendet e sjella prej hetuesit nga depoja e djegur. Pas pak u sollën edhe fotografitë e porsapregatitura. Të dy u kërrusën mbi to. Pëllumbi me laps të vendosur nën mjekër, shikonte herë nga shefi e herë nga fotografitë, të cilat pak interes paraqitnin për të që kishte qenë pranë realitetit. Shefi shikoi me vëmendje fotografinë e kufomës së panjohur.

— Mua më duket se një pjesë e tipareve të fytyrës i ruhet akoma. Ja, dhëmbët i ka në rregull, edhe buzët. Nofullat, ndonëse pak të tretura nga temperatura, të lënë përshtypjen e e një njeriu me moshë djaloshare. Asnjëri nga fshatarët nuk e njohu?

— Jo, shoku shef! Ata thanë se nuk ishte prej fshatit të tyre, po edhe sikur të ishte, vetë e ëmia nuk do ta njihje, po ta shikonte në atë gjendje.

— Ndonjë orë, ose kopsa nga veshja e tij nuk kishin mbetur aty rrotull?

— Jo, shoku shef, me përjashtim të plumbit, për të cilin ju fola më lart.

— Të dy shokët heshtën një copë herë. Një rast i tillë nuk i kishte ndodhur asnjëherë. Shefi nuk po ja ndante sytë fotografisë që tregonte pjesën e kufomës së paidentifikuar. Pas njëfarë kohe vendosi lapsin mbi dhëmbët e tij, që dukeshin në radhë nga buzët e përcëlluara pak të hapura, dhe ju drejtua Pëllumbit.

— Dhëmbët a ja patë me kujdes? Kishte ndonjë të mbushur ose të vënë. Ne na duhet çdo hollësi për të.

— Kjo më doli nga mendja — tha Pëllumbi i turpëruar, mbështeti lapsin nën mjekër dhe u kërrus më tepër te fotografitë e kufomave. — Veç kufomat janë në frigorifer, mund t'i kontrollojmë — tha Pëllumbi.

— Do të bënit mirë ta shihnit edhe një herë me imtësi, veçanërisht dhëmbët, që nuk dëmtohen nga zjarri.

Pëllumbi u ngrit, mori leje dhe doli. Shefi mbeti me procesverbalin e hetuesit të tij në dorë.

3

Pas disa minutash hyri Pëllumbi. Ishte i qeshur. Futi dorën në xhep nga nxori diçka të vogël të mbështjellë me letër.

— E gjetëm, shoku shef. Dhëmbi i tretë nga e djathta; fare i padëmtuar. E nxorëm me kudjes, ishte i florinjte — tha dhe e vendosi dhëmbin që lëshoi menjëherë shkëlqimin e tij mbi tryezë. — Interessant është fakti — vazhdoi Pëllumbi — që, megjithëse dhëmbët dukeshin që larg, ky, i mbuluar nga bloza, nuk dallohej aspak nga të tjerët.

— Tani duhet gjetur filli, — tha shefi — filloni që nga klinika. Aty janë shënuar të gjithë dhëmbët e vënë. Po nuk doli këtu, shohim në qytetet e tjera.

— E qartë, shoku shef — tha Pëllumbi. Mori dhëmbin, e mbështolli dhe u ngrit. Në çast trokiti dera dhe hyri një shok tjetër, punonjës i kriminalistikës. Ai ju drejtua shefit:

— Plaga në gjoks e xha Thanasit është plagë saçmash, nga të çiftes. Tani sa i nxorëm. Punonjësi i kriminalistikës vuri mbi tryezë disa kokrra saçmash mesatare.

— Ju shkoni dhe merrni me dhëmbët — i tha shefi Pëllumbit, që priste në këmbë. Ky doli, ndërsa dy të tjerët vazhduan punën.

Në klinikën dentare të qytetit Pëllumbi priti sa t'i vinte radha, se dentisti plak e me eksperiencë ishte tepër rigoroz në detyrë. Sa hyri, plaku e peshoi që nga këmbët deri te koka të porsaardhurin e, si u bind që vinte për herë të parë, ja preu:

— Doni ta hiqni me gjilpëra, apo ashtu burrërisht? — Në fakt Pëllumbi nuk mbante dorën, por vetëm lapsin në mjekër. Ky vuri buzën në gaz, duke i treguar plakut dhëmbët e tij të rregullt e të pastër si për t'i thënë se nuk kishte ardhur për punë të tilla, e ja shpjegoi me durim qëllimin e tij. Plaku ashtu me syze mbi sy u çudit pak duke parë dhëmbin e florinjtë. Pëllumbi e vendosi mbi tryezë.

— Kjo me të vërtetë është puna ime, s'kam si e mohoj, veç dhëmbi nuk ka rënë, por është nxjerrë, prandaj, në qoftë se doni ta rivini, duhet prerë faturë e re për pagesë — vazhdoi përsëri dentisti.

Pëllumbi qeshi prapë me sinqeritetin e dentistit dhe ja shpjegoi edhe një herë, se nuk interesohet për vete, por për dikë tjetër. I kërkoi listën e nje-

rëzve që kishin vënë tek ai dhëmbë të florinjte. Plaku ngriti supet i çuditur, shkoi në dollap nga ku nxcri një blok të gjerë e të trashë me kapakë kartoni dhe ja vuri përpara. Pëllumbi e shfletoi me kujdes. Në të qenë shënuar jo vetëm emrat, por edhe adresat e secilit që kishte vënë dhëmb të florinjte te plaku. Ai ishte njeri i rregullt jo vetëm në punë, por edhe në dokumenta. Pëllumbi i hapi ato fletë, një pjesë prej të cilave ishin zverdhur, e qëndroi te numri njëqind, që mbyllte numrin e përgjithshëm.

— Këtu kam vetëm ata që kanë vënë nga një, kurse ata që kanë vënë nga dy dhëmbë të tillë i kam edhe në një evidencë tjetër. Rregulli është gjë e mirë, djalë. Të vjen tjetri, që kushedi se ku e ka vënë dhëmbin e rregulloma, thotë dhe të shan zatin.

— Mund të ma jepni për dy ditë regjistrin? — i tha Pëllumbi.

— Merreni, veç mos ma vononi, se klienti është klient, ka të atillë që duan qiçra në hell, kurse dokumenti është dokument.

Pëllumbi mori blokun dhe doli. Deri në darkën e po asaj dite u verifikua e gjithë lista. Nga të gjithë njerëzit e shënuar në atë listë tre kishin vdekur. Dokumentat e tyre u shikuan në kryesi. Mbeteshin 97 të gjallë, por edhe prej tyre, Fatri Bashiri, nga fshati i afërt me kooperativën ku ishte djegur de-voja, kishte humbur pa gjurmë. Edhe të nesërmen e kishin kërkuar, por pa rezultat. U pyet familja e tij. Ajo nuk dinte gjë. Nga të dhënat e ardhura në degë doli se Fatriu ishte bir kulaku, njeri i pakënaqur. Familja e tij ishte futur vonë në kooperativë.

Meqenëse të ëmën nuk e kishte gjallë, u pyet e shoqja në lidhje me një gisht të këmbës që e ki-

shte më të shkurtër se gjatësia normale. Gruaja tha se i shoqi me të vërtetë e kishte këtë defekt. Atë natë, pohoi gjithashtu ajo, i shoqi ishte larguar nga fshati pa lajmëruar se ku do të shkonte.

Copat e kartonit gjysmë të djegura, të gjetura nën thasët me grurë, konkludonin si tapa çifteje e nga shikimi me imtësi i tyre u dalluan disa shifra, që vinin në dyshim të papritur një njeri të kooperativës. Fishekët e çiftes qenë mbushur vetë nga i zoti, e letra e përdorur për tapa fliste për gjurmë të dukshme shifrash llogarie, të cilat përputheshin me shkrimin e Feimit. Kjo e tmerroi hetuesin, por megjithatë mendoi se mos çiften e tij e kishte marrë ndonjë mik, ose tapat mund t'i përkitnin një periudhe tjetër.

Pëllumbi i kontrolloi të gjitha çiftet e kooperativës dhe ai konkludoi se të gjitha qenë të vajisura pa asnjë shenjë krimi pas. Nuk i bënë këmbët të shkonte në spital e të merrte në pyetje Feimin; vetëm me urdhër të shefit shkoi bisedoi një herë me të shoqen e llogaritarit. Kishte të drejtë hetuesi. Kur e sheh tjetrin me sytë e tu, duke u përleshur me flakën, të marrë edhe plagë e të mos kërkojë të largohet, nuk të vjen t'i besosh se si mund të jetë ai autori i krimit.

E shoqja e llogaritarit nuk doli në fushë ditën e nesërme me shpresë që të nisej në qytet, për në spital. Pëllumbi e gjeti në përgatitje e sipër. Gruaja, e shqetësuar për të shoqin, që shumë fshatarë ja kishin bërë hero në luftë kundër flakëve, e kujtoi Pëllumbin për ndonjë korrespondent, prandaj ju përgjegj me kënaqësi pyetjes së tij.

Sipas thënjeve të saj, Feimi atë natë që ndodhi zjarri, nuk kishte fjetur në kuzhinën e ngrohur së

bashku me të e fëmijët, por duhej të kishin fjetur në dhomë.

Kur e pyeti hetuesi nëse kishte dëgjuar të kër-
citura dere, ose mos kishte parë dritë të ndezur nga
dhoma, ajo ju përgjegj negativisht. Ajo e lodhur nga
puna në arë, kishte rënë në gjumë të thellë pa dë-
gjuar asgjë. Hetuesi mori një fishek çifteje nga
gjerdani i Feimit dhe u nis prapë për në qytet. Nuk
i ra nga rruga e drejtë, që ishte më e shkurtëra me
qëllim që të kishte më shumë kohë për të menduar.

Në rrugën e kafshëve kur po zbriste, i doli një
stan përpara. U ul mbi një trung lisi të sharruar dhe
e ndezi. Aty u afrua bariu i kopeve, një plak i thi-
njur me kërrabë në dorë. Biseda e papritur nisi. Kur
mungon kafeja ose rakia, edhe duhani është mjet i
mirë për të këmbyer fjalët.

4

Pëllumbi i ra larg e larg bisedës, derisa vetë
bariu i erdhi në shteg:

— Ti the se Feimi vraponte drejt flakës së de-
pos që dukej si diell në perëndim, tej në fushë.

— Oj, vraponte thotë! Fluturonte fare sikur s'i
zinin këmbët dhe. Pastaj shkuan të gjithë, por ai...

— Si e pe dot kur rruga e fshatit për në fushë
nuk duket as ditën që këtej nga stani, e jo natën?

— Pse nga rruga? — u çudit plaku. — Feimi më
trembi dhentë në stan mua. Jo, djalthi im, llogari-
tari zbriti këtej, e jo nga fshati — tregoi me dorë
bariu. Pastaj nisi lëvdatat për llogaritarin.

— E kemi djalë të mirë. Vërtet nusen e ka nga

«derë e madhe», po djali i ka prerë marrëdhënjet me ta.

— Cilën quan derë të madhe, o xhaxho?

— Hëm! Ne i matin pleqërisht dyert, me kutin tonë. Beshirët kanë qenë të parët në fshatin e afërm, qoftë për pasuri, qoftë për emër. Është e vërtetë se kohët kanë ndryshuar, por, si themi ne këtej, «Më mirë të të dalë syri, se nami». Po Feimi ynë i ka prerë marrëdhënjet me ta, ka kohë. Ndryshe nuk i jepnin në dorë qesen e kooperativës.

— Pra, Feimi është dhëndërr i ishkulakut.

— Kështu del, — tha plaku — po ne djalin e kemi të mirë. Ai luftoi si luan me flakën, hallall e pastë bukën.

— E ke parë gjë ndonjëherë Fatri Beshirin këtej?

— Gjynah të gënjej. Vërtet binaja e tyre ka rrënjë të dëgjua, si themi ne pleqtë, por nuk do të ma kishte qejfi ta shihja. Jo, nuk para vjen këtej.

Pëllumbi e falënderoi plakun që pranoi të shkëmbente duhanin me të dhe u nis tatëpjetë për në xhade duke ndjerë zërin e këmborëve të bagëtive dhe mendimet e reja që i pushtuan trurin.

Nga ekspertiza doli se shifrat nëpër tapat e çiftes qenë shkruar nga dora e Feimit, pra fishekët i kishte mbushur vetë. Po kështu edhe saçmat e gjetura në trupin e xha Thanasit ishin të njëjta me ato të fishekut që mori Pëllumbi nga gjerdani i tjetrit. Të gjitha rrugët të shpinin në atë që të paktën çiftja e Feimit kishte marrë pjesë në krismat e dëgjua në depon e djegur përzier me gjëmimet e qiellit. Sa për pjesëmarrjen e vetë Feimit, kjo ishte vetëm supozim.

Hetusi u këshillua me shefin e tij për sa konkludoi në bazë të fakteve të zbuluara dhe, me udhë-

zimet e këtij të fundit, vendosi ta merrte në pyetje llogaritarin e kooperativës, plagët e të cilit po përthaheshin shpejt.

Kur u paraqit llogaritari i kooperativës sipas kërkesës së hetuesisë, në zyrë, u ndodh vetëm Pëllumbi. Ai u ul i qetë karshi hetuesit dhe nderoi një cigare. Edhe Pëllumbi e nisi larg e larg bisedën, ashtu si ja donte puna:

— Të gjithë në fshat ju presin. Ju thirra për një bisedë miqësore, mbasi njerëzit i bashkon edhe më shumë lufta kundër çdo lloj të keqeje.

— Ne së bashku përpiqemi për ndërtimin dhe mbrojtjen e jetës së re — ju përgjegj Feimi.

— Për herë të parë më sollti e keqja andej nga vendet tuaja, po natyra më pëlqeu shumë. Edhe me gjuetinë e kafshëve nuk duhet të shkoni keq.

— Njëfarësoj. Nganjëherë vrasim ndonjë ujk, kur na sulmon kopetë, e rrallë lepuj. Ku të lë puna të merresh me gjueti.

— Vetë i mbushni fishekët me saçma?

— Gjahtari i mirë atje duket. Meqë ra fjala, dukuni ndonjëherë. Do t'ju shpie në një vend nga nuk del kurrë duarthatë — tha Feimi.

— Mos keni vende gjuetie më të përshtatshme në fshatin e afërm, ku keni njerëzit e gruas suaj? — pyeti hetuesi pa i larguar sytë nga fytyra e bashkëfolësit.

Llogaritari u drodh, po e mbajti veten. — Ka, posi, është pak larg, po mua nuk më pëlqen andej. Kam kohë që nuk dukem. Helbete, lufta e klasave. Ma zuri rrota bishtin, ç'të bëj, kam fëmijë me të, pa ja tregoja vendin dhe asaj — tha Feimi.

— Bariu i fshatit tuaj flet me respekt të madh për ju, veç ju shan pak, se natën që ra zjarri në

depo i trembët bagëtinë në vathë — i tha Pëllumbi duke vështruar me vëmendje bashkëfolësin. Feimi u ngrys, por prapë nuk e dha veten. Atëhere hetuesi vendosi t'i hapej e të mos e zgjatte:

— Një natë dimri me shi, kunati juaj, Fatriu, kaloi kodra e kthesa derisa erdhi në shtëpinë tuaj. Ju e prisnit jashtë që të mos ju njollosej shtëpia. Në sup mbanit çiftin e mbushur me fishekë, të pregatitur vetë. Të dy vendosët të realizonit urrejtjen tuaj të mbledhur prej kaq vjetësh në zemër, siç mbledh plaga qelbin, karshi ekonomisë së përbashkët. U nisët drejt depos së grurit. Xha Thanasi nuk flinte. Ju pritni me këmbët e para, se e mbante rregullin, e nuk ju la të afroheshit në depo. Fatriu, që nuk e përmbante dot urrejtjen, u fut me zor dhe derdhi bidonin e benzinës, që e kishte sjellë nga ana e anës. Fatriun e la në vend pushka e xha Thanasit. Ju u frikësuat se mos zbuloheshit. Qëlluat plakun me çifte. Si i vendosët të dy kufomat në pozicionin e dëshiruar, rregulluat rezistencën, çakmakun e plakut, shishen e benzinës dhe, që pas kësaj të mos ngjallej asnjë dyshim, derdhët edhe bidonin tjetër me benzinë dhe i futët flakën depos duke hedhur më tepër lëndë djegëse afër kufomës së kunatit tuaj me qëllim që të mos mbetej asnjë gjurmë prej tij, pasi dalja e tij në dritë ju rrezikonte edhe ju.

Pëllumbi fliste, ndërsa Femi u ngryste e ngryste në fytyrë. Në fund mbështeti kokën në mes të dy duarve mbi tryezë si për të mos dëgjuar më.

— I bindur se krismat e armëve nuk mund të dëgjoheshin në fshat në atë natë plot bubullima, mbyllët dritaret dhe derën dhe u larguat në drejtim tjetër me qëllim që të mos ju shikonte njeri duke hyrë në fshat. Por, kur fshati dha alarmin, për të

fshehur çdo dyshim, u përzjetë me të tjerët dhe bëtë «heroizma» për të shpëtuar atë, së cilës i vutë vetë flakën. Megjithëse plani ishte llogaritur mirë, nuk ju eci dhe nuk do t'ju ecë kurrë, juve. Drejtësisë së popullit nuk mundët t'i shpëtonit.

Si tha këto, Pëllumbi vendosi mbi tryezë të gjitha faktet që demaskonin veprimet e Feimit, duke i zgjatur edhe procesverbalin ku ishin shkruar thënjet e njerëzve.

— Nuk ka si të mbroheni. Të gjitha faktet ju gozhdojnë në mur — tha Pëllumbi dhe tregoi me dorë nga fotografitë dhe materialet e tjera. Feimi nuk hapi më gojën. Mbërtheu vështrimin tek ai dhëmb i florinjte që lëshonte një hije të gjatë e të zezë mbi tryezë si rruga tradhëtare e kriminelit. Ai nuk dëgjoi as zërin e hetuesit kur i tha:

— Në emër të ligjit jeni i arrestuar.

Feimi u ngrit në drejtim të derës, por vështrimin s'e kishte larguar nga tryeza, ku ndodhej fundi i tij.

REPORTAZHI I NDËRPRERË

Artani u ul në karrigen që i tregoi me dorë komandanti i postës kufitare dhe, si shkopsiti xhepin e jashtëm të xhaketës, i zgjati atij dy copa letre të vulosura. Kapiteni u kërrus dhe nisi të lexonte me vëmendje. Pasi mbaroi së lexuari të dytën, vuri buzën në gaz dhe tha:

— Keni ardhur të takoni Zemanin dhe të shkruani për jetën e kufitarëve? Shumë mirë, kësaj i thonë një rrugë e dy punë.

— Jashtë era vërshëllente nëpër pemë, përplaste fletëzat e borës në dritare. Ato binin të heshtura si copa pambuku. Sa më shumë kalonte koha, aq më e dendur bëhej kjo perde e bardhë nëpër faqet e poshtme të dritareve. Brenda në dhomë qe përhapur një shtresë tymi nga të plasurat e sobës prej llamarinë.

— Po, shoku kapiten. Gazetar nuk jam. Ju vura kësaj rruge vullnetarisht, si njeri i apasionuar pas punës sime dhe asaj të shokëve. Për ta nisa të shkruaj korrespondenca, e rrallë ndonjë reportazh. Nuk mund të rri dot pa punë. Në pushim, pas punës marr penën dhe shkruaj, shfrytëzoj kohën e lirë. Dua që rezultatet e shokëve të uzinës t'i marrë vesh gj-

thë Shqipëria. Kështu arrita të bëhem korrespondent vullnetar i gazetës. Kur po nxirrja lejën e kalendarit për në zonën kufitare, më takoi njëri prej redaktorëve dhe m'u lut të shkruaj për ju, se keni festën tani afër, më dha edhe këtë autorizim. Nuk mund t'ja prishja — ju përgjegj Artani dhe ndezi cigaren me urën e zjarrit që nxori prej sobës. Tymi u përhap me shpejtësi. Djaloshi e mbylli menjëherë kapakun prej teneqeje.

— Vepruat shumë mirë. Takohuni më parë me vëllain, mbasi do të marrë shërbimin e patrullimit, pastaj merruni me artikullin. Për këtë të fundit duhet të bisedoni me zëvendësin për punë politike. Ai do t'ju japë faktet që do t'ju nevojiten. Të nxirrni diçka të mirë për djemtë tanë. E, meqë ra fjala, po ju them se keni vëlla një xhanan djalë, sikur ka lindur për në kufi.

— E dua shumë Zemanin. Vetëm ai më ka mbetur nga gjaku; babai më ra dëshmor. pak ditë përpara se të çlirohej vendi, nëna na la të mi. . .

— I di të gjitha — ja preu oficeri dhe e treti vështrimin tej xhamit gjysmë të zbardhur të dritares. Te hyrja e repartit rrinte roja me automatik në gjoks armë, në karrikator mbante dorën e djathtë futur në dorezën e trashë të lëkurtë. Nga këpurdha mbrojtëse e vendrojes shkëputeshin copat e borës që i binin në trup e në fytyrë. Roja nuk lëvizte nga vendi. Më tej, në horizont, qielli ngjyrë plumbi në të bardhë qe bërë njësh me tokën. Qe aq afër, sa atyre u dukej se mund ta kapnin me dorë. Pastaj oficeri u kthye nga Artani e, kur e pa me sy të lotuar, rrudhi vetullat. Si ushtarak, pjesëmarrës i disa luftimeve, si njeri që i kishin rënë plumbat breshër përreth, nuk i pëlqenin burrat me qepalla të lagura.

E, megjithatë, miqtë nuk qërtohen, prandaj goditi gjetskë.

— Na qorroi ky tym i mallëkuar. Dru kemi me bollëk. I presim gëmushat, ferrat dhe murrizat buzë kufirit për të mos u bërë çerdhe gjarpërinjsh. Ç'e do, janë të lagura. Nxjerrin shumë tym të uruarat. — Kapitani pas këtyre fjalëve u ngrit si për të thënë: «Juve nuk ju pritet sa të takoni vëllain. Mua më presin punë të tjera». Ai doli, gjithashtu u ngrit dhe Artani.

— Te dera e priste Zemani. Ky nderoi oficerin që i bëri me shenjë në drejtim të derës. Oficeri u largua për në fjetore, ku pushonin njerëzit e shërbimit.

Dy vëllezërit u përçafuan me mall, sikur të kishin vite pa u parë dhe ashtu me duart në qafë të njëri-tjetrit hynë në dhomën e pritjes, ku vazhduan për njëfarë kohe bisedën. Në raste të tilla koha duket sikur ecën më shpejt, sikur ta bën për inat. Nuk kishin kaluar as tridhjetë minuta kur trokiti dera dhe hyri kufitar Seriani.

— Zeman! — nisi ai. — Më ka dërguar komandanti të të lajmëroj se nuk do të shkosh sonte në patrullim. Qëndro me vëllain. Në vendin tënd do të shkoj unë, e bëj unë shërbimin.

— Si? Po ti sa e dorëzove?

— Propozimin ja bëra vullnetarisht komandantit. Ai ma aprovoi.

— Në asnjë mënyrë — u përgjegj Zemani i vendosur.

— Edhe unë kështu mendoj. E nxorëm mallin. Përveç kësaj unë kam për të kryer edhe një porosi tjetër. — Artani desh të sqaronte punën e reportazhit që i duhej për të shkruar, por nuk vazhdoi më tej, u mjaftua me kaq.

Zemani u përshëndet me të vëllain dhe vrapoi në armaturë, pastaj veshi kokoren, kapotën, peletinën dhe u bashkua me shokët e grupit të patrullimit. Kufitar Seriani e ndoqi pas duke i bërtitur:

— E ke gabim, s'bën kështu. Nesër mund të më vijë edhe mua vëllai... Zeman, kthehu. Sot të zëvendësoj unë ty, ti nesër mua... — por tingujt e zërit të tij u mbytën nga vërshëllima e erës. Zemani, duke tundur dorën, u zhduk së bashku me grupin, në atë bardhësi të pafund, drejt kufirit, ku gjendej ndonjë lis i rrallë ose degë të ulura nga pesha e borës, që shpesh fërkoreshin me njëra-tjetrën dhe puthnin tokën e mbuluar me çarçaf të bardhë.

* * *

Kërrusur mbi tryezën katrore rrinin përballë njëri-tjetrit zëvendësi për punë politike i nënrepartit, një djalosh i thinjur para kohe, edhe Artani.

Artani shikonte në sy bashkëfolësin dhe i kujtohej komisarari i tij. «Kështu janë të gjithë komisarët, njerëz më afër njerëzve».

Me stilograf në dorë dëgjonte me vëmendje, shkruante në fletë gjërat kryesore. Për t'i vënë dru sobës ngrihej herë pas here oficeri. Kutia e cigares rrinte mbi tryezë pranë shishes së bojës. Kështu e ka mikpritja shqiptare.

— Shumë gjëra dëgjova për njerëzit e këtushëm. Nuk di për cilin të shkruaj më parë — tha Artani duke mbushur stilografin me bojë.

— Zgjidhni. Mund të them edhe më. Këtu vetë jeta është një reportazh i vërtetë i shkruar prej kufitarëve me gjak, nëpër prita e shkëmbinj. Armiqtë

ulërijnë matanë si ujçërit jashtë vathës, por nuk kanë se ç'të bëjnë. Ushtarët tanë e kanë kthyer vijën kufitare në një mur graniti të pakalueshëm.

— Prandaj e kam të vështirë të përqëndrohem. Njëra ngjarje është më heroike se tjetra. Duhet shkruar për aktin e guximshëm të kufitarëve të rinj, të udhëhequr nga rreshter Mali, po nuk mund ta lë pa përmendur kufitar Markun që gozhdoi më se një orë diversantët te gryka e Zeqos. Nuk kam si ta lë pa përmendur dhe heroizmin e atij kufitarit të plagosur.

Artani shfletonte për të gjetur emrin e duhur, por komisari, që i njihte vartësit si gishtërinjtë, i erdhi menjëherë në ndihmë.

— Asllani!

— Po, Asllani. Për këta duhen shkruar faqe të tëra, kurse unë vetëm një copë korrespondent vullnetar jam. Atje në uzinë puna ndryshon. I shikoj, i jetoj gjërat. Për gjërat e jetuara është më lehtë të shkruhet — tha Artani dhe nisi të nënvizonte diçka në fletën që kishte përpara duke shtrënguar stilografin me mollëzat e gishtërinjve të trashur dhe të deformuar nga kallot. Ngjyra e metalit, që i kishte depërtuar thellë në mish, ja bënte duart më burrërore.

— Edhe këtu do t'ja dilni mbanë. Vështirë është sa ta nisni — i dha guxim oficeri. — Si mendoni ta titulloni reportazhin? Me sa di unë, ngjarjet që do të përbëjnë shkrimin tuaj ndahen në nëntituj, dhe gjithë shkrimi do të marrë formën e reportazhit. — Punëtori nuk foli. Uli sytë mbi fletë, sikur kërkonte nëpër të titullin e shkrimit të tij, pastaj, sikur të zbulonte anën nga do ta qëllonte më mirë armikun, u përgjegj:

— Reportazh i shkruar me gjak.

— Po sikur të vinim një titull më...

— Me leje, shoku toger!.. — Të dy burrat, të ulur përreth tryezës katrore, kthyen koken nga dera. Një rrymë e ftohtë ajri e përzier me thërrime bore vërshoi nëpër dhomë. Para tyre qëndronte gatitu, me dorë në tëmthin e djathtë, kufitar Letteri, i vesuar dhe i armatosur. Nga fytyra e skuqur dhe frymëmarrja e parregullt bindeshe se atë e shqetësonte diçka e rëndësishme.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti zëvendësi për punë politike. Kufitari nuk u përgjegj. Shikoi nga Artani si për të thënë: «Ju na keni mësuar që të mos flasim për gjëra të rëndësishme në prani të njerëzve të panjohur».

...Togeri u ngrit e i hodhi dorën në shpatull, e në atë pozicion ju afrua derës. Kufitari shtyu derën dhe i foli eprorit ngadalë. Zëvendësi për punë politike u kthye nga Artani, vuri kokoren në kokë dhe foli shpejt e shpejt:

— Duhet ta ndërpresim për disa kohë punën e reportazhit. Në krahun e majtë një çetë po bën përpjekje të kalojë kufirin. Më falni. Tashti e merr fjalën pushka, pendën e lëmë për më vonë. — Pas këtyre fjalëve togeri doli me rrëmbim. Artani mbeti si i ngrirë dhe përshpëriti me çudi: «Siii?» Por askush nuk e dëgjoi, se dera që mbyllur.

Artani e ndjeu se sa ngrohtë bënte në dhomë kur u tret fare ajo rrymë ajri që kishte hyrë para pak kohe. Ai vështroi sobën që po bubullonte. I çuditur, shikoi rrotull. Vetëm ai dhe soba qëndronin në dhomë. Në zjarr kërcisnin drutë, ndërsa atij po i dilnin djersë të ftohta. Qe një e ftohtë e çuditshme që ja pushtoi tërë qelizat e trupit. Ju duk vetja i

huaj. Nga jashtë vinin zërat dhe komandat e kufitarëve. Në postë qe dhënë alarmi. Në sobë vazhdonin të kërcisnin drutë e lagura. Të gjithë këto zhurma ja trullosën mendjen. I dukej sikur dikush e qëllonte në membranën e veshit. Atje, në vijën e parë, luftohej me të ftohtët dhe me zjarrin. Të gjithë kufitarët po i shkonin në ndihmë Zemanit, vëllait të tij, kurse tjetrin e harruan. I hipi gjaku në kokë. U ngrit, hapi derën dhe, duke shtyrë para rrymën e ajrit, doli jashtë me flokë të shpupuritur.

Në oborrin e postës rrinin të rrjeshtuar kufitarët. Komandanti pyeste nënoficerin e shërbimit.

— U lajmërua fshati?

— Si urdhëroni, u lajmërua në çast. Fshatarët e armatosur janë drejtuar nëpër vendet e tyre.

— Mirë — tha oficeri dhe i bëri shenjë kujdes-tarit që të merrte efektivin. Artani i doli përpara. Sytë i lëshonin shkëndija. Shprehja e fytyrës së tij e bëri oficerin të qëndronte. Ë, ë, vëllai i Zemanit, shoku Artan, çfarë ju ka ndodhur?

— Dhe më pyesni? Pse, e pakët është kjo? Fshatin e lajmëruat, ndërsa mua më latë të ngrohëm pranë sobës, hë?

— Për ju është Zemani, atje? Pastaj gjatë kësaj kohe mund të mbaroni edhe artikullin. Ne kthehemi shpejt. Shëtitje të tilla janë të shpeshta këtej.

— Si? — hapi sytë më tepër Artani. — Po të jepej alarm në uzinën time, nuk do të ngrihej i madh e i vogël! Ja t'ju marrim ju, nuk do të hidheshit për të shuar zjarrin te ne?

— Ashtu është vërtet, por këtu janë marrë të gjitha masat. Pastaj.

— Asnjë pastaj. Unë dua armë! Te ne, kufi është kudo dhe të gjithë jemi kufitarë. Në s'kemi besim,

urdhëroni. — Sakaq Artani mundi të nxirrte nga xhepi dokumentin e partisë dhe librezën ushtarake, ku vërtetohej kryerja e shërbimit ushtarak. — Po nuk më dhatë armë, do të shkoj të luftoj me gurë, ose të kacafytem me thonj e me grushta.

Kapiteni e pa ashtu të zemëruar dhe u çudit shumë. Nuk ngjante aspak me Artanin e disa minutave më parë, të cilit, sa i ishte kujtuar i ati i vrrarë, i ishin njomur sytë.

Po errej, bora pushoi. Ndonjë flok bore që e merrte era dhe e përplaste ku të mundte zinte vend edhe në ballin e Artanit dhe menjëherë atje tretej si sheqeri në ujë. Oficeri u zu ngushtë. Një rast i tillë s'i kishte ndodhur asnjëherë. U munda prapë t'ja mbushte mendjen:

— Më kuptoni drejt. Këtu nuk bëhet fjalë për heroizmin, se ndryshe nuk ju jepte njeri leje për kalim këtu. Si komandant ja njoh mirë biografinë Zemanit, e rrjedhimisht edhe tuajën. Duhet të më kuptoni. Ka disa rregulla që ne ushtarakët...

— Rregullat i vendosin njerëzit. Asnjë, asnjë rregull nuk mund të më ndalojë të luftoj për atdheun. Më jepni armë, ndryshe lidhmëni, se unë do të bëj timen...

Kapiteni shikoi orën. Ju duk sikur akrepat kishin shpejtuar shumë. Ai thirri nënoficerin e shërbimit dhe e urdhëroi t'i jepte pushkën e një kufitari, që ndodhej me leje dhe u nis. Zëvendësin për punë politike e la në repart me gjithë personelin e shërbimit dhe një pjesë të efektivit.

Artani, sa kapi në duart e ftohta armën, ngau pas tij, u rrëzua dy herë mbi borë, pushkën e mbante në dorën e majtë të ngritur përpjetë, siç e bëjnë ushtarët kur kalojnë lumin me not për të mos ju

lagur. U ngut dhe e arriti kapitenin disa metra larg postës. Me ta u bashkua edhe korrieri. Kështu u bënë tre. Ecnin me nxitim. Në krye udhëhiqte oficeri. Kur rrezohej ndonjëri, të tjerët e ngrinin. Rruga çahej me vështirësi, bora po arrinte deri në gju. Asnjëri nuk fliste. Dëgjohej vetëm kërcitja e borës që shkelej nga këpucët e rënda dhe ulërима e erës nëpër gëmusha e gryka. Errësira e plotë pushtoi qiellin dhe tokën. Kur ndonjë plumb gjurmëlënës çante errësirën, duke lëshuar një flakë karakteristike dhe linte vrapin aty afër, dukej një pjesë e asaj bardhësie pa mbarim.

Të tre kufitarët vazhdonin ecjen. Krismat mbas një kthese të rrugës së ngushtë u ndien më të qarta. Diku afër, kishte nisur përpjekja.

Bora pushoi. Në qiell yjet nisën të shkrepëtinin një nga një. Një njeri i sprovuar në këtë zhurmë të përzier krismash mund t'i dallonte pa mundim tonat nga ato të armikut.

Komandanti qëndroi. Përpara tyre shtrihej Qafa e zezë. Oficeri mendohej, ndërsa Artani përpiquej të njihej me vendin. Nxinte gryka më shumë se nata. Poshtë, në të majtë, dëgjoheshin të shtënat. Korrieri dhe Artani shikonin oficerin dhe prisnin urdhëra. «Meqenëse ranë në përpjekje me forcat tona, diversantët do të përpiqen të çajnë përpara. Kësaj i thonë t'i biesh murit me kokë. Kur të binden për këtë, do t'u vihen rrugëve për të shpëtuar lëkurën. Vendi më i mirë për këtë është ky...» mendonte kapiteni.

— Tani të zëmë pozicionet. Pas një çerek ore diversantët mund të vijnë. Zgjidhni mburoja shkëmbore, mbasi bora, megjithëse e dobëson, e fton plumbin, shpohet kollaj prej tij. E përsërit, gjeni shkëmbinj. Zjarri do të hapet, mbasi të kem dhënë urdhër

me një breshëri automatikësh dhe dy gjurmëlënës.
— Kapiteni fliste duke mbajtur armën në gjoks.

Artani u largua nja njëqind metra në të djathtë dhe hapi borën prapa shkëmbit. Copat e ngrira të borës ja përplaste era në fytyrë. Në fillim nuk e ndjeu të ftohtët, pastaj nuk i zotëronte dot nofullat që të mos i kërciste dhëmbët. Fishekët gjurmëlënës çanin qiellin atje tej si meteorë. Siç duket, tanët jepnin shenja për drejtimin e lëvizjes së armikut. Ky drejtim përputhej plotësisht me parashikimet e komandantit të postës, gjë që e kuptoi dhe e miratoi Artani. Për një çast pushoi së menduari për shënimet që kishte lënë mbi tryezën katrore, në dhomën politike ushtarake. Tani duhej menduar për diçka tjetër. I duhej të shkruante një poemë të vërtetë për kufitarët, jo me pendë e bojë, por me plumba gjurmëlënës. Poema të tilla shkruhen shpesh në kufi. Ai e dinte.

Ngadalësoi frymëmarrjen. Përreth shkëmbinje dukeshin si mullarë të mbuluar me borë. Ju duk sikur një shkëmb u rrokullis në humnerë. Drejtoi armën. Tani po dëgjohej qartë kërcitja e borës që shkaktohej patjetër nga një trup që po zvarritej. Artanit i kërcisnin dhëmbët. Ai nuk shihte asgjë, veç ngjyrës së përhimtë të sipërfaqes dhe errësirës së plotë të sfondit të kodrave në grykë. Ç'të bënte, të hapte zjarr? Kundër kujt? Nuk shihte asgjë. Pastaj urdhëri i komandantit. Ai e njihte mirë ushtrinë dhe urdhërat. Duhej të priste. Me kalimin e kohës të kërciturit e borës dëgjohej më qartë. Artani arriti të kapte edhe dihatje të shpeshta. Ju elektrizua trupi. S'priti më.

— Ndal! Duart lart! — bërtiti. Po në vend të përgjegjes dy breshëri të njëpasnjëshme shkundën

borën shkëmbit që e mbronte. Copat e mëdha të borës që u ngritën lart, i ranë mbi kokë si breshër. Sytë e sprovuar dalluan mirë tytën që vulli plumba. Qëlloi kapiteni dhe korrieri. Oficeri u bind se qenë diversantë. Në rast të kundërt ata do të përgjegjeshin drejt, duke thënë parulla. Atëhere hapi zjarr dhe Artani. Lufta bëhej flakë për flakë. Qëllohej vetëm kundër flakëve që nxirrnin armët se nuk dukej asgjë. Diversantët, kur panë se me cilët kishin të bënin, vendosën të çanin përpara. E, siç dihet, grushti kryesor në këto raste jepet te pika më e dobët. Kundër tyre villnin zjarr dy automatikë dhe një pushkë, pushka e Artanit. Pushka jep dendësi zjarri më të paktë, prandaj dhe ata vendosën ta bënin të heshte. Hodhën një granadë. Ajo plasi rrëzë shkëmbit, ku mbrohej djaloshi. Copat e borës u ngritën lart dhe ranë anash. Shkëmbi u rrokullis tatëpjetë bokërinës. Artani mbeti i zbuluar. Para tij zjarri i granatës kishte shkrirë borën dhe kishte krijuar një gropë artificiale. U zvarrit drejt saj. Fytyra ju mbush me flokë bore dhe copa balte.

Si zuri vend në gropën e hapur prej bombës, e ndjeu veten më të sigurt dhe më të ngrohtë. Era e barutit i guduliste hundët.

Diversantët po afroheshin duke qëlluar pa ndërprerje. Artani dalloj hijen e trupit të njërit, tërhoqi këmbëzën e shkrepjes. Hija mbeti në vend, e palëvizur, sikur të qe shkrirë dhe bërë njësh me errësirën e natës. Nga flaka që lëshoi tyta e tij djaloshi zbuloi vetëveten. Dhjetëra plumba i vërshëllyen përreth. Një dhembje e fortë ja përshkoi shpatullën e djathtë. Ju duk sikur një thikë e mprehur dhe e nxehtë i hyri me shpejtësi në ato pjesë të trupit. Tani nuk mund të lëvizte dot për të ndërruar pozicionin. Di-

versantët jo vetëm qëllonin pa pushim, por edhe përparonin. Kalimi i Qafës së zezë ishte shpëtimi i tyre. Artani kishte forcë ende në gishtin tregues që e kishte vendosur në këmbëzën e pushkës së mbushur plot me fishekë.

Kapiteni e çmoi drejt situatën, ndaj u ngrit, la pozicionin dhe u doli përpara diversantëve. Kjo ndihmoi si për t'u prerë rrugën, ashtu edhe për t'i shpëtuar jetën punëtorit kokëfortë, që ndodhej në rrezik. Diversantët nuk duhej të kalonin edhe sikur të vdisnin të tre tanët. Ky ishte një ligj i rreptë i diktuar nga vetë toka që mbrojmë.

Artani qëllonte e çdo herë flaka e tytës i zbulonte vendndodhjen. I hipi një nxehtësi e madhe, ndërsa plaga nisi t'i ftohej dalëngadalë. Aty afër u dëgjuan zëra: «Përpara, shokë, në sulm!» Ishin fshatarët dhe kufitarët që vinin në ndihmë. Ata tani e vunë përpara bandën.

Mu përpara Artanit plasi përsëri një granadë. Kjo qe tentativa e fundit e diversantëve për të çarë përpara. Bora e përzier me baltë e mbuloi rishtas djaloshin. Ai u përpoq të shkëputej, ta mënjanonte këtë borë të bardhë, por pa sukses, se forcat i kishte në shterim e sipër.

Sakaq mbërritën forca të tjera fshatare dhe kufitarë që i dhanë fund luftimit. Diversantët lanë dy të vrarë, një të plagosur dhe dy robër. Kapiteni u mor me robërit. Feneri i tij i dorës ndriçonte borën e bërë si rrjetë nga plumbat. Ai së bashku me dy kufitarë kërkonte korrespondentin vullnetar. Përhapi me shpejtësi togun e borës, e zbuloi dhe e ngriti me kujdes. Nën rrezet e dobëta të fenerit ndritte pellegu i gjakut. Edhe rrobat i skuqnin në shumë vende. Mezi merrte frymë. Kapiteni i shkëputi pa vështirësi

pushkën nga duart e, duke lëvizur fenerin nga fytyra deri te gjunjët, i pa dorën e djathtë të skuqur nga gjaku. Në mes të saj nxinin kallot e përcëlluara nga metali. Nga kjo pamje i shkoi mendja menjëherë te reportazhi dhe u prek.

— Merreni! Shpejt në spital! Ai duhet të jetojë!
— Këtë shprehjen e fundit oficeri e përsëritte sa herë që kishte të bënte me ndonjë të plagosur që kishte luftuar trimërisht.

Një kufitar së bashku me një fshatar bënë duart si vig dhe e ngritën të plagosurin. Mbi xhakëtën prej kadifeje të Artanit ishin ngjitur copa bore të përziera me baltë.

Komandanti i postës u la udhëzime të tjera kufitarëve dhe u kthye në repart së bashku me Artanin e plagosur dhe me robërit. Këta vinin pas me duar të lidhura në mes të një roje të përforcuar. Nxinin. Kështu nëpër natë symbyllur kanë ecur gjithë jetën. Por nëpër natë, nuk shikon dot mirë, ndaj rrëzohesh në greminë. Tej, në të majtë, dëgjoheshin edhe pushkë të rralla. Në sektorin ku qe dërguar kufitar Zemani luftohej ende. Dukej qartë se, për të arritur suksesin e çetës, për të maskuar veprimet e saj, armiqtë provokonin në atë pikë të kufirit.

Kapiteni, sa mbërriti në postë, ngriti receptorin dhe i raportoi komandës eprorë. E shoqëronte zëvendësi për punë politike. Prej centralit telefonik hyri në dhomën ushtarake politike dhe në ecje e sipër pyeti zëvendësin:

- U nis kufitari i plagosur?
- Për cilin thoni, për korrespondentin?
- Po, për atë.
- E nisëm menjëherë me një mushkë dhe dy kufitarë.

— Duhet të shpëtojë. Është një kufitar i vërtetë. Zëvendësi për punë politike ja nguli sytë letrave dhe bojës së shkrimit aty mbi tryezë e ju drodh trupi, ju afrua dhe i grumbulloi me kujdes, shikoi komandantin dhe prapë letrat:

— Si t'ja bëjmë reportazhit?

— Sigurisht duhet shkruar. Këtë punë do ta bëjmë unë dhe ti, vetëm me përmbajtje tjetër. Unë do të jap faktet dhe ti si «komisar» duhet t'i radhitësh në letër.

Zëvendësi për punë politike nuk doli më. I mbështolli me kujdes fletët dhe i futi në xhepin e xhakëtës. Me sa kuptoi ai nga fjalët e kapitenit, duhej shkruar një reportazh për Artanin, punëtorin, korrespondentin dhe kufitarin trim. Dolën. Nga lindja po agonte. Së shpejti rrezet e diellit do të pushtonin majat e thepisura të maleve, ku vetëm shqiponjat dhe kufitarët ishin banorë të përhershëm. Krahu i majtë i postës ra në qetësi.

PULËBARDHAT

Xheloja u ngrit nga tryeza, nxori paqetën dhe ju afrua dritares, nga ku dukej bankina e gjatë e portit ushtarak, bankina dhe katerat siluruese, KS-të, të mbledhur rrotull. Qielli po ngrysej. Një tufë pulëbardhash u ngritën nga dallgët e, si bënë nga dy rrotullime në fluturim, u ulën mbi rërën e paktë të plazhit. Aty seç çukitnin. Komisarit ju kujtua proverbi detar: «Po çukiti pulëbardha në kum, prit det të egër dhe furtunë». Atij i shkoi mendja te lundrimi i afërt në det, por zilja e telefonit ja preu mendimin.

— Alo! Aloooo! Ju jeni, shoku regjizor? Si jeni me shëndet? Përsëri kërkoni t'i japim leje detar Adriatikut? Mirë, mirë, po i japim dy orë leje. Veç kjo të jetë e fundit. Mirë u pafshim!

Uli receptorin e, me vështrim nga deti, përfytyroi detar Adriatik Metën, mitralierin e 80-tës, një djalosh i gjatë dhe simpatik. Ai luante rolin kryesor në dramën, që efektivit i repartit po e vinte në skenë me forcat e veta, nën regjinë e regjizorit të teatrit të qytetit. E luante mirë atë rol, me shkathësi e fare natyrshëm. Dukej se kishte talent. Shokët e kishin kuptuar me kohë këtë. Në kohën e lirë ai mund

të imitonte cilindo. Dhe ç'të imituar! Por ja që detyrën funksionale nuk e kryente si duhet. Herë i gjen-dej ndryshk në armë, herë i vendoste fishekët në shirit kuturu etj. Veçse regjizori nuk i dinte këto. Ai kishte detyrën e tij, të vinte sa më mirë dramën në skenë, në mënyrë që me të të ndihmonte sa më shumë në edukimin ideo-estetik të rinisë. Për këtë kishte kërkuar që Adriatiku të vinte në shtëpinë e kulturës e të bënte punë plotësuese e individuale me të. Komisar Xheloja vendosi të lajmëronte komandantin e 80-tës për t'i dhënë leje mitralierit.

— Alo!.. «Shqiponjë e detit» jeni?.. Lajmëroni Seferin t'i japë dy orë leje detar Adriatik Metës të shkojë në prova në shtëpinë e kulturës. Ku është tani detari?.. Në shërbim, në truproje?.. Mirë. Sa të dorëzohë shërbimin, të niset... Po, po, komisari jam.

Mbylli telefonin. por dorën nuk po e largonte nga receptori. Diçka filloi ta shqetësojë. Ishte e dyta herë që regjizori kërkonte leje në telefon për të. Dhe ai i kishte dhënë. I kishte dhënë, se duhej. Ajo drama që do të shfaqej së shpejti, s'ishte një punë e kotë. Edhe ajo i shërbente qëllimit kryesor, edukimit të ushtarëve. Ajo s'duhej nënvlerësuar. E megjithatë... Duhet folur me regjizorin. Duhet folur menjëherë pas lundrimit.

Kështu mendonte komisari Xhelo.

Adriatiku, i bindur se do të merrte leje edhe atë pasdreke, pasi komisari ja kishte dhënë fjalën regjizorit, dorëzoi shërbimin dhe shkoi të pregatitej. Ishte rruar, pastruar e hekurosur kur e lajmëruan t'i paraqitej komandantit të anijes, shokut Sefer. Ishte tepër i qetë. Veçse kur mori fletëdaljen, i shkoi një dridhje nëpër trup. Një dridhje e çuditshme, siç u

ndodh njerëzve kur janë duke ecur mbi urë dhe vënë këmbën mbi dërrasën e kalbur, gati në thyerje, mbi një dërrasë që nuk mban më peshë të rënda. Një dridhje të tillë pësoi trupi i tij edhe kur bëri qitjen e parë me mitraloz; Ajo dridhje kaloi, u harrua e, pas qitjeve të tjera, nuk ju përsërit, kurse kjo tjetra sikur po e pushtonte të tërin. Megjithatë, ai nderoi dhe u largua me shpejtësi drejt postblokut. I shkeli syrin rojës, një siluristi të anijes së tij, kur i tregoi fletën e daljes, dhe u bashkua me njerëzit që kalonin në rrugë.

Ectë duke shikuar herë pas here orën. Ai shqetësim që pak minuta më parë i erdhi aq papritur, nuk e kishte lënë akoma. Mendoi mos e kishte nga lodhja, sepse sapo e kishte dorëzuar shërbimin 24 orësh. Por jo. Çfarë lodhje mund të kishte, shërbimi ishte i lehtë. Si korrier i oficerit të rojës, kohën më të madhe të punës ai e kalonte pranë telefonit. Mendoi se gjithshka i vinte nga emocioni, nga dëshira për të parë sa më parë Elmën, vajzën e dashur e me fytyrë të qeshur. Sytë e saj si dy fenerë në breg, lëshonin shkëndija edhe në kohë të zymtë për djaloshin. Dritat e tyre ishin drita shprese dhe sigurie. Kur ajo mbyllte qerpikët, detarit i dukej sikur feneri shuhej për t'u ndezur përsëri e për të treguar se aty ishte bregu, aty ishte toka.

Me Elmën u njoh në portin ushtarak, e pastaj në anije, kur një grup të rinjsh të uzinës së qytetit erdhën për vizitë. Atëhere Adriatiku ishte i drojtur. I bëri përshtypje vajza kur u ul në kështjellën e mitralozit të tij dhe mori në shenjë dy pulëbardha. Pulëbardhat ranë në fillim mbi ujë, pastaj u ngritën lart, por tytat e mitralozave i shoqëruan. Vajza e mbyllte me vështirësi syrin e majtë. Këtë e vuri re

Adriatiku. Atij nuk i pëlqeu që ajo shënoi mbi këto miksha të detarëve, aq më tepër sepse qenë dy, një çift i zgjedhur. U turbullua e, kur vajza e pyeti për diçka, ai ju përgjegj tjetër për tjetër e u skuq. Pastaj, si për të marrë veten, i tha:

— Ne pulëbardhat i duam shumë. Sa e sa herë na shpëtojnë në det. Na tregojnë kohën dhe bregun.

— Dhe gjithmonë kështu çifte-çifte rrinë?

— Janë qenje të gjalla. Natyra vetminë nuk e ka krijuar për to — u përgjegj Adriatiku. Pa vajzën dhe e treti prapë vështrimin te pulëbardhat, që tani kishin dalë nga sektori i qitjes. Kështu u njohën ata.

Pas kësaj erdhën dhe të tjera. Dhe detarët u shkuan atyre në uzinë. Biseduan për një koordinim të planeve të punës së tyre edukative kulturale, shprehën edhe gatishmërinë për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ndaj, kur lindi problemi i forcimit të grupeve diletante, organizatat e rinisë së uzinës i ndihmuan ushtarakët, duke caktuar dy vajza për të luajtur në dramën që do të vihej në skenë. Njëra prej tyre ishte Elma. Asaj i caktuan një nga rolet kryesore. Në dramë ajo dhe Adriatiku ishin dy të rinj që dashuroheshin, që thurnin ëndrra e plane për të ardhmen. Në fillim regjizori i detyroi disa herë të përsëritnin skena të veçanta: «Më natyrshëm, më natyrshëm», thërriste ai. Pas një muaji ai sikur u qetësua. Ata i kishin hyrë mirë rolit, luanin më tepër se ç'duhej. Kjo ra në sy, e kush mund të mbulonte dashurinë, që po shpërthente?

Këto po sillte ndër mend Adriatiku derisa arriti te porta e ndërmarrjes së Elmës. Portieri, një plak i thinjur, që e njihte si vizitor të shpeshtë, i buzëqeshi. Punëtorët e punëtoret nisën të dilnin dy nga dy e grupe-grupe.

— Ja, po dalin — tha ai.

Nga një grup vajzash u shkëput Elma. I shtrëngoi dorën.

Për disa kohë ata ecën përkrah njëri-tjetrit, pa e prishur monotoninë e hapave. Pastaj Elma i tregoi për prodhimet e reja të repartit të tyre. I tha se shoqet e ngacmojnë shumë. Papritur ajo e vështroi drejt në sy dhe e pyeti:

— Me leje ke dalë?

Ai e vështroi sikur ta pyeste.

— Jo, kot pyeta. Thashë se ishe pa leje, se...

— i tha vajza.

Ai ja preu menjëherë:

— Jo, të betohem kam! Kam leje nga vetë shoku Xhelo — dhe, për ta bindur, i tregoi fletën e daljes së lirë me firmë dhe me vulë të rregullt.

— Sidoqoftë, mua nuk më pëlqejnë këto dalje të shpeshta. Në ditë pune nuk kam parë asnjë detar tjetër të kapardiset nëpër qytet.

— Unë kam rolin. Roli është një detyrë për mua — tha detari dhe ngriti vështrimin mbi fytyrën e vajzës për të parë përshtypjet që i bënë këto fjalë.

— Dëgjo, Adi. Në pjesën që ne luajmë, dashuria i ndihmon të rinjtë për të kapërcyer vështirësitë e punës dhe të shërbimit. Unë kam frikë se mos ty të tërheq në drejtim tjetër, se...

— Nuk duhet të ma thoshe këtë. Nuk duhet të ma thoshe, pasi ti më njeh mirë. Unë... — dhe nuk vazhdoi më, veç ajo «unë» sikur i doli nga thellësitë e zemrës.

Ra prapë heshtja. Hapat e tyre të zakonshme në asfalt vazhduan monotonë. Në vend që të kalonin nga rruga kryesore, Adriatiku mori drejtimin e rrugës më të gjatë, ku kishte më pak njerëz. Nga njëra

anë ky veprim i pëlqeu vajzës, u pëlqeu të dyve, pasi do të qëndronin më tepër bashkë, por nga ana tjetër e vuri në dyshim Elmën. Megjithatë, ajo e kuptoi se e teproi me fjalët e saj, prandaj hapi bisedë tjetër. Fundi, edhe ajo nuk ishte indiferente ndaj tij. Kur disa ditë me radhë nuk bëheshin prova, duke menduar se detarët mund të kishin dalë në det, ose se mos Adriatiku ishte i sëmurë, ajo kishte shkuar në repart dhe e kishte takuar.

Si ndërroi biseda, dy të rinjtë hynë në botën e tyre dhe rrugën deri në shtëpinë e Elmës që me hap të zakonshëm mund ta bënin vetëm për njëzet minuta, e bënë gati për dy orë.

— Kur do të shihemi? — pyeti vajza buzagaz.
— Dhe papritur përgjegje, shtoi se asaj i kishte mbetur qejfi që regjizori s'tregonte ndonjë interesim për rolin.

— Ti, siç duket, e luan shkëlqyeshëm — nxitoi të thoshte Adriatiku.

— Shkëlqyeshëm?! — Dhe Elma qeshi me të madhe. — Me sa duket, regjizori ynë tregon interes vetëm për rolet e burrave. Ti mos qesh, unë s'tallem. Nesër do t'i them se nuk vepron mirë.

Adriatiku u ngrys në fytyrë.

— Jo, këtë mos e bëj — thirri. — Jo, jo, ti nuk duhet të ndërhysh në këtë punë. Regjizori nuk... Ti mos thuaj asgjë se...

Këto fjalë ai i nxori si me grep nga buzët që ju thanë. I shtrëngoi dorën vajzës dhe bëri të ikte. Elma qëndronte në këmbë e hutuar nga ato që dëgjoji. Atë diçka filloi ta shqetësonte.

— Mos i thuaj regjizorit — tha në të ikur Adriatiku. — Ne duhet të bisedojmë herë tjetër përse

s'duhet t'i thuash. — Dhe s'priti që vajza t'i përgjegjej.

Në çdo hap që bënte sikur e godisnin fjalët që tha ajo: «Në pjesën që ne luajmë, dashuria i ndihmon të rinjtë për të...» Pastaj... jo, djaloshi e kishte këren të turbulluar. Dhe, për çudi, filloi sërish ajo drithërimë, që kishte ndjerë kur mori fletëdaljen. Po sikur të takonte komisarin e ai ta pyeste si shkonin provat? Çfarë do t'i thoshte?

Tek mendonte kështu, vuri re se i ishte afruar repartit. Ja dhe deti, ja dhe anijet pas bankinës.

Sa hyri në repart, pa komandant Seferin në mes të një grupi detarësh. Nxitoi hapin për atje.

— Shoku komandant, detar Adriatik Meta u këthye nga liridalja pa vërejtje!

Shokët e panë me kujdes.

— Ore «artist», si shkon roli? — pyeti Arbeni.

— Apo nuk e luan ajo partnerja! Tamam si pulëbardhë rrëshqet! — tha Mithati.

Të gjithë qeshën. Adriatiku i vështroi fytyrëngrysur, por nuk foli.

Detarët do ta thumbonin akoma «artistin» sikur të mos ndesheshin me vështrimin e egër dhe me fjalët e komandantit:

— Adriatiku erdhi tamam në kohë!

— Dikush lajmëroi, shoku Sefer, që të paraqitet urgjent te komisari — tha njëri nga marinarët.

Adriatikut nuk i bënin këmbët. Fjalët e komandantit, që i doli në mbrojtje, e goditën rëndë.

— Ç'më shikoni ashtu? — ju drejtua ai shokëve.

— Na vjen zili — tha Arbeni dhe u shkeli syrin shokëve. — Lëreni. Siç duket, sot s'i ka ecur mbarë — shtoi pastaj.

Shokët u larguan, kurse Adriatiku shtangu në vend. Çfarë kishte bërë ai ashtu? Përse e bëri?

* * *

Në mbrëmje u soll i vetëm nëpër sheshin sportiv. Pastaj shkoi e u ul në një stol buzë detit dhe admironte pulëbardhat, që dilnin çifte-çifte nga dallgët duke luajtur me to, pastaj humbnin lart nëpër re. «Ah, këto pulëbardhat!...» mendoi.

Pas shiut, edhe era u qetësua. Veçse uji i detit ishte i turbullt si mendimet e djaloshit. I ndoqi me vështrim pulëbardhat dhe mendja i shkoi tek Elma: «Po sikur ajo të bisedojë me regjizorin? Sigurisht ai do t'i thotë se nuk... Por ky është një gabim, një faj i rëndë. Ky është mashtrim! Po, po... Duhet të shkoj e të them të vërtetën. Po pse ta kapë regjizorin Elma, kur ajo e di shumë mirë se unë për të e bëra këtë gabim? Në pjesën që ne luajmë, tha ajo, dashuria i ndihmon të rinjtë për të kapërcyer vështirësitë. Kurse dashuria mua më shtyn të bëj marrëzira. Marrëzira! Duhet biseduar shtruar me komisar Xhelon dhe t'ja them troç të vërtetën».

Gjithë mbrëmjen u përpëlit në krevat. Ndonëse një natë më parë u ndodh me shërbim e pas dorëzimit të shërbimit nuk kishte mbyllur sy, prapë s'e zinte gjumi. Sotiri, që e kishte krevatin ngjitur me të, dëgjoji kërcitjet e herëpashershme të krevatit dhe i foli me zë të ulët.

— Çfarë ke kështu? Hapja zemrën shokut.

Ai heshti. Pastaj me zë të ulët tha:

— Kam bërë faj ndaj rregullores dhe komisarit.

— Ndjaj rregulloreve?! — dhe tjetri ngriti kokën dhe priti të dëgjonte akoma. — Çfarë faj, Adi?

— U verbova nga diçka e shtrenjtë personale e për hir të saj prisha të përgjithshmen.

Shoku s'ju përgjegj menjëherë.

— Sidoqoftë, ti duhet të mendosh mirë për gabimin. Të mendosh e të dalësh para shokëve. Ata do të të ndihmojnë. Do të të kritikojnë, por do të të ndihmojnë.

— Lërimi fjalët ju atje, se do të flemë — u dëgjua një zë i përgjumur nga fundi i kapanonit.

Të dy shokët pushuan. Adriatiku u rrotullua nga ana tjetër, nga ku ishte edhe dritarja. Ndërmjet xhamit të saj dukej drita e fenerit të molit. Ai dukej i mbytur në det. Dëgjoheshin dallgët që përplaseshin pas shkëmbinjve të molit dhe vërshëllima e erës e përzier me shi. Shiu binte, deti ulërinte, por feneri, sikur të mos pyeste fare për këto, lëshonte dritën e tij me intervale të caktuara. Ajo dritë, që qëndronte e pashuar midis dallgëve, shiut dhe erës, sikur i depërtoi në zemër edhe detarit. E për herë të parë nuk pyeti veten siç bënte shpesh: «Po pulëbardhat ç'bëjnë në këtë qamet?» Me vështrim të feneri e zuri gjumi me një guxim e ngrohtësi në zemër, me një vendim të drejtë në mendje.

Të nesërmen koha u gdhi e mirë. Ai ju vu punës për të përgatitur mitralozin e për të dalë në det. S'i dihej alarmit. Ai jepet papritur. Të detyron të lësh bukën në mes, fjalën në buzë dhe gjumin. E pastroi mirë e mirë. Radhiti fishekët nëpër shiritat dhe, si i vendosi nëpër kaseta, u bë gati për të shpënë në vend vendimin e guximshëm, për të hequr qafe atë peshë që i rëndonte. Si u bind që çdo gjë ishte gati, kapi dorezat e armatosjes dhe afroi syrin të

shenjestra. Në rrethin e shenjestrës, ku pasqyrohej shpejtësia maksimale e objektit, ju shfaq një pulëbardhë në fluturim. «Prapë kjo! Dreqi ta marrë! Ah, këto pulëbardhat!..» Në atë kohë u dëgjua zëri i Andonit nga cepi i bankinës, që kryente detyrën e përgjegjësit të ndërresës.

— Adriatik, të kërkon «partnerja» në postblok!

Për disa çaste ai mbeti me vështrim nga pulëbardha. Pastaj uli grykët poshtë, duke menduar: «Është vështirë të qëllohet objekti kur fluturon shpejt. Pastaj pulëbardhat janë mike të detarëve». Një buzëqeshje i mbuloi fytyrën. Fiksoi mitralozin, e mbuloi me mushama dhe kërceu në bankinë duke i thënë shokut:

— Erdha! Thuaj të presë pak!

Andoni nuk dëgjoi. Ishte larguar për në detyrë. Adi u hodh nga anija në bankinë me hapa të nxituar. Ecte dhe mendonte: «Pse të ketë ardhur kaq herët? Vërtet ajo e justifikon këtë sikur interesohet për pjesën, për ndonjë material ose ndonjë porosi të regjizorit, po s'ma merr mendja të jetë ky qëllimi i ardhjes. Ka kuptuar gabimin tim, ose ka folur me regjizorin. Po, Elma, nga ky batak ku hyra, do të përpiqem të dal me forcat e mia...» Ecte i sigurt si asnjëherë. Ecte dhe mendonte me vendosmëri: «Po, po, Elma, unë e kam gjetur ku ka ndryshk posti luftarak dhe do ta luftoj vetë. Guximi nuk më mungon». Sakaq u ngjit drejt shkallëve të zyrës së komisar Xhelos.

Eprori ndërpreu punën dhe, pasi i tha të ulej, e pyeti:

— Ç'kemi, shoku detar? Si venë provat suplementare të dramës?

Adriatikut ju duk sikur komisari e pyeti si shkon drama e tij shpirtërore. . .

— Unë ja plotësova edhe dje kërkesën regjizorit dhe ju thashë të shkonit në shtëpinë e kulturës.

Kur shqiptoi fjalën «regjizorit», Adriatikut ju duk sikur komisari vuri buzën në gaz. Aty mori guxim dhe, me kokën pak të ulur dhe me vështrimin diku në mol te një tufë pulëbardhash, tha:

— Shoku komisar! Erdha t'ju them një të vërtetë, që më rëndon e më gërryen si spirancë këtu në kraharor. Dje isha unë që fola në telefon në emër të regjizorit. Imitova zërin e tij.

— Si?! Qysh e morët guximin!?

— Kam bërë faj, shoku komisar. Faj që s'e lan dot as uji i tërë molit. Kjo personalja e shkretë! . . Unë ju premtoj. . . — dhe uli kokën mbi kraharor në pritje të kritikave të eprorit. Por komisari, për çudi, nuk i foli rëndë.

— Tani shko te shokët në anije. Pas lundrimit çështjen tuaj do ta zgjidhë kolektivi. Veç dua që kjo të mos influencojë për keq në kryerjen e detyrave gjatë lundrimit.

Adriatiku nderoi dhe u largua i lehtësuar. Me që rruga për në anije binte afër postblokut, në ecje e sipër ja bëri me dorë Elmës që priste, si për t'i thënë: «Mirë u pafshim. Pas lundrimit takohemi e do të t'i them të gjitha».

NË HARTËN OPERATIVE

Admiral Nazarovi e kaloi edhe një herë dorën e shëndoshë në zverk. Këtë veprim të përsëritur e kreu në mënyrë të tillë sikur të desh të largonte një mizë kali që nuk e linte të qetë. U ngrit nga vendi dhe shkoi te cepi i tryezës së gjatë në formë T-je. Kishte kohë që ndodhej në vendkomandën e flotës e nuk po i vinte biseda në shteg për t'u shprehur kolegëve shqiptarë, Luanit dhe Drinit, atë që e shqetësonte. Me rrugën që morën punët Nazarovi e kuptonte se fjala e tij si këshilltar kryesor pranë komandës së flotës shqiptare nuk dëgjohej nga asnjëri. Megjithatë përpiqej të tregojë gjakftohtë e në krye të detyrës. Sipas tij qëllimi final arrihej duke mos ju ndarë admiral Luanit e duke i dhënë të kuptonte se miqësia midis dy popujve e ushtrive nuk vdes kollaj; nëse grindjet dhe polemikat shkojnë dhe vijnë, detet janë të përjetshme etj. E kishte të qartë se çfarë kërkonte prej kolegut shqiptar atë mëngjez maji. Duhej matur edhe një herë tensioni. Parimi, të gjesh burimin e sëmundjes, mikrobin e saj, pastaj të përgatitësh ilaçet për ta luftuar, po bëhej kurs gjeneral në punën e Nazarovit. Kështu e kishin porositur. I kishin thënë të vepronte me zgjuarësi e me doreza.

ndryshe... Kësaj «ndryshe» ja kishte shumë frikën.

Nga cepi i tryezës shikonte me bishtin e syrit hartën e madhe operative, që zinte pothuaj tërë faqen e sipërme të saj. Nëpër dete e nëpër brigje qenë hedhur forca të ndryshme vetëm me dy ngjyra. Me ngjyrën e kuqe ishin paraqitur forcat tona dhe me ngjyrën blu ato të kundërshtarëve.

Nazarovit sikur nuk i interesonin ngjyrat. Ai e përqëndronte vështrimin në hartë, atje ku ndodhej gjiri i Vlorës, pastaj e zvarriste deri në Sevastopol e sërishmi e kthehej në Vlorë, sikur desh ta matte me sy atë distancë që me dhjetëra herë e kishte matur me kompas dhe e mbante mend me imtësi deri në një pash detar. Dinte gjithashtu se grupi i anijeve luftarake e përshkonte këtë distancë për shtatëdhjetë e dy orë.

Ngriti vështrimin nga harta dhe u përqëndrua te të dy admiralët vendas. Luani i ulur në krye të tryezës me hartë përpara shtërngonte në dorë një laps të trashë, të mprehur në të dy anët e tij, kuq e blu. Trupi i tij mesatar, me shpatulla të gjera dukej më i shëndetshëm në atë pozicion. Flokët i mbante të shkurtër. Nën ballin e gjerë spikatte një rrudhë që dukej sikur desh t'i ndante mendimet në mes. Nazarovi e dinte se Luani tërë jetën e kishte mbajtur pushkën në sup. Edhe në det kishte zbritur nga malet me pushkë në krah, së bashku me lirinë që kishte zbritur si uji i rrëmbyer i këtyre lumenjve që derdhen për të gjetur prehje të përjetshme në Adriatik. Në biseda përdorte përemrin «na» në vend të «ne»-së. Drini qëndronte në këmbë. Trupi i gjatë e i përkulur mbi hartë, mbi të dy bërrylet, krijonte një gjysmëharku. Ata konsultoheshin në gjuhën e tyre me zë të ulët.

Nazarovi nuk kuptonte asgjë. Edhe mendjen nuk e kishte atje. Befas nga një mendim që i erdhi në kokë sytë ju hapën shumë, duke nxjerrë në dukje anët e skuqura nga pagjumësia. Me sa dukej ndërmjet mendimit që i erdhi papritur, hartës dhe dy burrave që punonin me të, duhej të ekzistonte një lidhje e fortë.

Kërkoj nëpër xhepe dhe, pasi nxori «Kazbekun», që e nderoi, u largua pak më tej, te dritarja gjysmë e hapur. Andej hynin herë pas here tinguj borish automobili e fragmente të shkëputura bisedash të kalimtarëve. Nazarovi thithi cigaren e u përpoq të admironte panoramën e bukur të qytetit, që kodrat i rrinin si kurorë me degë ullinjsh. Edhe këtu nuk u përqëndrua. Atëhere pa në xhamin e hapur ku që larguar perdja e trashë gri. U tremb nga pamja e fytyrës së tij.

— Nuk e shoh mirë sot — i tha Drini Luanit duke bërë me shenjë nga Nazarovi.

— Kohët e fundit asnjëri prej tyre s'ka qenë mirë — u përgjegj Luani po me zë të ulët.

Trokiti dera. Tri palë sy u mbërthyen te doreza që u përkul ngadalë. Hyri oficeri i shërbimit operativ, një djalosh i ri trupgjatë me një radiogram në dorë. Bëri disa hapa përpara drejt komandantit të flotës e, si vendosi copën e letrës para tij, mbi tryezë, nderoi dhe doli.

Drini ju afrua radiogramit për ta lexuar. Nazarovit i kaloi një e ngjethur në trup dhe, sikur të mos bëhej merak për atë që bëhej fjalë në atë copë letër, u kthye prapë nga dritarja për të parë ndonjë reagim të kolegëve nëpërmjet pasqyrës së pafabrikuar e vazhdoi të thithte «Kazbekun». Luani i hodhi një sy fluturimthi radiogramit të deshifruar në shqip,

pastaj nisi ta lexonte me zë nga e para, duke e përkthyer çdo fjalë në ruisht e duke u përpjekur të shihnte fytyrën e Nazarovit, e cila, e mbështjellë me tym cigareje, qëndronte e drejtuar nga qyteti. Zëri i shkoqitur i Luanit u dëgjua përreth: «Sot në orën tetë e pesëdhjetë një grumbull anijesh të mëdha qëndruan me spirancë në perëndim të ishullit Fanos. Më parë këto anije, ende te painedentifikuara, lundronin me kurs për në Veri. . .» më poshtë në radiogram qenë shënuar numrat e pikave sinjalo-vrojtuese që i jepnin si dhe koha e zbulimit të anijeve në ecje. Luani nuk i përktheu këto.

— Eskadra e flotës VI! — tha Nazarovi, sikur të ishte në dijeni për çdo gjë. — Flota amerikane shkon si zakonisht për në Triest — vazhdoi ai si ju afrua edhe më tryezës.

— Të dërgojmë një katër silurues për ta verifikuar — tha Drini.

— Gjithmonë dyshoni ju shqiptarët, — tha Nazarovi i pakënaqur — pse gur varri jam unë në Shqipëri? Komanda ime më vë në dijeni për çdo lëvizje të anijeve tona ose të armikut.

Admiral Luani u përkuul edhe më mbi hartën operative. Sipas të dhënave të fundit të zbulimit, flota VI, e ndarë në disa grupe ndodhej në La Spezia, Napoli dhe Augusta. Një pjesë e saj ishte shpërndarë në disa porte të tjera të shteteve të ndryshme të Mesdheut. Nga mbiu në brendi të ishullit Fanos? Atij i bënë përshtypje thënjet e admiralit të huaj. E kuptoi shprehjen e fundit të Nazarovit kështu: «Po të ishin anijet sovjetike, Nazarovi duhet të kishte dijeni. E, meqë s'kishte, çdo gjë ishte e qartë: Anijet qenë të flotës VI».

Kur Luani vërtitte atë laps dyngjyrësh në dorë

duke mos vendosur me ç'ngjyrë ta hidhte në hartë situatën e re të porsakrijuar, Drini ju përgjegj kolegut të huaj:

— Këtu nuk është punë dyshimi. Ju vetë thoni shpesh: «Beso dhe kontrollo». Ndryshe, po mori vrapin predha e artilerisë, s'ka forcë që e kthen prapa.

Luani ja hodhi prapë sytë Nazarovit. Dësh të zbulonte ndonjë dridhje muskuli në fytyrën e ngjallur të tij. Po ai dukej i qetë. E kishte përmbysur dyshimin që mund të linte, të paktën kështu mendonte.

— Atëhere, si përfundim, grupi i anijeve të porzbuluara duhet hedhur në hartën operative me ngjyrën e armikut — tha Luani pa ja ndarë sytë Nazarovit.

— Jo, pse, verifikojeni një herë — tha Nazarovi me shpoti. Kjo u duk qartë se fjalën «verifikojeni» e theksoi fort. Meqenëse cigarja i ishte shuar në buzë, nxori prapë «Kazbekun». Në të kishte dhe dy cigare brenda, po, si duket, ose nuk i pa, ose nuk desh t'i shihte. E mblodhi shuk paqetën e pambarruar dhe e flaku në kosh. — Dreq, o punë, na mbaruan dhe cigaret. Të shoh në zyrë mos kam ndonjë paqetë — vazhdoi me ton tjetër dhe gjeti shkak për të dalë. Bëri disa hapa në korridor e, në vend që të hynte në zyrën e tij, hyri në atë të kolonel Petrovit, shefit të sigurimit të këshilltarëve sovjetikë. Pas pak Petrovi doli nga vendkomanda, mori «Gazin» dhe u drejtua për në bazë.

Në lokalin që shërbente si vendkomandë mbetën vetëm dy shokët, Luani me Drinin. Rrinin të shqetësuar përballë njëri-tjetrit. Situata e porsakrijuar kërkonte marrjen e masave. Të paktën duhej

shtuar vrojtimi e duhej shikuar mirë çfarë forcash ishin e ç'donin ato në portet tona.

— Me ç'ngjyrë ta hedhim — pyeti Luani i përkulur me laps në dorë.

— Sigurisht me ngjyrë blu. Si flota VI, ashtu dhe ajo sovjetike njësoj janë. Peshkaqenët njëlloj i kanë dhëmbët. Rrymat e nënujshme të deteve kalojnë nëpër ngushtica të ndryshme e bashkohen me njëra-tjetrën. Kjo dihet mirë edhe për Detin e Zi dhe për oqeanin Atlantik — tha Drini. — Bashkë me to...

Luani hodhi anijet e paidentifikuara në hartën operative me ngjyrën blu. Ra zilja e telefonit. Fliste oficeri i shërbimit operativ: — Ju raportojmë, shoku komandant, se pika N. e zbulimit lajmëron: «Sipas tastos së dhënjes në telegrafi dhe bisedimeve të radistëve ndërmjet tyre, konkludon se grupi i anijeve i ankoruar në perëndim të ishujve Fanos janë të eskadrës sovjetike të ardhur nga Deti i Zi. Ato po riorganizohen për t'u nisur në kilvator. Drejtimi i tyre është i panjohur».

— Janë të sigurt zbuluesit tanë? — pyeti Luani.

— Të sigurt, shoku komandant, të sigurt, për këtë pyeta komandantin e tyre dhe m'u përgjeggj: «I njoh të gjithë radistët kryesorë të anijeve më të rëndësishme të flotës VI në Mesdhe, nga pulsi i durave dhe nga mënyra e dhënjes në tastë. Cilën doni ju? Ja të marrim aeroplanmbajtësen «Amerika». Tri-dhjetë minuta më parë radisti i saj lajmëroi qendrën nga Napoli. E pelengua me përpikmëri».

Luani shikoi nga dritarja, ku kishte mbetur ende tymi i «Kazbekut» të Nazarovit, shtrëngoi lapsin në dorë, e me nofulla gati të mbërthyerë tha si me vete: «Dymijë e tetëqind ishin më parë, tremijë i kanë

sjellë me «Irgizin» dhe «Çiaturin» bëjnë rrotull gjashtëmijë detarë të armatosur e, po t'u shtojmë dhe eskadrën e porsambërritur, bëhen shumë. Ata kanë forca brenda dhe jashtë gjirit të Vlorës. Kombinimi i tyre ka për qëllim...» Admiral Luani e shprehu mendimin e tij me një gjest në hartë duke rrethuar Vlorën me një dorë nga ana e detit dhe me dorën tjetër nga Pashalimani. Ngriti kokën si për të pyetur, po në fakt nuk bëri asnjë pyetje. Përplasi lapsin mbi hartë e, si drejtoi trupin e ngërthyer vazhdoi:

— Nisuni urgjent në Sazan! Vini në gatishmëri numër një flotën, artilerinë bregdetare dhe tërë forcat. Pa lejen e Tiranës, që do ta merrni nëpërmjet meje, asnjë anije tjetër sovjetike nuk duhet të hyjë në gjirin e Vlorës!

— Si urdhëron, shoku komandant! — tha Drini. Ata shikonin njëri-tjetrin në sy si shokë. Sa herë që i duhej Drinit ta përdorte atë «si urdhëron», vinte buzën në gaz. Për çudi këtë radhë nuk buzëqeshi. I shtrëngoi dorën Luanit dhe u mat të dilte.

— Katri silurues që ndodhet në molo do t'ju shpjerë në Sazan — tha Luani. — Kur të mbërrini, po e patë të arësyeshme, dërgojeni në Fanos për ri-verifikim.

Admiral Drini tërhoqi derën pas vetes. Për disa çaste në vendkomandë plakosi heshtja. Pastaj ra zilja e telefonit. Luani kapi receptorin.

— Po, admiral Luani. Si? Grupi i anijeve mbiujëse sovjetike, i zbuluar në përdorim të ishullit Fanos është nisur drejt Veriut? Mirë, mirë, vëzhgojeni e për çdo lëvizje të dyshimtë më lajmëroni menjëherë. Uli dorezën dhe, pasi mori një numër, vazh-

doi: — Centrali? Lidhmëni me Tiranën! Me Tiranën ju thashë — përsëriti Luani.

Kur hyri admiral Nazarovi, Luani ende ndodhej i zhytur në këto mendime. Oficeri sovjetik i hodhi një sy të shpejtë hartës së situatës operative e, kur e pa se grumbulli i anijeve në perëndim të Fanosit ishte shënuar me ngjyrën blu, i bindur se vendasit nuk e dinin ende të vërtetën, nënqeshi i kënaqur.

— Po pse xhanëm kanë qëndruar amerikanët në perëndim të Fanosit? Zakonisht ata kalojnë përmes Otrantos — foli Nazarovi.

— Janë nisur drejt Veriut — tha Luani. Në të njëjtën kohë i afrohet shenjës konvencionale, me të cilën ishte shënuar në hartë grupi i anijeve të huaja, vendos një shigjetë drejt Veriut e shënon në një cep aty afër datën dhe orën.

— Janë nisur drejt Veriut? — tha Nazarovi si me habi. — Ata kursin e kanë për në Triest. — Ai e ngriti më shumë zërin me bindje. — E njoh mirë këtë linjë të tyre.

— Mos e kanë për në Vlorë? — pyeti Luani me zë të ulët dhe ngriti sytë mbi fytyrën e bashkëfolësit.

Nazarovi bëri sikur nuk e dëgjoi këtë pyetje. Rrotulloi kokën nëpër dhomë sikur kërkonte dikë, e më tepër me frikë se sa i çuditur pyeti:

— Ç'u bë shoku Drini?

— Shkoi në Sazan për të marrë masa sigurimi kundër eskadrës së flotës VI që shkon për në Veri. — Në të njëjtën kohë vuri majën e kuqe të lapsit në hartë mbi shenjën konvencionale që tregonte vendndodhjen, e pastaj mbi shigjetën e drejtimit për në Veri. Ashtu siç qëndronin dy njerëz të huaj karshi njëri-tjetrit, ashtu u vendosën dhe ngjyrat me kontraste: E kuqja karshi blusë, e kuqja mbi blunë. —

Duhen marrë masat, s'i dihet armikut. Kursi i tyre kalon afër brigjeve tona. Papritur mund të kthehen për në lindje. Ne duhet të jemi të përgatitur për çdo të papritur.

— Si shkoi në Sazan? Po mua si këshilltar pse nuk më pyetët? — Nazarovi hodhi me forcë cigaren në fund të dhomës.

— Këshilltarët ne i kemi pyetur dhe i pyesim për çështje teknike — tha Luani. — U kërkojmë mendime aty ku na ndihmon eksperiencia e tyre e vjetër ushtarake edhe në aspekte taktike, por jo për probleme strategjike.

— Pse, këtu nuk do të ndihmonte eksperiencia jonë? — pyeti Nazarovi duke futur me hutim gishtërinjtë nëpër flokë.

— Nuk besoj — tha Luani. — Vitet e fundit udhëheqja juaj i ka errësuar shumë anët e mira të eksperiencës së bolshevikëve të vërtetë në luftë kundër imperializmit. Le të marrim vetëm Kongon.

— Admiral Luani! — bërtiti Nazarovi duke i ndërprerë mendimin bashkëfolësit.

— Qetësohuni, shoku Nazarov, qetësohuni. Detyra e këshilltarit nuk ju lejon të nxeheni, e aq më tepër të hyni në punët tona të brendshme.

— Si nuk më lejon!? Hapja e zjarrit kundër eskadrës amerikane është një veprim serioz që të shpie në luftë. Jemi pjesëtarë të një traktati mik. Pikëpamjet tona dhe të traktatit të Varshavës janë të njohura për këtë pikë. Jeta ka vërtetuar se nga...

— Nga shkëndija e një pushke mund të lindë zjarri i një lufte të përbotshme! Këtë deshët të thoshit — e ndërpreu Luani. — E kemi dëgjuar dhe herë të tjera e s'kemi qenë në një mendje me ju.

— Po a e dini ç'do të thotë të hapësh zjarr mbi

pesë-gjashtë anije të mëdha luftarake, që kanë qindra gryka zjarri e raketa! Ato me breshërinë e parë do t'i shkaktonin dëme të mëdha brezit të mbrojtjes.

— Ne i kemi bërë llogaritë e prapë nuk jemi të një mendimi me ju — tha Luani. Mori kompasin dhe raportatorin, mati distancën nga bregu deri te vendi ku, sipas shpejtësisë së lëvizjes dhe kursit duhet të ndodhej eskadra, hodhi në hartë vendndodhjen e re dhe u kthye nga Nazarovi duke vazhduar: — Pse shqetësoheni kaq shumë ju? Ju thashë se eskadra e flotës VI është nisur në drejtim të Veriut. Ne do të hapim zjarr kundër saj, vetëm po të hyjë në ujërat tona, pasi ta kemi lajmëruar ku ndodhet, pasi t'i kemi kërkuar që të largohet. Do të hapim zjarr, vetëm po nuk u bind të largohet nga ujërat që na përkasin vetëm neve. Këtu nuk ka asgjë alarmante, më duket.

— «Po të hyjnë, do të hapim zjarr», thotë... Kjo është për të vënë duart në kokë! Kjo do të thotë luftë! Kjo është çmenduri! Ata e kanë mbushur Mesdheun me anije lufte! — Nazarovi nuk fliste, por bërtiste. Asnjëherë Luani nuk e kishte parë kështu.

— Ne nuk na kanë trembur edhe në ditët e para, pas çlirimit, kur ishim shumë të dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht. Po ju tregoj një rast nga jeta e vendit tim që ju, pikërisht në këto çaste duhet ta kuptoni mirë. Dëgjomëni — tha Luani dhe, si u mbështet më mirë në tryezë, vazhdoi: — Amerikani Hari Fulsi u dërgua nga SH.B.A. për të forcuar miqësinë midis popujve tanë me pashaportë diplomatike. Të paktën kështu ishte shënuar në vizën e tij. Na u tha se do të ndihmonte në zhvillimin e ekonomisë dhe të shkencës sonë, po diplomacia nuk është shkencë. Ajo është një art në duart e atyre

që dinë ta lozin. Duke zbatuar me përpikmëri udhëzimet e qendrës së zbulimit të shtetit që i përkiste, organizoi grupe diversioniste dhe sabotazhi në dëm të pushtetit popullor. Ky njeri me gjithë suitën e tij u zbulua dhe u bë i padëshirueshëm për ne. Shqipëria e vogël i ka pështyrë në surrat të gjithë armiqtë e saj, sado të fuqishëm që të kenë qenë. Kërkuam të largohej brenda një afati të caktuar nga toka jonë. Për të marrë Hari Fulsin, qeveria amerikane dërgoi dy kryqëzorë. E çuditshme, apo jo? Ata deshën të na frikësonin, të na bënin presion, ose të futnin këtë forcë goditëse në Durrës e në kombinim me elementet e pakënaqura brenda, që ishin njerëzit e tyre, të na detyronin të binim në gjuhë. U gabuan rëndë.

Bashkë me shokun Drini u ndodha në Durrës. Ne si ushtarë të këtij populli dhe sipas udhëzimeve që morëm nga lart, vendosëm të mos i linim të dy kryqëzorët të hynin në ujërat tona. Dërguam një rimorkiator të vjetër, më të mirin që kishim, me urdhër të prerë, që në rast mosbindjeje të hapte zjarr. Këtë veprim do ta kryente për t'i dhënë sinjalin artilerisë bregdetare dhe tërë vendit që të merrnin masa. Merrni me mend, një rimorkiator me një mitraloz 8 mm. kundër dy kryqëzorëve që kishin me dhjetëra topa e mijëra detarë.

Qeshnin oficerët e lartë amerikanë kur shihnin rimorkiatorin tonë tek lëkundej nga dallgët e krijuara prej heliçeve të fuqishme të kryqëzorëve, por mandej i vunë gishtin kokës. U bindën se mbas atij rimorkiatori të drunjte qëndronte një popull trim e i papërkulur, që e ka çmuar dhe e çmon lirinë si gjënë më të shtrenjtë, një popull që sa e kishte fituar lirinë.

Ata pesë a gjashtë burra të rimorkiatorit mund të vdisnin me predhën e parë të kryqëzorit, mund të vdisnin edhe të tjerë, por tërë populli e ushtria që qëndronin pas tyre do të luftonin për jetë a vdekje. E ai komandant rimorkiatori mori urdhër të qëllonte me plumba mitralozi kundër çelikut të kryqëzorit. Mos buzëqeshni, do të qëllonte ashtu siç do të qëllojnë edhe djemtë, ose vëllezërit e tij tani, në goftë se eskadra e flotës VI tenton të hyjë me forcë në Vlorë, ose në ndonjë port tjetër shqiptar. Kjo ndodhi atëhere, në vitin 1946, kur ne ende nuk e kishim parë barin të mbinte në varrin e martirëve të luftës. Po sot, kur popullin e kemi më të bashkuar se kurrë rreth partisë dhe Komitetit të saj Qendror leninist, kur kolonat e pesta që kishte organizuar Hari Fulse e mandej miqtë e tij i kemi zhdukur, (ju si miqtë tanë e dini këtë), kur kemi një ushtri të fortë e të pajisur me teknikën e kohës, pse të mos qëllojmë? Pse të rrimë duarlidhur? — Fjalët e fundit Luani i tha me emocion. Herë pas here shikonte kolegun në sy për të parë a e kuptonte ai paralelizmin e ngjarjeve. Po Nazarovi bënte sikur nuk merrte vesh. Siç dukej ende nuk ja kish arritur qëllimit të tij.

— E pastaj? — pyeti Nazarovi i përkulur mbi hartë. — Nuk ju kuptova se çfarë deshët të më tregonit në historinë e dy kryqëzorëve amerikanë.

— Fjalën e kishim te eskadra e flotës VI që po i afrohet brigjeve tona, apo jo?

— Po, që shkon për në Veri — tha Nazarovi me të shpejtë, siç bëjnë njerëzit kur duan të korrigjojnë diçka.

— Në Veri, në Veri, por aventurat ushtarake janë bashkudhëtare të imperialistëve dhe miqve të tyre — u përgjegj Luani.

Nazarovi nderi dhe një cigare tjetër.

— Kështu pra — vazhdoj Luani — komandanti i rimorkiatorit ua tha prerë amerikanëve: «Prisni këtu, jashtë ujërave territoriale! Këtu do t'ju sjellim Harrin dhe shokët e tij. Po të bëni një xhiro elike përpara, përgjegjësia do të bjerë mbi ju». . . U bë ashtu siç thamë ne. Ishte mot i keq. Deti kishte rryma të nënujshme të fuqishme. Rimorkiatori ynë nuk dispononte mjete për të ngjitur zotin Harri në bordin e kryqëzorit. Pastaj atje në det të hapur nuk e linin dallgët të akustohej allaj i anijes luftarake. Atëhere Hari Fulsin e lidhëm me rrjeta peshkimi dhe e ngjitëm në kryqëzor. Me rrjeta peshkimi dhe me vinça, siç ngjitin peshkatarët gjahun e tyre. Tani a më kuptuat? — Luani vuri buzën në gaz dhe uli sytë. Nazarovi ngriti supet.

— Me fjalë të tjera desha t'ju thosha në vijim të bisedës sonë se me presion e shantazhe jemi mësuar ne. Forcës, kemi qenë dhe jemi gati t'i përgjigjemi me forcë. Po unë mendoj. . . — këtu Luani e uli zërin dhe pa nga bashkëfolësi me bisht të syrit. — Po unë mendoj se eskadra e flotës VI s'e ka syrin për te ne. Ajo do të vazhdojë kursin drejt Triestes, siç thatë ju.

Në dhomë ra qetësia, Nazarovi thithi «Kazbekun». Përpiqej të ishte i qetë. Diçka e rëndësishme e tërhiqte e bënte çmos të mos largohej nga ajo hartë operative, ku anijet luftarake të nisura drejt Veriut ishin shënuar me ngjyrën blu. Ai rrëshqiste vështrimin se te kjo ngjyrë në atë tjetrën, të kuqe, ku harqet e distancës efektive të qitjes së artilerisë bregdetare, vendosur nëpër brigjet e thepisura, zgjatëshin deri tej në det. Tani për tani këto ngjyra të kundërta ishin shënuar vetëm në hartën operative e ndodhe-

shin larg takimit, por afrimi vazhdonte. Kjo, si duket, e shqetësonte më tepër admiralin e huaj. Ai si specialist e dinte mirë se çdo luftë nis me harta e përfundon po me harta. Shembulli që i solli Luani e goditi direkt në plagë.

Nazarovi pa orën e dorës. Ishte e para herë që e kryente këtë veprim. Duhej ende kohë që grupi i anijeve të nisura nga Fanosi të binte traviers me kanalin e jugut, pra kish kohë për të provuar tensionin e vendasve, për të shikuar deri në çfarë shkalle i kishin tendosur nervat e deri ku mund të shkonin ata me vendosmërinë e tyre.

— Ata të dy kryqëzorët mund ta bënë pluhur e hi bregdetin dhe qytetet tuaja — përsëriti Nazarovi si me vete, pa i hequr sytë nga grupi i anijeve që ishte hedhur në hartë.

Ajo që s'është provuar mbetet për të parë, — tha Luani. Hodhi sytë mbi forcat e shënuara në hartë me ngjyrë të kuqe. Në të përfshiheshin anije të ndryshme mbiujëse, katera silurues, artileri bregdetare të kalibrit të ndryshëm, forca tokësore etj.

— Koleg, në punë të tilla nuk duhet nxituar.

— Nuk ju kuptova? — pyeti Luani.

— Ta zëmë se drejt kanalit të veriut ose të jugut vijnë drejt Vlorës një ose disa anije luftarake me flamurin sovjetik. Mund të vijnë edhe pa lajmëruar. Është bërë traditë te ju e te ne që mikut të mos i kërkohet leje për vizitë e të mos i caktohet dita. Flas për miq të vërtetë, siç jemi ne. E kam fjalën te veprimi, si do të reagonit? A do t'i lejonit anijet tona të hynin? — tha Nazarovi. Ai i kishte ngulur sytë fytyrës së Luanit e përpiquej që nëpërmjet saj të depërtonte në shpirt të tij. Dukej sheshit se përgjegjen e priste me padurim.

«Hë të shkretën, nxirre, se na plase». . . mendoi Luani dhe tendosi trupin në karrige. Nuk u nxitua t'i jepte përgjegje. Mori raportorin dhe kompasin, pa orën dhe, si llogariti vendndodhjen e re të grupit të anijeve që ecnin me kurs drejt Veriut, vendosi një pikë në hartë, hoqi shigjetën në vazhdim të kursit, e nën të shënoi kohën e re. Pastaj u kthye nga Nazarovi.

— Simbas kontratës sonë anijet sovjetike para se të nisen nga bazat e tyre për në Shqipëri duhet të na pyesin a i pranojmë, apo jo. Vetëm pas lejes aprovuese nga autoritetet tona mund të ndezin motorat dhe të hedhin kursin në hartë për të ardhur në këto brigje.

— Nuk m'u përgjegjët plotësisht — tha Nazarovi.

— A, ju doni të dini si do të vepronim me anijet luftarake të paidentifikuara?

Nazarovi pohoi me kokë.

— Në rregulloret tona të anijeve luftarake e në instruksionet e baterive bregdetare ka paragraf të veçantë për këtë. Atje tregohet qartë si duhet vepruar. Ju e dini mirë atë. . . Anija e huaj pyetet se cila është, lajmërohet se ka hyrë në ujërat tona. Në rast se nuk përgjegjet, ose nuk bindet, ajo konsiderohet armike, e me armiqhtë. . . këtu mendimet tona janë të qarta. — Luani hoqi një shigjetë të kuqe nga bateria më e afërt bregdetare në drejtim të grupit të anijeve që desh të thoshte me këtë: Kundra armiqve hapet zjarr me të gjitha forcat.

— Si!?. Si, po vllëzëria, po traktati i Varshavës?! — tha me të shpejtë Nazarovi me sy të zgurdulluar. Njëra vetull ju ngrit lart. Buza e poshtme ju dridh, fytyra ju skuq dhe ju shtrembërua. Cigarja i ra nga

dora. U përkul për ta marrë. Nga nxitimi ju përplas
koka në tryezë, po s'e bëri veten. Vuri cigaren sërishmi
në buzë e, meqë ishte i hutuar, harroi dhe e futi nga ana e
zjarrit, pështyu tërë inat dhe u ngrit në këmbë.

PASQYRA E LËNDËS

| | Faqe |
|-----------------------------------|------|
| Rrugë e fundit e një lanxhe | 3 |
| Rezervisti | 12 |
| Nëna me zemër të madhe | 17 |
| Vigjlenca | 24 |
| Provimi i parë | 29 |
| Përpyekja e fundit | 36 |
| Në luginën e ftohtë | 46 |
| Dhëmbi i tretë | 66 |
| Reportazh i ndërprerë | 83 |
| Pulëbardhat | 97 |
| Në hartën operative | 108 |